

Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

2013-2014



"Me mbështetjen
financiare të UNICEF"

unicef 



Raport kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014

Shtypi Shtypshkronja “Pegi”

ISBN: 978-9928-175-72-4



Me mbështetjen financiare të UNICEF

Të nderuar lexues,

25 vjetori i miratimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës është një ngjarje e shënuar jo vetëm në Shqipëri por në mbarë botën. Kjo konventë erdhi pas një revolucioni të thellë në mendimin e të rriturve lidhur me fëmijët - ata nuk konsiderohen si "pronë" e të rriturve, as si zgjatim i prindërve, por si individë të pavarur me të drejta të plota. Ratifikimi i Konventës në vitin 1992 në Shqipëri shërbeu si një gur themeli për ndërtimin e vlerave demokratike dhe në trajtimin e fëmijëve si qytetarë me të drejta të plota.

Kur flitet për të drejtat e fëmijëve nuk mund të mos mendosh për një fëmijë që është i gëzuar, i cili shpenzon kohë në lojëra e argëtime, ka mundësi të arsimohet, të shoqërohet dhe të pranohet nga shokët dhe mësuesit, është pjesë e një familjeje e komuniteti që i vlerëson, i mbron dhe kujdeset për ta, dhe jeton në një shtet që i ka në vëmendje fëmijët në nevojë dhe në rrezik.

Por kjo nuk është ende situata në Shqipëri, ku fëmijët vuajnë shkelje të rënda të të drejtave dhe mirëqenia e fëmijëve rrallë herë diskutohet si një çështje prioritare e politikës dhe e shoqërisë. Për më tepër kur flitet për grupe të caktuara të fëmijëve, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në gjakmarrje, fëmijët në situatë rruge, fëmijët me HIV/AIDS, shpesh herë programet janë ende shumë larg të të kuptuarit, arritjes dhe adresimit të nevojave dhe të drejtave të këtyre grupeve.

Edhe pse një sërë nismash janë ndërmarrë për të plotësuar në mënyrë të qëllimshme nevojat dhe të drejtat e fëmijëve - dhënia e bonusit shtesë për familjet në programin e ndihmës ekonomike për çdo fëmijë që shkon në shkollë, nisma për mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët në situatë rruge, nisma për parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve në shtëpitë e fëmijës, etj. - jemi të vetëdijshëm se këto nuk mjaftojnë. Ende ka shumë punë, për të ndërtuar një sistem të mbrojtjes sociale, i cili në radhë të parë mbron fëmijët dhe familjet më të rrezikuara.

Raporti për situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, i hartuar nga ASHMDF, synon të shkojë përtej ligjërimi politik dhe të sjellë në vëmendje sfidat, vështirësitë dhe hendeqet që ende ekzistojnë në mënyrë që fëmijët të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

ASHMDF luan një rol mjaft aktiv për t'u bërë zëri i fëmijëve dhe për të sjellë drejtpërdrejtë zërin e tyre, veçanërisht të atyre më të përjashtuar. Nxitja e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të fëmijëve në proceset vendimmarrëse duhet të kthehet në prioritet për të gjitha institucionet e tjera të pushtetit qendror dhe vendor, për të siguruar që të drejtat e tyre të respektohen dhe programet e hartuara të kenë në qendër fëmijët.

Puna për të përmbushur të drejtat e fëmijëve është një punë, që ndikon jetën e tyre sot, ndikon që ata të jetojnë një fëmijëri të lumtur dhe të shëndetshme, por njëkohësisht ndikon, që fëmijët të bëhen të rritur të përgjegjshëm dhe me vlera për veten, familjet dhe komunitetet e tyre.

Prandaj, le të bashkojmë forcat dhe të angazhohemi si institucione dhe si shoqëri, për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të të drejtave të fëmijëve tanë drejt rrugës për integrimin në familjen Evropiane.

Erion Veliaj

Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Të nderuar lexues,

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është një detyrë parësore e institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, që kërkon një bazë të mirë ligjore, por edhe profesionistë që punojnë dhe janë në kontakt me fëmijët. Në këtë 25 vjetor të miratimit të Konventës "Për të Drejtat e Fëmijës" ne mund të rendisim shumë hapa të rëndësishëm të ndërmarrë ndër vite, përmirësime ligjore dhe institucionale, programe në mbrojtje të fëmijëve, strategji, plane veprimi dhe politika publike që adresojnë çështjet e fëmijëve.

Të drejtat e fëmijëve nuk mjaftojnë të parashikohen në Konventa dhe ligje, por ato duhet të zbatohen plotësisht dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë fëmijët. Të drejtat e fëmijës mund dhe duhet të realizohen, duke luftuar varfërinë, duke ofruar kujdes shëndetësor, arsimim për të gjithë, shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë.

Fëmijët kanë nevojë për mbrojtje të veçantë nga shteti. Çdo vonesë në reagimin e institucioneve ndaj shkeljes së të drejtave të tyre do të rrezikonte sigurinë fizike, emocionale dhe psikologjike të fëmijës. Në këtë drejtim Shqipëria ka nevojë të forcojë institucionet që monitorojnë e kontrollojnë se sa zbatohet në mënyrë korrekte kuadri ligjor, cilësinë e shërbimeve ndaj fëmijëve dhe mbi të gjitha ato duhet të nxjerrin në pah mangësitë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Prej shumë vitesh në Shqipëri këtë rol e kanë luajtur organizatat e shoqërisë civile, vendase dhe të huaja. Krahas punës së shoqërisë civile, nevojitet forcimi i institucioneve shtetërore, që veprojnë në këtë fushë.

Raporti periodik i ASHMDF për situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, parathënieën e të cilit kam privilegjin të zhvilloj, i shërben më së miri vënies në pah të arritjeve dhe sfidave për të ardhmen, si edhe qartësimin të përgjegjësive konkrete për institucionet qendrore dhe vendore në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Asnjë argument nuk mund të justifikojë mosreagimin dhe mungesën e koordinimit midis institucioneve për rastet e dhunës ndaj fëmijëve, fëmijëve të ngujuar, shfrytëzimit për punë ose fëmijëve në situatë rruge, etj. Fondet nuk janë asnjëherë të mjaftueshme për të investuar për fëmijët dhe të ardhmen e tyre, por ne i kemi të gjitha mundësitë të shfrytëzojmë maksimalisht burimet financiare që kemi dhe të koordinojmë nismat shtetërore me ato të partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë, dhe mbi të gjitha, të kanalizojmë energjitë tona për më shumë veprime konkrete dhe më pak punë abstrakte.

Miratimi i ligjeve nuk duhet të na gëzojë, se kemi në letër ligjin e radhës të shkruar mirë, pa u kujdesur për zbatimin e tyre; strategjitë dhe planet e veprimtimit nuk duhen parë si detyra e radhës e realizuar brenda afateve kohore; koordinimi dhe takimet mes institucioneve qendrore dhe vendore nuk duhen konsideruar si garë për të shmangur përgjegjësitë. Ashtu siç fëmijët janë të sinqertë, edhe të rriturit duhet të jenë të sinqertë në punën dhe përkushtimin ndaj tyre.

Së fundmi, dëshiroj të falenderoj ASHMDF, që më ofroi mundësinë të shkruaj disa fjalë në këtë 25 vjetor të Konventës së Fëmijëve dhe në publikimin e raportit periodik të këtij institucioni. Ky raport profesional do të më shërbejë mua, kolegeve dhe kolegëve të mi në punën tonë në vijim, si një hartë për t'u orientuar më qartë, se ku nevojitet ndërhyrja dhe mbështetja e Kuvendit të Shqipërisë.

Të gjithë ata, që kontribuojnë çdo ditë për fëmijët meritojnë mirënjohje për punën fisnike dhe investimin që po i bëjnë shoqërisë për të ardhmen. Një shoqëri që respekton dhe garanton të drejtat e fëmijëve, është më e sigurt dhe e shëndetshme sot dhe në të ardhmen e saj.

Ju faleminderit!


Prof. Dr. Vasilika Hysi

Kryetare e Nënkomisionit të të Drejtave të Njeriut
Kuvendi i Shqipërisë

Lista e Shkurtimeve

ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
DPSHSSH	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
DRSHSSH	Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetërore
IEVP	Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale
IShPShSh	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
K.Pr.P	Kodi i Procedurës Penale
KDF	Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve
KP	Kodi Penal
KSHB	Këshilli Kombëtar i Birësimit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJDF	Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
PVF	Plani i Veprimit për Fëmijët 2012-2015
SKDSH	Studimi kombëtar demografik dhe shëndetësor





Përmbajtja

Hyrje.....	9
I. KUADRI RREGULLATOR DHE INSTITUCIONAL PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE.....	12
Kuadri Rregullator	12
Kuadri Institucional.....	14
Mekanizmat në nivel qendror.....	14
Mekanizmat në nivel vendor.....	17
Çështje për adresim.....	20
Kontributi i Fëmijëve.....	21
II. E DREJTA PËR FAMILJE DHE MBROJTJE SOCIALE.....	22
Situata.....	22
Të dhëna të lidhura me situatën e fëmijëve.....	22
Mbulimi me shërbime	24
Ecuria	27
Shërbimet përkujdesjes sociale	28
Shërbime Sociale të reja	30
Kategori të veçanta fëmijësh.....	32
Mekanizmat koordinues dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijëve	34
Çështje për adresim.....	36
Kontributi i Fëmijëve.....	37
III. E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR.....	38
Situata.....	38
Ecuria	45
Çështje për adresim.....	48

IV. E DREJTA PËR ZHVILLIM DHE PËR EDUKIM	49
Situata.....	49
Ecuria	55
Çështje për adresim.....	59
Kontributi i Fëmijëve.....	60
V. E DREJTA PËR MBROJTJE LIGJORE	61
Situata.....	62
Çështje për adresim.....	71
Kontributi i Fëmijëve.....	73
Shtojca 1 Legjislacioni	74
Shtojca 2 Lista e NJDF dhe NJMF	77



Hyrje

20 nëntori 2014 është një ditë e shënuar në historinë e të drejtave të fëmijëve anembanë botës pasi shënon 25 vjetorin e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, Konventës më të ratifikuar të Kombeve të Bashkuara, e cila i ngriti fëmijët dhe të drejtat e tyre në pedestalin e të drejtave universale njerëzore. Vendi ynë ka aderuar në këtë Konventë në 27 shkurt 1992 si edhe ka ratifikuar të tre protokollet opsionale të saj. Ky përvjetor paraqet një mundësi unike, për të marrë në shqyrtim ndikimin që kanë pasur këto dokumente në realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, si edhe për të ngritur një platformë për reflektim lidhur me të ardhmen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në vend.

Për të nderuar këtë moment të rëndësishëm, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF) ka zgjedhur të prezantojë Raportin Kombëtar mbi Situatën e të Drejtave të Fëmijëve 2013-2014.

Ky raport është raporti i 3-të i ASHMDF. Raporti i përgjigjet një prej funksioneve kryesore të Agjencisë, në bazë të mandatit të saj ligjor, që ka të bëjë me monitorimin e zbatimit të Ligjit kuadër 10347 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”. Ky ligj, së bashku me Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) që e plotësojnë atë¹, dhe Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015 (PVF) përbëjnë gurët themelorë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Për të përmbushur këtë funksion, VKM Nr. 267, datë 12.04.2012² i jep ASHMDF të drejtën, të mbledhë të dhëna nga një sërë institucionesh në nivel qendror dhe vendor për të hartuar raportet periodike, në zbatim të Planit të Veprimit.

Në dallim nga raportet e mëparshme, Raporti i 2013-2014 ka përqafuar një qasje të re në monitorimin e situatës së të drejtave të fëmijëve. Ai nuk kufizohet vetëm në analizën e zbatimit të objektivave të identifikuar në PVF 2012-2015, por hedh një vështrim më të gjerë mbi situatën e të drejtave të fëmijëve me qëllimin, për të kuptuar në mënyrë sa më të plotë këtë situatë dhe problematikat e saj.

Kjo për disa arsye: së pari, prioritetet për të drejtat e fëmijëve, të ngurtësuar në PVF gjatë vitit 2011-12, nuk marrin parasysh ndryshimet që kanë ndodhur si në planin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar në fushën e të drejtave të fëmijëve. Ndryshimi i ekzekutivit ka sjellë gjithashtu një ndryshim në prioritetet. Qeveria e re shqiptare e cila filloi punë në shtator të vitit 2013, ka një program të

¹ VKM Nr. 263, datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”; VKM Nr. 264, datë 12.04.2012 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”;

VKM Nr. 265, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”; VKM Nr. 266, datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve”; VKM Nr. 267, datë 12.04.2012 “Për Llojet, Mënyrën e Shkëmbimit të Informacionit dhe të Dhënave Statistikore të Kërkuara nga Agjencia e nga Strukturat Shtetërore Përgjegjëse, në Nivel Qendror dhe Vendor”.

² Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 267, datë 12.04.2012 “Llojet dhe mënyrën e shkëmbimit të përpunimit të informacionit e të të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF-ja e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”

rinovuar me prioritete dhe objektiva në lidhje me fëmijët, të cilat nuk reflektohen plotësisht në PVF. Një shembull është fokusi që po i jepet punës me fëmijët në situatë rruge. Për më tepër, asnjë mekanizëm rishikimi nuk është parashikuar për PVF përgjatë kohëzgjatjes së tij, duke e kufizuar atë, për të qenë një dokument udhëheqës i politikave dhe masave për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Së dyti, PVF nuk është i vetmi dokument udhëheqës në lidhje me të drejtat e fëmijëve për qeverinë shqiptare. Në vitin 2012, Shqipëria u shqyrtua nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve (KDF), i cili i ka dhënë vendit tonë një listë me rekomandime të rëndësishme në të gjitha fushat, që prekin të drejtat e fëmijëve, për t'u realizuar në mënyrë progresive dhe mbi bazën e të cilave Shqipëria do të shqyrtohet sërish në vitin 2017.

Rekomandimet e KDF përbëjnë një tjetër dokument themelor, mbi bazën e të cilit, duhet të matet progresi në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve. Ndaj, për të identifikuar arritjet dhe hapat përpara, janë marrë parasysh objektivat e PVF, por edhe rekomandimet e KDF. Këto dy dokumente së bashku, si një pasqyrë për situatën e të drejtave, shërbejnë për të vlerësuar progresin por edhe mangësitë.

Ky ndryshim në qasje, ka sjellë si rrjedhojë një ndryshim në metodologjinë e të mbledhurit dhe analizës së të dhënave. Për këtë qëllim janë qasur institucionet shtetërore, të japin kontributin përtej kuadrit të PVF.

Në hartimin e raportit janë marrë parasysh edhe pikëpamja e fëmijëve nëpërmjet dy konsultimeve *ad hoc* që janë organizuar në bashkëpunim me partnerët tanë, si edhe rezultatet e konsultimeve të mëparshme me fëmijët të organizuara në bashkëpunim me Agjencinë³.

Gjithashtu raporti është bazuar dhe në një sërë të dhënash mbi të drejtat e fëmijëve të raportuara nga aktorë të shoqërisë civile, që plotësojnë tablonë e të dhënave në lidhje me çështje specifike, dhe që janë referuar në tekst. Për të plotësuar tablonë e monitorimit të të drejtave, ASHMDF në bashkëpunim me partnerët po finalizon gjithashtu një raport monitorimi të buxhetit të qeverisë për fëmijët.

Gjetjet paraprake të raportit janë bërë paraprakisht subjekt i diskutimit me institucionet, të cilat kanë dhënë informacion dhe që kanë një rol në përmbushjen e të drejtave të fëmijëve. Kjo jo vetëm me qëllimin për të vlerësuar gjetjet dhe rekomandimet me anë të një procesi përfshirës, por edhe për të forcuar përgjegjshmërinë, për ta bërë raportin një dokument, i cili do t'i shërbejë reflektimit mbi masat, që duhen marrë nga këto institucione në adresimin e mangësive të identifikuara.

Me gjithë ndryshimet dhe përmirësimet që përmban ky raport dhe përpjekjen për të pasqyruar në mënyrë sa më të plotë situatën e të drejtave, jemi të

³ 13 dhjetor 2013, Dëgjese me fëmijët për buxhetin e MMSR, për çështjet e fëmijëve, në MMSR 19 nëntor 2013, Takim i ministrave të MMSR, MSH, MAS, MB me fëmijët dhe diskutim mbi problematikat që i shqetësojnë ata, në MMSR 27 maj 2014, Seancë dëgjimore me fëmijët dhe deputetët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë, 1 Qershor 2014, Takim dhe diskutim me fëmijët i ministrit të MMSR, në kuadër të 1 Qershorit 19 Nëntor 2014, Dëgjese me fëmijët dhe Ministrin e MMSR, zëvendësministren e MAS, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, për buxhetin 2015

ndërgjegjshëm që ka vend për përmirësim dhe se jemi ende larg ideale. Ndaj përpjekja për të përmirësuar qasjen dhe metodologjinë e raportimit do të vazhdojë të përmirësohet. Një mundësi e mirë na ofrohet nga momenti i hartimit të Planit të ri të Veprimit për Fëmijë gjatë vitit 2015, me tregues që do të lejojnë një monitorim efektiv të situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Raporti është i ndarë në pesë kapituj tematikë. Çdo kapitull është strukturuar në mënyrë që të paraqesë situatën aktuale, progresin e bërë në çdo fushë, të identifikojë problematikat e konstatuara dhe sfidat për realizimin e plotë të të drejtave si dhe sugjeron disa rekomandime nga pikëpamja e të drejtave të fëmijës. Kapitulli i parë fokusohet mbi mekanizmat legjislativë dhe institucionalë për mbrojtjen të drejtave të fëmijëve; kapitulli i dytë ka në qendër mbrojtjen sociale të fëmijëve si dhe mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës; kapitulli i tretë hedh vështrimin tek çështjet e lidhura me të drejtën për zhvillim dhe edukim; kapitulli i katërt analizon aksesin dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore; dhe kapitulli i fundit shqyrton çështjet e lidhura me mbrojtjen ligjore për fëmijët në konflikt me ligjin.



I. KUADRI RREGULLATOR DHE INSTITUCIONAL PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Kuadri Rregullator

Shqipëria ka ratifikuar konventat dhe protokollet kryesore të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, të cilat theksojnë, se fëmijët gëzojnë të drejta të plota dhe për shkak të veçorive, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore (*Shtojca 1: Legjislacioni Ndërkombëtar dhe Kombëtar*).

Që prej vitit 1992, Shqipëria është palë e konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve. Ky hap është pasuar me njohjen e dokumenteve të tjerë të rëndësishëm në këtë fushë. Ndër të fundit edhe Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës "Për Procedurën e Komunikimit"⁴, e Konventa e Këshillit të Evropës për "Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"⁵

Me ratifikimin e **Protokollit të tretë Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mbi "Procedurën e Komunikimit"** shteti Shqiptar ripohon edhe njëherë, se fëmijët janë subjekt i të drejtave të plota dhe u jep atyre mundësinë, për të kërkuar zgjidhje në nivel ndërkombëtar, nëse shkeljet e këtyre të drejtave nuk mund të gjejnë zgjidhje në sistemin ligjor brenda vendit. Në këtë mënyrë, ratifikimi i këtij instrumenti të ri ligjor, siguron se tashmë edhe shkeljet e të drejtave të fëmijës, mund të trajtohen po njëjloj si edhe shkeljet e të drejtave të tjera të njeriut, në nivel ndërkombëtar.

Protokollin e tretë Opsional të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës mund të zbatohet pa vështirësi brenda strukturave politike dhe ligjore ekzistuese të Shqipërisë. Ky Protokoll, nuk imponon detyrime të reja thelbësore, përveçse një angazhimi për të bashkëpunuar në procedurat e komunikimit dhe hetimit.

Protokollin nuk ka për qëllim të zëvendësojë mjetet juridike ekzistuese të brendshme apo të eliminojë nevojën për analizë dhe ndryshim. Më saktë qëllimi i Protokollit është të forcojë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe të lirive themelore në nivel të brendshëm. Megjithatë, edhe kur masat e brendshme janë të forta, në disa raste ato mund të dështojnë. Nëse kjo ndodh, aksesin në mekanizmat ndërkombëtarë ofron zgjidhje dytësore, por të nevojshme, procedurë me të cilën fëmijët mund të gjejnë një zgjidhje, për shkeljen në fjalë.

Me vendim Nr. 63 datë 26.11.2013 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar **Rezolutën**

⁴ Ligji Nr. 86/2013, datë 14.02.2013 " Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës "Për Procedurën e Komunikimit",

⁵ Ligji Nr. 19.11.2012, Nr. 104/2012 "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës për 'Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"

“Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”. Sipas kësaj rezolute Kuvendi vlerëson si shumë të rëndësishëm detyrimin e shtetit për të mbrojtur, respektuar dhe promovuar të drejtat e fëmijës, që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, konventat e Këshillit të Evropës, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga legjislati i brendshëm. Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë angazhohen për të përmirësuar legjislatin në mbrojtje të fëmijëve, për të nxitur dhe monitoruar qeverinë, veprimtarinë e institucioneve dhe mekanizmave të zbatimit të ligjit, që bëjnë të mundur mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. **Në nëntor të vitit 2014**, një grup parlamentarësh kanë krijuar dhe **Grupin e Parlamentarëve Miq të Fëmijëve**, të cilët do të kenë në fokus të drejtat e fëmijëve.

Konventa e Këshillit të Evropës për “Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”⁶ ka si qëllim mbrojtjen e të gjitha grave, përfshirë vajzat nën 18 vjeç nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Ajo synon hartimin e një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Konventa nuk zbatohet vetëm në rastet e dhunës me bazë gjinore, por përfshin në mënyrë të qartë dhunën në familje, dhe ofron mbrojtje për të gjitha viktimat e akteve të dhunës, që ndodhin brenda familjes duke përfshirë fëmijët.

Ndryshimet e miratuara së **fundi në Kodin Penal me ligjin Nr. 144/2013, dt. 20.5.2013**, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Këto ndryshime e sjellin legjislatin penal shqiptar në linjë me legjislatin ndërkombëtar, në veçanti me Konventën e Këshillit të Evropës (Lanzarote) *“Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”⁷.*

Ndër ndryshimet esenciale që mund të përmendim është Neni 1, ku shtohen fjalët *“të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve”*. Gjithashtu në Nenin 50, bëhen këto ndryshime: *“e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje”*. Ligjvënësi ndër të tjera, ka vendosur që të forcojë masën e dënimit për krimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve, vepër e cila nga 15 vjet burg tashmë dënohet me 25 vjet burg. Në Kod është shtuar edhe një vepër e re penale Neni 107, që ka të bëjë me dhunën me natyrë seksuale, ndërkohë që Neni 108 është ndryshuar i gjithi për të ofruar një mbrojtje nga krimet seksuale për fëmijët e moshës 14-18 vjeç. Po në këtë vepër penale është përfshirë edhe tentativa për të takuar fëmijën për të patur marrëdhënie seksuale me të. Një shtesë tjetër në Kod është edhe ngacmimi seksual, përfshi edhe fëmijët, në paragrafin e ri C të Nenit 108 të KP.

Një rregullim të plotë ligjor ka pësuar edhe pornografia e fëmijëve në Nenin 117 të Kodit Penal, i cili në ndryshimet e tij të fundit, e konsideron edhe posedimin, rekrutimin e një serë formash të tjera të pornografisë së fëmijëve si një krim. Po ashtu një zgjidhje adekuate është gjetur edhe për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Neni 124, paragrafi C i Kodit, është përmirësuar, duke përfshirë të gjithë format e shfrytëzimit të fëmijëve. Neni i ri thotë: *“Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura,*

⁶ Ligji Nr. 19.11.2012, Nr. 104/2012 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës për “Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”

⁷ Ligji Nr. 10071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës (Lanzarote) “Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”

për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet."

Së fundmi është miratuar ngritja e Seksionit **për të Miturit pranë institucionit të Avokatit të Popullit** nëpërmjet Ligjit Nr. 155/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit". Ky është një lajm mjaft pozitiv në garantimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, pasi më në fund edhe vendi ynë ka një zyrë të veçantë pranë Avokatit të Popullit, që do të mund të presë ankesat për të drejtat e fëmijëve dhe të bëjë monitorim të pavarur mbi shkeljet e këtyre të drejtave.

Kuadri Institucional

Në ligjin Nr. 10347 datë 4.11.2014 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përcaktohen cilat janë mekanizmat institucionalë në nivel qendror dhe vendor dhe mënyrën e bashkëveprimit të tyre për të siguruar realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në nivel qendror janë organizuar dhe funksionojnë:

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
Ministri që bashkërendon punën për çështjet e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Në nivel vendor janë ngritur dhe funksionojnë:

Njësia për të Drejtat e Fëmijës në nivel qarku (**12 NJDF**)
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel **bashkie/komune (196 NJMF)**

Mekanizmat në nivel qendror

Mekanizmat në nivel qendror kanë kryesisht funksion politikëbërës, monitorues dhe koordinues të zbatimit të këtyre politikave.

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (KKMDF)

KKMDF është organ këshillimor ad hoc, i ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr. 238, dt 11.12.2013 "Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve".

Këshilli kryesohet nga Ministri i MMSR dhe përbëhet nga:

- Ministri i Punëve të Brendshme;
- Ministri i Arsimit dhe Sportit;
- Ministri i Drejtësisë;
- Ministri i Shëndetësisë;
- Ministri i Integritimit Evropian;
- Ministri i Financave;
- Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;
- Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Avokati i Popullit;
- 1 përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive;
- 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

Roli i KK MDF është i rëndësishëm për të siguruar dhe reflektuar rregullisht sesi po arrihen rezultate dhe progres, që fëmijët të jetojnë të sigurt, të shëndetshëm, të gëzuar dhe me shpresë për të ardhmen. KK MDF nëpërmjet një qasjeje të koordinuar ndër-sektoriale synon bashkëpunimin si nga institucionet shtetërore por edhe nga shoqëria civile për të punuar më fort për respektimin dhe në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Pas një procesi konkurrimi të hapur janë përzgjedhur organizatat Koalicioni "Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve" dhe shoqata "Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar", si përfaqësuese të shoqërisë civile në KK MDF. Mandati i anëtarëve të KK MDF është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.

Tashmë me anëtarë të rinj, KK MDF zhvilloi mbledhjen e dytë në 3 tetor 2014, për të diskutuar për domosdoshmërinë e ndërmarrjes së nismave konkrete për të respektuar të drejtat dhe jetën e fëmijëve në Shqipëri, si edhe sfidat për realizimin e këtyre të drejtave. Duke marrë në konsideratë situatën aktuale në vend, rekomandimet e Raportit Periodik Universal, dhe treguesit e prioritetit 5 (Udhërrëfytyesi për Integrimin Evropian), u evidentuan përparësitë në ndërhyrje të lidhura me fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë miratimin e Protokollit për Mbrojtjen dhe Kujdesin për Fëmijët, buxhetimin me fokus fëmijët, dhe koordinimin funksional të strukturave vendore.

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës

Ministri që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili koordinon, me të gjitha ministratë përgjegjëse çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Për arsye të rolit dhe funksionit që kanë ministrat në kabinetin qeveritar, në qeverinë aktuale këtë pozicion e mban Ministri i MMSR, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse që ka për këtë qëllim harton politika dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, dhe nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Nismat e shumta që janë ndërmarrë me iniciativën e Ministrisë të MMSR janë shtjelluar në kapitujt përkatës e veçanërisht në kapitullin e mbrojtjes sociale. Gjatë kësaj periudhe Ministri i MMSR i ka dhënë prioritet dëgjimit të zërit të fëmijëve për çështje që i përkasin atyre dhe kanë ndikim në jetën e fëmijëve. Ministri në bashkëpunim me Agjencinë⁸ kanë organizuar 5 takime e dëgjesa me fëmijë të moshave dhe grupeve të ndryshme të interesit, me të cilët kanë diskutuar rreth shqetësimeve të tyre, por edhe për çështje të rëndësishme, si buxheti i aktiviteteve dhe shërbimeve të nevojshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve për vitet 2014 dhe 2015.

⁸ 13 dhjetor 2013, Dëgjese me fëmijët për buxhetin e MMSR, për çështjet e fëmijëve, në MMSR
19 nëntor 2013, Takim i ministrave të MMSR, MSH, MAS, MB me fëmijët dhe diskutim mbi problematikat që i shqetësojnë ata, në MMSR
27 maj 2014, Seancë dëgjimore me fëmijët dhe deputetët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë,
1 Qershor 2014, Takim dhe diskutim me fëmijët i ministrit të MMSR, në kuadër të 1 Qershorit
19 Nëntor 2014, Dëgjese me fëmijët dhe Ministrin e MMSR, zëvendësministren e MAS, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, për buxhetin 2015

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF)

ASHMDF është person juridik, në varësi të MMSR. Ky është institucioni kyç i cili ka për qëllim monitorimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe koordinimin e veprimeve mbi mbrojtjen e fëmijëve.



Agjencia Shtetërore
për **Mbrojtjen** e të
Drejtave të **Fëmijëve**

Femijet.gov.al

Që prej vitit 2014, ASHMDF ka një menaxhim të ri, të fokusuar tek përforsimi i rolit pro-aktiv koordinues të institucionit për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Kjo frymë e re është reflektuar dhe në një imazh të ri të Agjencisë, me një logo të re dhe një faqe të re të ndërtuar në internet.

Në përputhje me rekomandimet e KDF, ASHMDF ka përforsuar rolin e saj koordinues për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. Një prej prioriteteve kryesore të ASHMDF për 2013-2014 ka qenë **ndërtimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve** me vizionin për të shkuar drejt një sistemi që ofron mbështetje, sipas një qasje multidisiplinare për plotësimin e nevojave të fëmijës dhe familjes. ASHMDF ka zbatuar, në bashkëpunim me partnerët e saj, një sërë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të njësive për fëmijët në nivel vendor (NJMF dhe NJDF) si dhe përforsimit të ndërhyrjes multidisiplinare, për të siguruar mbrojtjen e vazhdueshme të të gjithë fëmijëve. Në këtë kuadër, ASHMDF ka marrë përsipër koordinimin e zbatimit të Planit të Veprimit *“Ndihamë për familjet dhe fëmijët në situatë rruge”*, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis MMSR dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe disa OJF. Si pjesë e këtij plani, ASHMDF ka ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësuese për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi për lypje dhe për punë, e cila u lançua më 12 qershor, dita botërore kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë.

ASHMDF i ka dhënë më shumë rëndësi në 2013-2014 rritjes së **ndërgjegjësimin të përgjithshëm mbi të drejtat e fëmijëve** dhe përforsimit të mekanizmave të **pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të fëmijëve** në vendimmarrje në nivel qendror, për të sjellë zërin e fëmijëve pranë institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse për realizimin e të Drejtave të Fëmijëve. Në kuadër të festës së 1 qershorit, festës ndërkombëtare të fëmijëve, ASHMDF organizoi aktivitetin *“Dita ime, të drejtat e mia”* Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të dëgjohej zëri i fëmijëve, të rritej ndërgjegjësimi për fëmijët si subjekte me të drejta të plota dhe pjesëmarrja e tyre të ishte domethënëse. Në qendër të aktivitetit u zhvillua një bashkëbisedim, mes përfaqësuesve të qeverisë shqiptare dhe fëmijëve, të cilët ndanë mendimet e tyre lidhur me çështjet që i shqetësojnë.

Një seancë dëgjimore në prag të 1 qershorit u zhvillua gjithashtu në Komisionin Parlamentar të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë me fëmijët, për të sjellë zërin e fëmijëve, për shqetësimet e tyre në lidhje me garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, për çështjet që lidhen me ta. ASHMDF ka intensifikuar bashkëpunimin dhe konsultimin me aktorët e shoqërisë civile si pjesë organike e punës së saj.

ASHMDF ka përmbushur gjithashtu detyrimin ligjor të saj, lidhur me **raportimet ndërkombëtare lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijëve**. ASHMDF mori pjesë në delegacionin që u paraqit në Gjenevë në prill 2014 në kuadër të

Mekanizmit të Raportimit Periodik Universal (UPR) dhe ju përgjigj pyetjeve mbi të drejtat e fëmijëve, që zunë një vend të rëndësishëm në shqetësimet e ngritura nga vendet anëtare të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.


ASHMDF përfaqëson shtetin Shqiptar dhe ka raportuar pranë Komitetit Monitorues të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual, Komiteti i Lanzarotes. Që prej prillit 2014, Shqipëria është anëtare e Bordit Drejtues të Komitetit të Lanzarotes. Së fundmi, ASHMDF ka përfaqësuar Shtetin Shqiptar në Komitetin, që do të hartojë Strategjinë e re të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve, ku është përzgjedhur në vendin e Zv. Presidencës së Komitetit.

Mekanizmat në nivel vendor

Ligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” synon të përmirësojë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, duke institucionalizuar Njësitë e Mbrojtjes dhe të të Drejtave të Fëmijës (NJDF) si struktura të nivelit vendor, të cilat përgjigjen për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor. NJDF funksionon brenda strukturës administrative të Këshillit të Qarkut, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale. Aktualisht janë ngritur dhe funksionojnë **12 NJDF** në të gjithë qarqet e vendit.

NJDF ka qenë një nxitje e rëndësishme për strukturat e qeverisjes vendore, në marrjen e përgjegjësisë për mbrojtjen e fëmijëve duke rritur ndjeshëm numrin e NJMF-ve të reja.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë, të identifikojë dhe menaxhojë rastet e fëmijëve në rrezik, që ndodhen brenda zonës ku kjo njësi shtrin juridiksionin e saj. Aktualisht në të gjithë vendin janë ngritur dhe funksionojnë **196 NJMF**.




Burimi: ASHMDF

Duke konsideruar që në vitin 2010 kur u miratua Ligji “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” në të gjithë vendin ishin ngritur vetëm 16 NJMF, ndërsa sot janë

ngritur 196 NJMF në të gjithë vendin, vlerësohet, se procesi i ngritjes së NJMF ka ecur me ritme të shpejta.


Aktualisht rreth 51% e territorit të vendit, mbulohet me shërbimin e NJMF-ve. Progresi në ngritjen e Njësive nuk ka qenë i njëjtë për të gjithë qarqet. Qarqet si Vlorë dhe Durrës kanë mbuluar pothuajse të gjithë territorin e tyre me këtë shërbim, ndërsa Gjirokastra dhe Shkodra kanë mbulim të vogël, respektivisht 3% dhe 15% të territorit. Numrin më të madh të NJMF të ngritura e ka qarku i Elbasanit, me rreth 35 NJMF.



Burimi: ASHMDF

Për periudhën raportuese 2013-2014, është e rëndësishme, të përmendet ngritja dhe funksionimi i NJMF të reja në bashkinë e Tiranës dhe qarkun e Korçës. Ndonëse me vonesë, Bashkia e Tiranës mundësoi ngritjen e 10 NJMF të reja në secilën Njësi Bashkiake. Qarku i Korçës ishte qarku i fundit që ngriti NJMF në vitin 2013 dhe sipas tabelës së mëposhtme vërehet një rritje e menjëhershme e numrit të NJMF të reja të këtij qarku nga 2013 në 2014.

Numri i NJMF sipas Qarqeve per vitet 2013 dhe 2014



Burimi: ASHMDF

Një sërë aktivitete janë zbatuar nga ASHMDF në bashkëpunim me partnerët për **përforcimin e kapaciteteve** të mekanizmave në nivel vendor lidhur me mbrojtjen e fëmijëve por edhe me tematika të ndryshme, siç janë regjistrimi ligjor i fëmijëve të paregjistruar, menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik, puna me fëmijët në situatë rruge, shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimet seksuale, puna multidisiplinare për mbrojtjen e fëmijëve.

Trajnimet kanë përfshirë gjithashtu edhe profesionistë të fushave të ndryshme, si punonjësit e policisë, prokurorisë, shërbimeve sociale, zyrtarë të punës, organizatave jo qeveritare, etj., të cilët kanë një rol për të luajtur në mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të një qasjeje multisektoriale të mbrojtjes. Në total **rreth 250** profesionistë janë trajnuar në kuadër të aktiviteteve të ASHMDF. Shumë aktivitete të ngjashme janë zhvilluar edhe nga organizatat jo qeveritare.

Një hap i madh përpara në profesionalizimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, është realizimi i kursit për *“Çështjet e Mbrojtjes së Fëmijëve”*, i cili është zbatuar, sipas një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet MMSR, Ministrisë së Brendshme, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe një grup organizatash. Ky është kursi i parë profesional për mbrojtjen e fëmijëve dhe në 2014 u diplomuan 20 punonjësit e parë për mbrojtjen e fëmijëve.

Është e rëndësishme, të krijohet një rrjet profesionistësh të mbrojtjes së fëmijëve, të cilët ndajnë eksperiencat e tyre dhe mundësojnë një mbështetje horizontale në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. Për këtë qëllim, në shtator 2014, ASHMDF organizoi një takim dy ditor me temë *“Forcimi i rrjetit të mbrojtjes së fëmijëve”*.

Mirëfunksionimi i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve varet veçanërisht nga autoritetet vendore, të cilët duhet të njohin rolin dhe përgjegjësitë e tyre, për të siguruar kujdes dhe mbrojtje për fëmijët dhe të koordinojnë veprimet e tyre me aktorët e tjerë vendorë të angazhuar në çështjet e mirëqenies së fëmijëve.

Drejtuesit e pushtetit vendor, jo në pak raste nuk i japin rëndësinë e duhur emërimit të një punonjësi të posaçëm për NJMF. Ndonëse brenda përcaktimeve ligjore, në komuna dhe disa bashki të vogla, roli i NJMF i mbivendoset rolit të administratorit shoqëror. Rrjedhimisht duke iu ngarkuar disa detyra njëherësh, ngarkesa e punës është më e madhe dhe koha për t’ju kushtuar rolit si NJMF është më e kufizuar. Aktualisht janë 32 NJMF që kanë vetëm këtë funksion, ndërsa 164 NJMF janë edhe administratorë shoqërorë. Për më tepër, ndryshimi i drejtuesve të institucioneve vendore: bashki, komunë, qark, ka sjellë edhe ndryshim të punonjësve të NJDF dhe NJMF. Duke vlerësuar rolin dhe përgjegjësinë që këto struktura kanë në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët dhe familjet e tyre, kjo problematikë bëhet dhe më e ndjeshme. Ndryshimet e shpeshta pengojnë krijimin e një modeli të qëndrueshëm, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si një element i rëndësishëm në zhvillimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e tyre. Në këto raste ndryshimet e punonjësve, kërkojnë rikualifikim dhe rritje kapacitetesh të tjera. Shpeshherë mungesa e eksperiencës apo edhe e kualifikimit për punonjësit e rinj reflektohet edhe në produktivitetin e punës së tyre.

Çështje për adresim

Dispozitat ekzistuese ligjore duhen të vlerësohen dhe harmonizohen me Ligjin mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe standardet e tjera ndërkombëtare të njehsuara në instrumentet ndërkombëtarë për të drejtat e fëmijës.

Të forcohen përpjekjet për të siguruar që parimi i interesave më të lartë të fëmijës është i integruar në mënyrë të përshtatshme dhe të aplikohet në mënyrë konsistente në të gjitha procedurat, politikat, programet dhe projektet përkatëse në lidhje dhe me ndikim për fëmijët.

KKMDF duhet të vazhdojë, të ushtrojë funksionet e tij në mënyrë të rregullt, sipas afateve kohore të përcaktuara në legjislacion, duke monitoruar punën mbi të drejtat e fëmijëve dhe nxitur bashkëpunimin ndërmjet ministrive përgjegjëse, nivelit vendor dhe organizatave jo-qeveritare.


Përforcimi i rolit koordinues dhe monitorues i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e cila duhet të ketë autoritet dhe kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare për të koordinuar në mënyrë efektive veprimet, ndërhyrjet për të drejtat e fëmijëve në nivel kombëtar dhe vendor.

Ngritja e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, duhet të jetë një detyrim ligjor për njësitë e reja administrative, që do të formohen si rezultat i reformës territoriale. Bashkitë duhet gjithashtu të sigurojnë burime të nevojshme financiare, lidhur me shërbimet për fëmijët. Bashkitë e reja duhet të ruajnë kapitalin njerëzor të krijuar gjatë viteve të fundit dhe të fuqizojnë NJMF e mirëfillta me më shumë se 1 staf.

Hartimi i buxheteve institucionale transparente dhe pjesëmarrëse përmes dialogut publik, sidomos me pjesëmarrjen e fëmijëve për të mbështetur me burime përmbushjen e të drejtave të fëmijëve.

Përmirësimi i sistemit të të dhënave për vlerësimin e progresit të arritur në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Të merren masa më aktive, për të promovuar konventën për të drejtat e fëmijëve dhe protokollet e aprovuara, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi mbi të drejtat e fëmijës tek institucionet, publiku i gjerë dhe fëmijët në veçanti.



Kontributi i Fëmijëve⁹

Pse është mirë të jesh fëmijë në kohën e sotme?

Ndihem i lirë për të vepruar në situata të ndryshme - nuk ke shumë përgjegjësi mbi vete.

Je më i mbrojtur nga familja e nga shteti.

Je ndryshimi i së ardhmes - konsiderohesh si shpresa për të ardhmen.

Kam një shpresë pozitive, se do të jem unë ajo, që do të sjell ndryshime në të ardhmen.

Ndihem në kulmin e aftësive mendore dhe fizike - në kulmin e zhvillimit dhe energjive.

Kur je i ri ke më pak komplekse.

E re do të thotë, që ke të drejtë, për t'u argëtuar e luajtur më shumë se të rriturit.



Pse nuk është mirë të jesh fëmijë në kohën e sotme?

Nuk merren për bazë mendimet tona, ndihemi keq për këtë.

Mungesë lirie për gjithçka që duam.

Të drejtat tona shkelen shumë lehtësisht.

Të gjithë mendojnë, se ne nuk kemi eksperiencën e duhur për të kontribuar.

Nuk kemi mundësi, për t'u argëtuar, të kufizuar për të luajtur e shpalosur talentet.

Ndihemi vulnerabël ndaj dhunës apo dhe padrejtësive.

Prindërit e mi nuk janë në punë.

Në rast se do të kishim probleme, nuk dimë ku mund të shkojmë për ndihmë.

⁹ Grup diskutimi drejtuar nga ASHMDF me 30 të rinj të mbledhur në datë 4 nëntor 2014, në Elbasan, lehtësuar nga Save the Children

II. E DREJTA PËR FAMILJE DHE MBROJTJE SOCIALE

E drejta për familje dhe mbrojtje sociale është një nga të drejtat themelore e përcaktuar qartazi edhe nga instrumente të rëndësishëm ndërkombëtar. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, nëpërmjet nenit 27, sanksionon të drejtën e të gjithë fëmijëve, për të pasur një minimum të pranueshëm jetese. Neni 26 përcakton detyrimin e shteteve anëtare që të realizojnë të drejtën e fëmijëve dhe familjeve për siguri dhe mbrojtje sociale në përputhje me legjislacionet kombëtare. Komiteti për të Drejtat e Fëmijës komenton se *“rritja në varfëri dëmton mirëqenien, përfshirjen sociale e vetëbesimin, dhe zvogëlon dukshëm mundësitë për të mësuar dhe për t’u zhvilluar. Të gjitha mjetet e mundshme duhen të përdoren, përfshirë ndihmën materiale dhe programe mbështetëse për fëmijët dhe familjet, në mënyrë që fëmijët të kenë një standard jetese sipas të drejtave të tyre.”*

Situata

Të dhëna të lidhura me situatën e fëmijëve

Ndjekja dhe monitorimi i treguesve të mbrojtjes sociale dhe nivelit të përjashtimit të social të fëmijëve është i vështirë, pasi aktualisht në Shqipëri mungon mbledhja dhe përpunimi sistematik i të dhënave për fëmijët në kushte/situata të vështira. Studime, vlerësime apo dokumentime të ndërhyrjeve apo programeve të ndryshme sjellin në vëmendje, se shumë fëmijë janë të rrezikuar ndaj varfërisë, abuzimit, shfrytëzimit, apo dhunës. Ky kapitull do të paraqesë një përmbledhje të të dhënave duke treguar faktorët e rrezikut, me të cilët ekspozohen fëmijët shqiptarë.

Varfëria është një nga shkaqet kryesore të përjashtimit social. Sipas të dhënave të fundit të LSMS 2012¹⁰, varfëria në Shqipëri është rritur, nga 12.4% në 2008 në 14.3% në vitin 2012; gjithashtu normat e rritjes makroekonomike janë ulur duke dëshmuar, se Shqipëria është prekur nga kriza globale financiare. Pjesa e popullsisë, konsumi mujor real për frymë i së cilës është nën 4.891 Lekë (me çmimet e vitit 2002), u rrit. Për herë të parë, varfëria është rritur më shumë në zonat urbane dhe shifrat tregojnë se shkalla e varfërisë është ulur në zonat malore të cilat kanë pasur gjithmonë tregues të lartë varfërie. Kjo ulje mund të jetë si pasojë e lëvizjeve të popullsisë dhe vazhdimit të lëvizjeve nga zonat malore drejt rajoneve të tjera. CENSUS 2011 tregon se për herë të parë në Shqipëri popullsia urbane është më e lartë se ajo rurale, duke përfaqësuar 53,7 % të popullsisë. Hendeku i varfërisë dhe ashpërsia e varfërisë kanë pësuar gjithashtu rritje nga viti 2008. Përqindja e fëmijëve që jetojnë në varfëri absolute është 20.1 %. Në zonat rurale kjo përqindje është më e madhe me 21.4%, ndërsa në zonat urbane 18.9%. Familjet me më shumë se 4 fëmijë, kanë përqindjen më të lartë të varfërisë në vend, rreth 49.6%, ndërsa fëmijët e grupmoshës 0-4 vjeç, zënë përqindjen më të lartë të fëmijëve, që jetojnë në varfëri absolute, 22%¹¹.

Varfëria përbën faktor rreziku dhe është një nga shkaqet bazë të shumë fenomeneve. Prania e **fëmijëve në situatë rruge**, duke lypur, jetuar apo duke punuar në rrugë, është bërë tashmë një fenomen shumë shqetësues. Ata jetojnë

¹⁰ Shqipëria: Trendi i Varfërisë”, botim i INSTAT, shtator 2013

¹¹ Shqipëria: Trendi i Varfërisë”, botim i INSTAT, shtator 2013

në kushte të papranueshme fizike e sociale, nuk janë në shkollë dhe shpeshherë janë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit. Për herë të parë në Shqipëri në vitin 2013-2014 u zhvillua një studim në shkallë kombëtare për të vlerësuar fenomenin. Të dhënat tregojnë se 2527 fëmijë jetojnë në situatë rruge në Shqipëri dhe mbi 700 prej tyre janë vetëm në Tiranë¹². Djemtë e moshës 10 – 17 vjeç përbëjnë numrin më të madh, duke qenë edhe dyfish më i madh sesa ai i vajzave. Për fëmijët më të vegjël shihet një shpërndarje më e barabartë ndërmjet gjinive. Rreth një e treta e fëmijëve në situatë rruge janë adoleshentë të moshës 15 – 17 vjeç, ndërkohë që fëmijët ndërmjet moshës 4-14 vjeç përbëjnë shumicën. Shqetësues është fakti, se 4% e të gjithë fëmijëve në situatë rruge, janë foshnja të moshave nga 0–3 vjeç, ata zakonisht shoqërojnë nënat, por ka raste kur lihen vetëm pa mbikëqyrje. Shumica e fëmijëve i përkasin komuniteteve Rome dhe Egjiptiane¹³.

Përveç fëmijëve në situatë rruge, kemi edhe fëmijë, të cilët janë të detyruar të punojnë, për të ndihmuar familjet, të dalin nga varfëria. Ndonëse të dhënat për **fëmijët e punësuar** në sektorin formal të ekonomisë mund të mblidhen nga të dhënat administrative të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (IShPShS), të dhënat për pjesën tjetër të fëmijëve, që punojnë mund të mblidhen vetëm nëpërmjet studimeve dhe anketimeve. Sipas të dhënave nga IShPShS për vitin 2014, në sektorin formal të ekonomisë janë punësuar rreth 114 fëmijë. Shumica e fëmijëve të punësuar janë femra të moshës 17 vjeç. Shumica e fëmijëve kanë arsimin 9 vjeçar dhe janë punësuar në ndërmarrjet prodhuese.

Në minierat e Bulqizës ka 32 fëmijë që mbledhin krom¹⁴; përgjithësisht nuk bëhet fjalë për raste shfrytëzimi të fëmijëve nga të tretë, por për fëmijë që dalin për të mbledhur krom për nevojat e familjes apo nevojat e tyre, ndonëse shumë adoleshentë e shfrytëzojnë këtë veprimtari për lekë xhepi, madje edhe për të blerë cigare ose alkool. Studimi i parë kombëtar i kryer nga INSTAT (Instituti i Statistikave) dhe ILO/ IPEC në 2010 mbi punën e fëmijëve, vlerësoi se 8.2 % e 5-17 vjeçarëve janë ekonomikisht aktivë.

Ndërkohë që të dhënat paraprake¹⁵ të një studimi tregojnë, se gati 22,5 % të djemve 15 – 17 vjeç dhe 14,5% të vajzave të po asaj moshe deklarojnë, se janë aktualisht në punë.

Një kategori e veçantë fëmijësh që kanë nevojë për mbrojtje sociale, janë edhe **fëmijët në lëvizje**¹⁶, një term që përmbledh kategoritë e fëmijëve nga familje të emigruara, fëmijët në situatë rruge, fëmijët e trafikuar dhe ata Romë dhe Egjiptianë. Fëmijët në lëvizje në Shqipëri përbëjnë një kategori jo gjerësisht të identifikuar dhe të adresuar. Përgjithësisht, shërbimet aktuale të mbrojtjes nuk plotësojnë nevojat e fëmijëve në lëvizje.

Fëmijët në Shqipëri përballen me forma të ndryshme të dhunës në familje, në shkollë në komunitet. Dhuna në familje ndikon negativisht gratë dhe fëmijët. Dhuna psikologjike është forma e dhunës, që raportohet më së shpeshti nga fëmijët¹⁷. Rreth 61,69% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës

¹² Fëmijët në situatë rruge – studim kombëtar, ARSIS, GFK, UNICEF, SCiA, 2014

¹³ Fëmijët në situatë rruge – studim kombëtar, ARSIS, GFK, UNICEF, SCiA, 2014


¹⁴ Njësoj si më lart

¹⁵ "buxhetimi për fëmijët" studim që po kryhet nga Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me mbështetje të Save the Children

¹⁶ Terre des Hommes dhe Save the Children in Albania janë duke punuar në këtë fushë

¹⁷ Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B. (2013), Dhuna ndaj Fëmijëve në Shqipëri. Studimi Epidemiologjik në Ballkan mbi Abuzimin e Fëmijëve dhe Neglizhencën (BECAN), CRCA Shqipëri, Tiranë.

psikologjike një herë në jetën e tyre. Por po aq e lartë është edhe dhuna fizike; 48,42% e fëmijëve kanë përjetuar të paktën një formë të dhunës fizike gjatë jetës së tyre, dhe 59,45% e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike gjatë vitit të kaluar. 11.4% e fëmijëve kanë përjetuar ngacmim seksual dhe 4.88% e fëmijëve dhunë seksuale me kontakt, të paktën një herë gjatë jetës së tyre.



Sipas një studimi të fundit mbi **sigurinë e fëmijëve online**¹⁸, 85% e fëmijëve 13-18 vjeç kanë akses në internet nëpërmjet një kompjuteri në shtëpi, që në shumicën e rasteve gjendet në dhomat e tyre. Internet kafetë janë gjerësisht të aksesueshme si në zonat rurale dhe ato urbane. 44 % e fëmijëve përdorin internetin për të shikuar material pornografik çdo ditë. Vetëm gjatë vitit të fundit 47 % e 13-18 vjeçarëve janë kontaktuar në internet nga persona të panjohur që në 40 për qind të rasteve, ishte një i huaj. Vërehet nivel i ulët i informimit të fëmijëve lidhur me shkëmbimin e informacionit të sigurt në internet dhe strukturave përgjegjëse ku duhet të raportojnë incidentet online. Familjarët dhe miqtë janë personat e parë ku fëmijët raportojnë një problem, ndërkohë që mësuesit dhe punonjësit e policisë janë figurat që ka më pak të ngjarë që fëmijët të drejtohen për ndihmë e të raportojnë.

Mbulimi me shërbime

Sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Shqipëri ofron mbështetje ekonomike si pagesa në *kesh* për familjet e varfra dhe individët me aftësi të kufizuara, si dhe shërbime shoqërore, kryesisht shërbime rezidenciale për fëmijët e braktisur dhe me probleme sociale. Sipas të dhënave administrative për vitin 2014¹⁹, 132.000 fëmijë të varfër janë në përbërje të familjeve përfituese të Ndihmës Ekonomike. Numri më i madhe i familjeve me fëmijë që përfitojnë nga skema ekonomike janë në zonat veriore si Kukës dhe Dibër, dhe më pak në Durrës dhe Tiranë.

Rreth 17,698 fëmijë me aftësi të kufizuara, marrin shërbimet dhe pagesat e nevojshme të përcaktuara nga legjislacioni. Nga këta, rreth 9345 fëmijë janë të regjistruar në sistemin arsimor. Ligji i ri për aftësinë e kufizuar, i miratuar në 2014, krijon kushtet e nevojshme për respektimin e barabartë të të drejtave të të gjithë grupimeve të personave me aftësi të kufizuara, duke përafruar legjislacionin

¹⁸ Studim për sigurinë në rrjet të fëmijëve, World Vision (2014)

¹⁹ Të dhënat administrative të Shërbimit Social Shtetëror

shqiptar me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Ligji i ri jep një përkufizim bazë dhe unik të personit me aftësi të kufizuara, bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar për Funksionimin, Aftësitë e Kufizuara për Shëndetin (ICF), si standard të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Gjithashtu përpjekje po bëhet për të reformuar komisionet e vlerësimit dhe diagnostikimit të aftësisë së kufizuar në mënyrë që të merren masa për trajtimin e plotë të paaftësisë dhe ndikimin e saj në jetën e fëmijës dhe familjes.

Megjithatë ende mbetet sfida lidhja e pagesave me sistemin e shërbimeve të mbrojtjes sociale, dhe kjo jo vetëm për fëmijët e varfër apo me paaftësi. Shifrat e dhëna nga harta e shërbimeve sociale tregojnë se numri i ofruesve të shërbimeve është rritur nga 120 në 2007 në 187 shërbime në vitin 2012, megjithatë prapë nuk janë vendosur ende mekanizmat për të lidhur elementët e ndryshëm të mbrojtjes sociale në mënyrë që të ketë një trajtim tërësor të rasteve të fëmijëve dhe familjeve në nevojë.

Rrjeti i **shërbimeve të përkujdesit** është në reformim e sipër dhe aktualisht targeton kategori të ndryshme të fëmijëve. Rrjeti i shërbimeve të përkujdesit është në fokus të veprimtarisë institucionale të Shërbimit Social Shtetëror:

- Fëmijët jetim dhe të braktisur;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara (mendore & fizik);
- Fëmijët viktime të dhunës;
- Fëmijët /minoret viktime të trafikimit;
- Fëmijë nga familje me probleme sociale;
- Fëmijë në situatë rruge;
- Fëmijët e riatdhesuar.

Në mbështetje të fëmijëve jetimë, të braktisur dhe të ardhur nga familje me probleme sociale, funksionon rrjeti i institucioneve të përkujdesit social i cili është i strukturuar në:

- Qendra rezidenciale për fëmijë;
- Qendra të Riaftësisimit dhe Zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Qendra Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Qendra të pritjes dhe rehabilitimit të minoreneve të trafikuar, dhe viktimave të dhunës;
- Qendra ditore dhe në mbështetje të fëmijëve në nevojë;
- Qendra Transitore e Emergjencës.

Gjatë periudhës maj 2013- prill 2014, në rrjetin e Institucioneve publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror janë trajtuar:

- 596 fëmijë – institucione rezidenciale përkujdesi për fëmijë, nga këto:
 - 287 fëmijë (në 9 institucionet rezidenciale publike);
 - 309 fëmijë (në 12 institucionet rezidenciale jopublike OJF- të);
- 4697 fëmijë në shërbim ditore/komunitare të OJF-ve, nga këto (Buletini Statistikor i SHSSH – 2013);
 - 72 fëmijë (në qendrat ditore në 3 institucione publike për fëmijë Durrës, Shkodër dhe Sarandë);
 - 102 fëmijë të trajtuar gjithsej në 4 “Qendrat Pritëse të Viktimave

të Trafikimit “dhe 1 “Qendër Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës”;

50 Fëmijë më Aftësi të kufizuar të trajtuar në 6 Qendrat e Zhvillimit Publike dhe 45 fëmijë në 3 qendrat ditore për PAK. 40 fëmijë në 5 Qendrat Rezidenciale Jopublike – OJF, për Persona me Aftësi të Kufizuar.

Nevoja për të sistemuar fëmijët është e lartë: në institucionet rezidenciale të përkujdesit për fëmijë vetëm gjatë periudhës janar - dhjetor 2013, janë komisionuar dhe sistemuar 117 fëmijë, nga të cilët 100 fëmijë në institucione publike dhe 17 fëmijë në institucione jopublike.

Ndryshe nga shumë vite më parë, këtë vit numri i fëmijëve të braktisur në maternitetet ka qenë më i lartë, 41 fëmijë të cilët janë vendosur të gjithë në institucionet rezidenciale. Shqetësues është fenomeni i fëmijëve të ashtuquajtur fëmijë jetim social, të cilët nuk braktisen nga prindërit por nuk rrinë dot pranë familjes për shkaqe të ndryshme: 76 fëmijë të tillë janë sistemuar në institucionet e përkujdesit në vitin 2013. Gjatë vitit 2013 janë rikthyer nga institucionet publike dhe jopublike në familjet biologjike rreth 50 fëmijë, gjithashtu janë realizuar 46 birësime të fëmijëve nga institucionet publike dhe jopublike të përkujdesit.

Vitet e fundit janë bërë përpjekje për të punuar për një koncept të ri të mbrojtjes së fëmijëve transformimi i qendrave rezidenciale në modelin **“Shtëpi-familje”**. Shtëpia-familje është një alternativë e vlefshme për shmangien e pasojave të institucionalizimit të fëmijëve dhe të jetesës në mënyrë kolektive. Karakteristikë e veçantë e shtëpisë-familje është krijimi i elementëve pozitiv që përbëjnë modelin e familjes natyrore në mënyrë që çdo person/fëmijë të gjejë tek ajo, situatën optimale të strehimit, sigurisë, ngrohtësi njerëzore, solidaritet, të cilat janë të nevojshme për një rritje personale harmonike. Aktualisht funksionojnë dhe janë transformuar gjatë viteve të fundit, 2 qendrat rezidenciale për fëmijë në modelin Shtëpi- Familje; “ Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Durrës” ku trajtohen 20 fëmijë në dy “ Shtëpi familje” dhe “ Shtëpia e Fëmijës 6-16 vjeç Zyber Hallulli “- Tiranë e transformuar në 4 apartamente për 46 fëmijë rezidenciale. Gjithashtu si pjesë e rrjetit të shërbimeve rezidenciale për fëmijë janë edhe qendrat rezidenciale jo publike OJF që ofrojnë këtë shërbim të formës “Shtëpi Familje” për fëmijët në nevojë si më poshtë:

SOS- Fshatrat e Fëmijëve- Tiranë	69 fëmijë
SFI- Rreze Dielli – Tiranë	08 fëmijë
“ Orët Fatlume” – Elbasan	29 fëmijë
Vatër e Ngrohtë – Gjirokastrë	14 fëmijë
Fillimet e Reja – Tiranë	13 fëmijë
Misioni Katolik “Bijat e Dashurisë” – Mollas Elbasan	07 fëmijë
Komuniteti “ Papa Giovanni XXIII’- Shkodër	20 fëmijë

Shërbimi i kujdestarisë së përkohshme është i ri për Shqipërinë. Organizimi dhe ofrimi i këtij shërbimi përbën një reformë në fushën e shërbimeve sociale, bazuar në Strategjinë dhe Standardet për shërbimin e kujdestarisë për fëmijët të cilëve u mungon kujdesi prindëror. Aktualisht këtë shërbim e kanë përfituar 100 fëmijë

në gjithë vendin²⁰. Nga analizimi i të dhënave të disponueshme evidentohet se shërbimi i kujdestarisë ofrohet kryesisht nga familjet me lidhje biologjike me fëmijën (të afërm).

Shërbimi kufizohet nga mungesa e kapaciteteve në disa nivele të ofrimit, mbështetja në kujdesin rezidencial, si edhe mendësia e përgjithshme e popullatës lidhur me shërbimin.

Për periudhën maj 2013 – maj 2014, përmes procedurave të zbatuara nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB) janë **birësuar** 41 fëmijë. Monitorimi i rregullt i institucioneve rezidenciale të fëmijëve ka evidentuar problematika në dokumentimin e situatës reale shëndetësore dhe atë të zhvillimit të fëmijës. Prezantuar si një mekanizëm monitorues dhe vlerësues në vazhdimësi i procesit të birësimit në interesin më të lartë të fëmijës, KSHB ka kryer **50 raporte pasbirësuese**, pranë familjeve shqiptare.

Ecuria

Mbrojtja sociale

Qeveria është duke ndërmarrë disa reforma rrënjësore që synojnë të rrisin efikasitetin e skemave të mbështetjes si dhe synojnë të ofrojnë mbështetje tërësore për familjen duke u bazuar edhe në modele dhe praktika ekzistuese.

Skema e Ndhmës Ekonomike (NE) po reformohet në mënyrë që të identifikohen më mirë familjet në nevojë, si dhe të përjashtohen rastet abuzive në mënyrë që ndihma t'i shkojë atyre familjeve që e meritojnë. Skema e re po pilotohet fillimisht në Elbasan, Tiranë dhe Durrës, e në një fazë të dytë, do të shtrihet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pilotimi i skemës ekonomike me kriteret e reja ka bërë që abuzimet të ulen. Tabela e mëposhtme tregon se gjatë muajve të pilotimit (maj – qershor 2014) është ulur ndjeshëm numri i familjeve përfituese duke treguar se shkalla e abuzimit ka qenë e lartë. Duke rritur efikasitetin e skemës, më tepër fonde do të jenë në dispozicion të qeverisë për të përmirësuar shërbimet për këto familje.

Emërtimi	Viti 2012	Viti 2013	maj-qershor 2014
Familjet me fëmijë që marrin N.E.	74,21	77,172	61,282
Numri i fëmijëve në familje me NE	171,812	184,723	132,410


Skema e ndihmës ekonomike gjithashtu synon që të përmirësojë disa nga kushtet e mirërritjes së fëmijëve. Sipas VKM Nr. 376, datë 11.6.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", të ndryshuar, fëmijët e familjeve të varfra, të përfshira në skemën e NE, marrin një pagesë shtesë prej 300 lekë në muaj gjatë periudhës që ndjekin shkollën dhe 100 lekë për çdo vaksinë të kryer sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit.

²⁰ Të dhënat administrative të Shërbimit Social Shtetëror


Shërbimet e përkujdesjes sociale


MMSR ka ndërmarrë një reformë në sistemin e shërbimeve sociale që synon forcimin dhe fuqizimin e të gjitha niveleve të qeverisjes për të planifikuar, buxhetuar dhe monitoruar shërbime shoqërore të integruara që i përgjigjen nevojave reale të fëmijëve. Në këtë kuadër, hapa janë marrë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit në institucione ekzistuese, por njëkohësisht po punohet për të nxitur deinstitucionalizimin e sistemit rezidencial të kujdesit. Reforma ka si qëllim të transformojë shërbimet rezidenciale në tipologji të tjera shërbimesh si: shtëpi – familje dhe ngritjen e tipologjive të reja të shërbimeve si kujdestaria, shërbime komunitare.

Nga krahasimi i të dhënave për periudhën kohore 2012- 2014 vërehet që ka rritje të vogël të numrit të fëmijëve të vendosur në institucionet publike dhe jo publike (nga 129 në 139). Të dhënat mbledhen për periudha të caktuara kohëzgjatje: qëndrimi i fëmijëve në institucione për 1-2 vjet dhe 10 vjet. Lajmi i mirë është se të dy treguesit kanë ulje për institucionet publike: 115 fëmijë kanë qëndruar për 1-2 vjet në 2014 krahasuar me 121, dhe 14 kanë qëndruar për 10 vjet në 2014 krahasuar me 41 në 2012. Vërehet rritje për fëmijët që kanë ndenjtur 1-2 vjet në institucionet jo publike nga 39 në 65 fëmijë. Më pak fëmijë të kategorive në nevojë ka patur në institucione. Nuk dihet në se kjo ka ardhur për shkak të uljes së kërkesës, apo uljes së kapaciteteve institucionale.




Për t'u përmendur si një arritje është rritja e numrit të fëmijëve që dalin nga institucionet rezidenciale publike dhe jopublike. Kjo mund të tregojë se masat e marra për të bashkuar fëmijët me familjet, qofshin këto familjet biologjike apo birësuese, po japin efekt.





Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e fëmijëve në institucionet rezidenciale sipas statusit. Shifrat tregojnë se numri i jetimëve në institucionet jopublike është rritur. Kjo mund të sugjerojë ose për mungesë kapacitetesh ose për strategji agresive “reachout” nga institucionet jopublike.



Të dhënat tregojnë se 80 % e fëmijëve në institucione janë jetim social, dhe procesi i rikthimit në familje ka hasur pengesa për shkak të mungesës së vlerësimeve të familjeve nga Administratorët Social në nivelet rajonale dhe fuqizimit të familjes me programe të ndryshme sociale nga pushteti vendor. Në këtë kuadër, DPSHSSH në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetërorë (DRSHSSH) ka marrë nismën për të koordinuar punën dhe veprimet për të identifikuar dhe vlerësuar situatën social-ekonomike të familjeve të fëmijëve të vendosur në institucionet publike me qëllim rikthimin sa më shpejt pranë mjedisit familjar dhe qëndrimin sa më pak në këto institucione. Aktualisht, janë 9 institucionet rezidenciale që kanë dërguar listat e familjeve të fëmijëve të vlerësuar si potencial për rikthim në familje²¹. Në zbatim edhe të “Planit për Deinstitutionalizimin e Fëmijëve” të hartuar nga DPSHSSH, Punonjësit Social të DRSHSSH do të vlerësojnë situatën familjare dhe do të punojnë për fuqizimin e familjes së fëmijëve të vendosur në institucione, në mënyrë që fëmijët të rikthehen në mjedisin familjar, të sigurt për një jetë normale. Gjithashtu pas rikthimit në familje të fëmijëve do të

²¹ Sipas urdhërit me Nr. Prot 601 dt 18.03.2014 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror drejtuar Drejtorive Rajonale për ndjekjen dhe zbatimin e planit për rikthim të fëmijëve në familje biologjike

realizohet edhe monitorimi i tyre në mjedisin familjar nga DRSHSSH.

Për të përmirësuar **monitorimin** e Institucioneve publike dhe jopublike rezidenciale për fëmijë, në DPSHSSH është krijuar një sistem i plotë dhe fleksibël me të dhëna për të gjithë përfituesit në rrjetin e institucioneve rezidenciale, gjë që lejon evidentimin e shpejtë të situatës dhe dinamikën e ndryshimeve në këto institucione. Është aplikuar si metodë e re monitorimi për vlerësimin e cilësisë së shërbimit në këto institucione sistemi i pikëzimit të standardeve të përkujdesit për fëmijë mbështetur në treguesit cilësor. Kjo metodë ka për qëllim vlerësimin sasior me pikë (max 100) për të matur në mënyrë më fleksibël dhe të shpejtë

70% e institucioneve të Përkujdesit Shoqëror për fëmijë, respektojnë standardet dhe kanë përmirësuar cilësinë e shërbimit si:

- Fshati i Fëmijëve SOS Tiranë;
- Shtëpia e Fëmijës Zyber Hallulli Tiranë;
- Qendra SFI, Shtëpi Familje për fëmijë në komunën Pezë Tiranë.
- Qendra Betania Bubq F.Krujë;
- Orët Fatlume Elbasan;
- Bijat e Dashurisë Komuna Mollas Elbasan.

30% e Institucioneve duhet të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve dhe kushtet e jetesës së fëmijëve për të cilat janë lënë detyra. Nga inspektorati janë marrë masa ekstreme për pezullim e veprimtarisë së institucionit (për shembull Shtëpiza e Shpresës Elbasan).

performancën e institucionit. Evidencat statistikore që dërgohen pranë DPSHSSH, çdo muaj dhe një herë në katër muaj si dhe raporte dhe relacione periodike mbi aktivitete e realizuar në këto institucione paraqiten në raportet vjetore dhe Buletinin Statistikore të DPSHSSH. Për një vit janë monitoruar 57 Institucione të Përkujdesit për Fëmijë, nga të cilat 17 rezidenciale dhe 40 ditore.

Në inspektimin e subjekteve publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbime rezidenciale për fëmijë, janë konstatuar që institucionet kanë nevojë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për fëmijë bazuar në standardet e miratuara. Krahasuar me vitet e kaluara ka përmirësim në një pjesë të mirë të qendrave, ku fëmijët dhe prindërit marrin pjesë aktivisht. Vështirësi janë konstatuar në funksionimin e ekipeve multidisiplinare dhe adresimin e nevojave të fëmijëve; ndjekjen dhe

zbatimin e procedurave, për hartimin e planeve të përkujdesit social sipas formatit të miratuar. Ndjekja e procedurave për marrjen e kujdestarisë ligjore me vendim gjykatë sipas udhëzimit Nr. 1934. dt 19.10.2007 ka qenë problem dhe vazhdon të jetë. Për këtë janë propozuar ndryshime në këtë Udhëzim.

Sfidë mbetet një sistem trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm për burimet njerëzore, përfshirë punonjës social, psikolog, infermiere, fizioterapistë, kujdestarë, madje edhe prindërit e fëmijëve.

Shërbime Sociale të reja

Në plotësim të kuadrit të mbrojtjes sociale në Shqipëri, MMSR ka nisur një program trevjeçar për të vendosur bazat e një sistemi të integruar shërbimesh sociale në Shqipëri. Programi synon të institucionalizojë menaxhimin e rastit dhe punonjësin social në komunitete për të vlerësuar dhe adresuar situatën e familjeve në nevojë. Punonjësi social është ndërlihdësi i sistemit të shërbimeve sociale me familjet, dhe ai do të jetë në gjendje të adresojë çdo rast vetëm nëse shërbimet sociale ekzistojnë, janë mirë të planifikuara dhe financuara. Pikërisht këto janë edhe objektivat strategjikë të planit trevjeçar për reformën e shërbimeve sociale. Reforma po shënon arritjet e para:

- Një qasje e re dhe e qartë lidhur me sistemin e shërbimeve sociale është përfshirë në strategjinë e re kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015 – 2020;
- Gjithashtu strategjia kombëtare për Decentralizimin ka përfshirë edhe sugjerime lidhur me rritjen e kapaciteteve të Njësisve të Qeverisjes Vendore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve sociale duke mundësuar kështu që ata të kenë më tepër përgjegjësi për të ofruar shërbime në komunitetin e tyre;

- Parlamenti Shqiptar në fillim të dhjetorit 2014 miratoi Ligjin “Për urdhrin e punonjësit social” që vendos që asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e punonjësit social në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i urdhrin të punonjësit social të Republikës së Shqipërisë dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të këtij profesioni, të lëshuar nga ky organizëm.

Shërbime të përkujdesit social janë ofruar sidomos për kategori të veçanta familjesh dhe fëmijësh. Me ndërhyrjen e MMRS dhe mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes u ngrit një vendqëndrim për strehimin e 53 familjeve të komunitetit rom pas shpërnguljes nga banesat e mëparshme. Kjo u quajt “Qendra Transitore e Emergjencave”. Një praktikë të tillë Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror²² e institucionalizoi dhe vendosi miratimin e Hapjes së Qendrës Kombëtare Transitore të Emergjencës për Kategoritë në Nevojë. Në këtë kontekst, strukturave të shërbimeve që menaxhohen dhe administrohen nga DPSHSSH, i shtohet edhe një tipologji e re shërbimi. Qendra do të shërbejë në të ardhmen si një bazë kalimtare për personat apo familjet që vijnë nga situata social-ekonomike të vështira. Në qendër do të ofrohen shërbime psiko- sociale sipas standardeve për shërbimet shoqërore, si dhe do të synohet fuqizimi dhe ri-integrimi i këtyre familjeve në komunitet nëpërmjet bashkëpunimit me institucione dhe partnerë për formimin profesional, punësimin dhe strehimin. Bashkëpunimi dhe ndihma e partnereve si UNICEF dhe Terre des Hommes bëhet i mundur nga mirëfunksionimi i qendrës. Masat janë marrë që fëmijët të ndjekin arsimin 9 vjeçar publik ose atë parashkollor.

Shërbimi i kujdestarisë u pilotua gjatë vitit 2011 në dy bashki (Tiranë, Shkodër). Pilotimi u vlerësua dhe mësimet e nxjerra ndihmuan për ta shtrirë shërbimin edhe në njësi të tjera vendore. Sot janë 100 fëmijë në kujdestari krahasuar me 66 në vitin 2012.

Birësimi dhe procedurat e tij po bëhen më të lehta dhe më efektive. KSHB ka bërë të mundur që brenda fundit të vitit 2013 të realizohej liçensimi i të gjitha agjencive ndërmjetësuese në Fushën e Birësimit Ndërvendas duke lehtësuar dhe përshpejtuar këtë proces. Gjithashtu KSHB në fund të vitit 2013 ka paraqitur propozime konkrete për përmirësime dhe ndryshime ligjore që kanë të bëjnë me çështjen e birësimit brenda dhe jashtë vendit. Këto propozime janë përcjellë pranë institucionit të Ministrisë së Drejtësisë dhe janë në proces për të ndjekur hapat e nevojshëm sipas praktikës së hartimit të legjislacionit. Takimi i parë me gjyqtarët e seksionit të familjes në Gjykatat e Rretheve me qëllim ndërgjegjësimin për eliminimin e vonësive në proceset gjyqësore për “deklarim braktisjeje dhe birësim fëmije”, ka rezultuar prej muajit prill 2014 në përshpejtimin e procedurave që garantojnë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve.

Marrëveshje bashkëpunimi me donatorët

DPSHSSH ka ndërmarrë disa nisma bashkëpunimi me biznese dhe aktorë të shoqërisë civile të cilët do të kontribuojnë me donacione për mbështetjen e grupeve në nevojë:

- Nisma “Shqipëria Dhuron”, promovua në Durrës në 13 dhjetor 2013, nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dhe u menaxhua nga DPSHSSH gjatë gjithë muajit dhjetor 2013. Falë kësaj nisme u identifikuan dhe u adresuan nevojat e rreth 3500 familjeve, të cilave ju ofruan pako ushqimore falë kontributit të donatorëve.
- Nisma Rrjeti “Miq të Shërbimit Social, është një program konkret bashkëpunimi ndërmjet shtetit, biznesit dhe shoqërisë civile për të rritur cilësinë e shërbimeve në institucionet që trajtojnë grupet më në nevojë: të moshuarit, fëmijët, persona me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje. Në këtë nismë janë bërë pjesë rreth 35 biznese, organizata, dhe subjekte privatë.

²² Vendimi Nr. 166/5 më datë 18.03.2014

Kategori të veçanta fëmijësh

Fëmijët në situatë rruge

Të dhënat e marra nga studimi kombëtar për fëmijët në situatë rruge u përdorën për të hartuar programe dhe ndërhyrje. Duke u bazuar në marrëveshjen e nënshkruar nga MMMSR dhe MPB, ASHMDF ka koordinuar hartimin e një plani veprimi "Ndhimë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge", që ka për qëllim të mbrojë fëmijët nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, nëpërmjet një qasje të plotë, të integruar dhe një ndërhyrje të koordinuar ndër-sektoriale me strukturat e shërbimeve sociale, policisë, arsimit, shëndetësisë, punësimit, etj., për mbrojtjen e fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve të tyre.

Ndërhyrjet janë përcaktuar në dy faza:

Faza e parë pilote në Tiranë, në kuadër të së cilës, janë hartuar marrëveshje 3 palëshe mes Agjencisë, Kryetarëve të njësive bashkiake dhe Organizatave që mbështesin në terren NJMF-të. Deri tani janë firmosur akt - marrëveshjet nga të gjitha organizatat dhe nga 7 njësi vendore të Tiranës. Janë në proces nënshkrimi dhe njësitë e tjera. Në 5 Njësi Bashkiake të Tiranës, janë ngritur **skudrat e terrenit** që përbëhen nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë vendore përkatëse, një punonjës social i OJF që ka eksperiencë me punën në terren (ARSIS, SHKEJ, FBSH). Bashkëpunimi po ngrihet gjithashtu me policinë, në ato raste kur është e nevojshme. Në kuadër të Nismës janë ofruar trajnime për **45 profesionistë** lidhur me punën me fëmijët në situatë rruge, që përfshijnë NJMF në Tiranë, punonjës të policisë dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat janë pjesë e ekipeve të terrenit.

Faza afatgjatë që do të sigurojë vazhdimësinë e ndërhyrjeve në nivel kombëtar dhe do të fokusohet kryesisht në rajone ku fenomeni është më i përhapur si Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë, etj. Fushata ndërgjegjësuere "Jo shfrytëzimit të fëmijëve për lypje e punësim" e lançuar në datë 12 qershor 2014, është konceptuar si një iniciativë e vazhdueshme për të ndërgjegjësuar qytetarët mbi fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge dhe për të denoncuar këtë fenomen. Linja telefonike e vënë në dispozicion të qytetarëve për denoncim të rasteve prej shtator 2014, shënon integrimin e një mekanizmi të nevojshëm për të identifikuar rastet dhe reaguuar në kohë ndaj fenomenit.

Fëmijët që punojnë

ASHMDF ka advokuar që të ketë aktivitete specifike për këtë grup në Strategjinë "Për sigurinë dhe shëndetin në punë 2014-2020"; konkretisht është parashikuar që të përfshihen në kurikulat e arsimit bazë dhe të mesëm terminologji në lidhje me konceptet bazë për një punë të sigurt dhe të shëndetshme.

Fëmijët në lëvizje

Për herë të parë në vitin 2013-2014, ASHDMF, në bashkëpunim me partnerët Terre des hommes dhe Save the Children është angazhuar në koordinimin e zbatimit të programit MARIO në Shqipëri, fokusuar në mbrojtjen e fëmijëve në lëvizje. Fillimisht, është bërë dokumentimi i situatës së fëmijëve në lëvizje në Shqipëri, duke ofruar një panoramë aktuale ligjore, strategjike, strukturore, programatike dhe kapacitetesh lidhur me çështjen. Kjo analizë ka ndihmuar për të formuluar rekomandime për të ndikuar në ndryshimin e situatës. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, për të siguruar pjesëmarrje dhe përfaqëse të integruar. ASHMDF do të **advokojë** dhe monitorojë në vazhdimësi zbatimin e këtyre rekomandimeve

specifike për këtë kategori dhe atyre të integruara me komponentë të tjerë të mbrojtjes së fëmijëve.

Për **fëmijët në rrezik dhe të riatdhesuar**²³, DPSHSSH ka vendosur një bashkëpunim ndërinstitucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nënshkrimin e Urdhrit të Përbashkët për marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen/ripranohen nga vendet e tjera. Përpjekje po bëhen për të hartuar një marrëveshje 3 palëshe midis MMSR, MPB dhe MPJ pasi kjo e fundit luan një rol të rëndësishëm në rikthimin e fëmijëve të pashoqëruar nga emigracioni.

Fëmijët e abuzuar dhe shfrytëzuar seksualisht

Studimet tregojnë se problemi është shpesh i fshehur dhe se raportimet në institucione janë të pakta. Pothuajse në të gjithë vendin mungojnë shërbimet dhe programet e specializuara me financim të qëndrueshëm, me personel me profesionistë të trajnuar si pjesë e një mekanizmi efikas dhe efektiv ndërhyrjeje.

Në mbështetje të Reformës së Shërbimeve Shoqërore, Terre des hommes në bashkëpunim me MMSR, ASHMDF, ARSIS me mbështetjen e BE ka ndërmarrë një projekt tre vjeçar për ngritjen dhe mbështetjen e një sistemi të integruar me në qendër fëmijën, që ka si qëllim mbrojtjen e fëmijës nga çdo lloj forme, abuzimi, shfrytëzimi. Aktualisht ka filluar trajnimi dhe rritja e kapaciteteve për NJMF, administratorët socialë, personelin arsimor (mësuesit, psikologët e shkollave dhe drejtorëve), përfaqësues të policisë, personelin shëndetësor, personelin gjyqësor, prokurorë dhe të tjerë për të ndihmuar në identifikimin dhe adresimin e rasteve të abuzimit të fëmijëve, veçanërisht abuzimin seksual. Si rezultat i kësaj iniciative, do të zhvillohet një platformë multidisiplinare për menaxhimin e rasteve të lidhura me abuzimin seksual dhe zhvillimin e shërbimeve të specializuara.

Fëmijët dhe anëtarët e komunitetit nga popullsitë vulnerabël Rome dhe Egjiptiane, do të trajnohen për të identifikuar rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, për t'i ndihmuar dhe referuar pranë shërbimeve ekzistuese.

Siguria në rrjet

Siguria në rrjet është një sfidë e re për mirëqenien e fëmijëve. Masa janë marrë për të krijuar një mjedis që siguron dhe mbron fëmijët. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në bashkëpunim me Ministrinë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) koordinuan procesin për hartimin dhe miratimin e Kodit të Sjelljes²⁴ "Për përdorim të sigurt dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike". Aktualisht në Shqipëri nuk ekzistojnë standarde dhe rregullore të qarta në lidhje me klasifikimin e përmbajtjes komerciale dhe operatorët e komunikimit telefonik dhe online pranojnë se nuk kanë kontroll mbi përmbajtjen që ofrohet në internet, por nëpërmjet këtij Kodi ata sigurojnë që përmbajtja komerciale e ofruar nga ose nëpërmjet tyre do të kontrollohet e do të klasifikohet brenda një kuadri të përshtatshëm. Përmbajtja

²³ Sipas përkufizimit dhe në zbatim të detyrave të "Strategjisë Për riintegrimin e Shtetasve Shqiptar të Kthyer 2010-2015

²⁴ Me VKM Nr. 182 datë 13.03.2013 u miratua Kodi i Sjelljes "Për përdorim të sigurt dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike" ndërmjet operatorëve të komunikimeve elektronike i cili u nënshkrua në 7 shkurt 2013 nga operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike në vend, sipërmarrësit si: AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus, Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (AITA) si dhe ISP Provider: Albtelecom, Abcom, Abissnet, Tring Communication.

komerciale do të “shënjohej” për të dalluar nëse është i përshtatshëm për moshën nën 18 vjeç. Sipas këtij Kodi sipërmarrësit angazhohen të ndihmojnë fëmijët dhe prindërit lidhur me përdorimin e rrjeteve apo shërbimet e internetit, duke pasqyruar Udhëzimet për prindërit në faqet e tyre të internetit. Kodi i sjelljes së këtyre operatorëve është një hap i parë, por mbetet me rëndësi hartimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm për të siguruar internet të sigurt për fëmijët.

Në maj 2013 ndryshimet e nenit 117 të kodit Penal përcaktojnë si vepër penale mbajtjen apo përdorimin e materialeve pornografikë. Më 11 shkurt 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me AKSHI-n nënshkruan dy memorandume mirëkuptimi për bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP) dhe Ofruesve të Shërbimit të Internetit (ISP).

ALCIRT²⁵ do të mirëmbajë dhe administrojë portalin online që do t’ju shërbejë personave juridikë, publikë dhe privatë për të publikuar adresat e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme në përputhje me përcaktimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e tyre, si dhe ofruesve të shërbimit të aksesit në internet (ISP-ve) për marrjen e informacionit me qëllim mbylljen e aksesit në këto faqe sipas legjislacionit në fuqi. ALCIRT-i nxjerr udhëzime dhe urdhra për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara më sipër.

Siguria dhe mbrojtja e të drejtave online të fëmijëve është integruar në kurikulat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Lënda TIK, po pilotohet në arsimin bazë. Kjo lëndë është lëndë thelbësore e kurikulës, e cila shërben edhe si ndër-lëndë për të gjithë lëndët e fushave të tjera të kurikulës dhe ndihmon zhvillimin e kompetencës digjitale tek të gjithë nxënësit. Lënda TIK përmban si tematikë të veçantë tematikën ‘Mbrojtja dhe siguria e nxënësve nga interneti’.

Kjo tematikë vazhdon të trajtohet më e thelluar në shkallën e tretë dhe të katërt të kurikulës të arsimit bazë në klasat 6, 7, 8, 9. Në këto klasa ruhet i njëjti emërtim i tematikës, por njohuritë thellohen duke e aftësuar nxënësin për t’u mbrojtur.

Mekanizmat koordinues dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijëve

Institucionalizimi i strukturave për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijët në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ka qenë një nxitje e rëndësishme në marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e fëmijëve. Vëzhgimet në terren dhe diskutimet me grupet e ndryshme të interesit tregojnë se pas ngritjes së NJDF në qarqe ka pasur ndryshime cilësore në perceptimin e të drejtave të fëmijëve nga institucionet dhe shoqëria, si dhe një rritje të bashkëveprimit dhe bashkërendimit institucional edhe pse jo me të njëjtin ritëm në të gjithë vendin.

Rreth 67% e NJMF janë aktive dhe raportojnë rregullisht pranë ASHMDF. Në përgjithësi raportimet janë nga NJMF-të e bashkive, të cilat kanë më shumë përvojë. Nga raportimet del se 146 NJMF kanë pasur të paktën 1 rast ose asnjë rast për të menaxhuar për vitin 2014. Këto shifra tregojnë se ka akoma shumë punë

²⁵ Me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 482, datë 16 korrik 2014 për “Një shtesë në vendimin Nr. 766, datë 14.09.2011 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike” (ALCIRT),

për t'u bërë nga NJMF, kryesisht për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në rrezik. NJMF raportojnë në ASHMDF sipas një formati të përcaktuar, por është konstatuar se NJMF i dokumentojnë rastet në mënyra të ndryshme. Ky problem do të adresohet në Udhëzimin e ri për Procedurat për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili pritet të miratohet së shpejti dhe do të vendosë disa rregulla të unifikuara për të gjitha NJMF, lidhur me hapat dhe dokumentimin e procesit të menaxhimit të rastit.


Takimet e grupeve multidisciplinare për zgjidhjen e rasteve kanë pasur probleme. Ndonëse vërehet një ndërgjegjësime dhe bashkëpunim më i madh i institucioneve vendore me NJMF për menaxhimin e rasteve, shpeshherë mungon pjesëmarrja e tyre nëpër takimet apo tryezat e diskutimit të grupeve multidisciplinare. NJMF kanë siguruar bashkëpunimin, kryesisht nëpërmjet takimeve individuale me aktorët vendorë.

Qeveria shqiptare ka filluar Reformën Administrativo-Territoriale e cila synon të ulë ndjeshëm numrin e ndarjeve administrative në vend dhe është duke hartuar strategjinë e re të decentralizimit, strategji që do të rishikojë funksionet qeverisëse të niveleve vendore. Në këtë kuadër ASHMDF do të advokojë për forcimin e NJMF, duke rritur burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare, për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për fëmijët dhe familjet.

Për ndërtimin e një sistemi të mbrojtjes së fëmijëve efektiv dhe afat-gjatë, përbën domosdoshmëri funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe multidisciplinar i mbrojtjes. Kjo sjell si nevojë përcaktimin e qartë të roleve dhe procedurave për bashkëpunim në kuadër të identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, për të gjithë institucionet publike apo private të cilat punojnë me fëmijët dhe kanë përgjegjësi për mbrojtjen e tyre. Me këtë synim, është miratuar udhëzimi i katër ministrave i **procedurave të ndërhyrjes për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik** nëpërmjet një procesi konsultativ dhe përfshirës, duke u bazuar në praktikën e mira të evidentuara në Protokollin e Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës.

Gjithashtu, për të kuptuar më mirë sfidat për realizimin e një sistemi gjithëpërfshirës së mbrojtjes së fëmijëve, ASHMDF në bashkëpunim me MMSR dhe mbështetjen e UNICEF po ndërmarrin një vlerësim të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vend i cili jo vetëm do të bëjë një analizë të sistemit të funksioneve, mekanizmave koordinues, mënyrave të buxhetimit, impaktin e reformës së re territoriale, por do të vlerësojë dhe do të bëjë rekomandime për ndërthurjen e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve me Reformën e Shërbimeve Sociale.

Për vitin 2013, NJMF të cilat kanë raportuar pranë ASHMDF-së kanë menaxhuar **1321** raste të fëmijëve në rrezik dhe për vitin 2014 rreth **1407** raste. Nga këto **703** janë raste të reja për vitin 2014. Fëmijë në rrezik konsiderohet çdo fëmijë të cilit i janë cënuar apo mohuar të drejtat e tij. Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktime të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit. Përgjithësisht fëmijët në rrezik vijnë nga familje të varfra dhe janë përballur me situata dhune në familje, abuzimi fizik e seksual, shfrytëzim për punë në rrugë, trafikimi si dhe në shumë raste neglizhimi nga prindërit apo personat kujdestarë në përmbushjen e nevojave të tyre bazë për mbijetesë.



Çështje për adresim

Strategjia e re e mbrojtjes sociale duhet të reflektojë konsiderata të rëndësishme edhe për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet një qasjeje të integruar gjithëpërfshirëse dhe multidisiplinare.

Strategjia e mbrojtjes sociale dhe reforma e shërbimeve sociale duhet të theksojë rëndësinë e politikave efektive që mundësojnë që fëmijët të shkojnë sa më shpejt në familje, qofshin ato biologjike, birësuese, apo familje kujdestare. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet de-institucionalizimit të fëmijëve të grupmoshës 0-6 vjeç. Reforma duhet të përforcojë shërbimet në mbështetje të familjes, me një fokus të veçantë tek fuqizimi i familjeve dhe prindërimi i mirë.

Skema pilote e ndihmës ekonomike, me incentiva për shkollimin dhe vaksinimin e fëmijëve duhet të zgjerohet në të gjithë Shqipërinë.

Njëkohësisht duhen hartuar standarde për monitorimin e punës për mbrojtjen e fëmijëve.


Duhet të krijohen shërbime të specializuara për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimet seksuale, duke përfshirë trajnimin e specializuar të profesionistëve, garantimin e mbrojtjes efikase të fëmijëve dhe evitimin e ri-viktimizimit, dhe ndërgjegjësimin e gjerë mbi problematikën.

Mbrojtja për fëmijët në situatë rruge duhet të përfshijë fëmijët në situatë rruge në rajonet e tjera, jo vetëm në Tiranë, nëpërmjet zgjerimit të zbatimit të Planit të Veprimit. Bashkëpunimi i strukturave për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të qartësohet nëpërmjet hartimit dhe adoptimit të Udhëzuesve specifkë.

Kuadri rregullator lidhur me përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët duhet përforcuar dhe është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi i fëmijëve, prindërve dhe profesionistëve mbi përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët. Pilotimi i modulit kurikular mbi sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave online të fëmijëve duhet vlerësuar dhe aplikuar gjerësisht në bazë të rezultateve të vlerësimit.

Me prioritet duhet parë përfshirja dhe rritja e aksesit në shërbime për vajzat, fëmijët që i përkasin grupeve minoritare, fëmijët që jetojnë në zonat rurale dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, sidomos në qasjen e tyre në arsim, mbrojtje sociale, shëndetësi dhe strehim i përshtatshëm.

Të forcohen përpjekjet për të siguruar që fëmijët të kenë të drejtë të shprehin lirisht mendimet e tyre në të gjitha çështjet që i prekin ata dhe tu japin këtyre pikëpamjeve rëndësinë e duhur në shkolla dhe në institucione të tjera arsimore, si dhe në familje.



Kontributi i Fëmijëve²⁶

Si është dhe dëshironi të jeta bota që ju rrethon?

Zemra e kuqe paraqet **dashurinë** që është shumë e rëndësishme se ndikon shumë në formimin tonë për të ardhmen.

Lulja simbolizon **familjen**, me të cilën çdo fëmijë është shumë i lidhur. Duam që familja të jetë e shëndetshme dhe e lumtur.

Fëmija blu, mbi kokën e të cilit shtrihet një dorë e zgjatur simbolizon fëmijën si viktimë të **dhunës**, ndoshta nga prindërit në shtëpi apo nga të tjerë.

Këto unaza të bashkuara janë për **martesat e hershme** të fëmijëve. Nuk duhet që fëmijët të detyrohen të martohen por duhet të edukohen që kur të mbushin moshën e duhur, mund të zgjedhin vetë se me kë duan të martohen.

Kompjuteri tregon për hobet e fëmijëve si p.sh. facebook që është bërë pjesë e pandashme e jetës së tyre. Por internetit është mirë që t'i vendoset një limit dhe kontroll për fëmijët, për shkak se aty mund të gjenden gjëra që nuk janë të përshtatshme për ne.

Fëmija i rrethuar nga të qeshurat simbolizon talljen dhe **diskriminimin** që u bëhet fëmijëve për shkak të ngjyrës së lëkurës, racës, gjinisë, gjendjes ekonomike, etj.

Me pëllumbin dhe degën e ullirit kemi paraqitur paqen kurse me këtë kafazin, paraqesim privimin nga liria të fëmijëve që janë të prekur nga **gjakmarrja**.

Me anë të kësaj dore me çelës jemi përpjekur të shprehim **vjedhjen**, përveç dëmit që shkakton është edhe shembulli i keq tek fëmijët, duke i mësuar ata që mund të fitojnë gjëra pa punuar por duke ia marrë të tjerëve.

Shishja e vizatuar paraqet **alkoolin**, i cili është një nga shkaqet më të mëdha që shpie në dhunën ndaj fëmijëve.

Është vizatuar kutia e ndihmës së shpejtë për të paraqitur **sistemin shëndetësor**. Dhe pranë saj shkrimi "Not free here" nënkupton se nuk mund të marrin shërbime falas edhe pse kjo është një e drejtë ligjore për ne.

Është paraqitur një **gjethe droge pasi** fëmijët në ditët e sotme që në vogëli janë të ekspozuar ndaj drogës si pasojë e shembujve të këqij që i rrethojnë ata.

Me një kafshatë buke bashkë me një lugë, kemi simbolizuar mungesën e ushqimeve – **varfërinë** e shumë familjeve.



²⁶ Grup diskutimi drejtuar nga ASHMDF me pjesëmarrjen e 20 të rinjve, në 12 nëntor 2014, në Shkodër, **lehtësuar nga World Vision**

III. E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR

Situata

Konventa për të drejtat e fëmijëve sanksionon të drejtën e fëmijëve për të përfituar kujdesin më të lartë dhe cilësor shëndetësor. E drejta e fëmijës për kujdes shëndetësor përcaktohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës, “shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti dhe kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor”²⁷. Ky angazhim kushtetues mbështetet edhe nga parimet për shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse shëndetësore të cilat gjenden në ligjet “Për shëndetin riprodhues”²⁸ dhe “Për shëndetin Publik”²⁹.

Politika publike e sigurimit të shërbimeve të përshtatshme për të garantuar kujdes shëndetësor për të gjithë qytetarët, trajtohet në disa dokumente strategjike kombëtare, të tillë si: Strategjia e Shëndetit Riprodhues, Plani Kombëtar i Veprimit për fëmijë³⁰, Plani i dekadës Rome³¹ si edhe Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara³².

Në kuadër të dokumenteve ndërkombëtare, përmendet mbështetja e Planit të Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (Kajro, 1994), si dhe pjesëmarrja aktive në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në 2015 (OKB, 2000), ku zvogëlimi i vdekshmërisë amtare, foshnjore dhe feminare janë tre nga tetë indikatorët e zhvillimit të lidhura direkt me kujdesin parësor shëndetësor të nënës dhe fëmijës.

Politikat e kujdesit shëndetësor të nënës dhe fëmijës kanë synuar përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve të ushqyerjes dhe shëndetit të nënës dhe fëmijës me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve, sistemi i kujdesit shëndetësor, në veçanti, sistemi i kujdesit shëndetësor të nënës dhe fëmijës, përballet me probleme kritike.

Paraqitja e treguesve të shëndetit të nënës dhe fëmijës për efekt të këtij raporti përmban disa sfida, duke patur parasysh se ekzistojnë burime të të dhënave, të cilat janë bazuar në metodologji të ndryshme – regjistrimin e lindjeve dhe vdekjeve (të dhëna administrative) ose sipas modeleve studimore, ose modele që mbështeten mbi supozime të ndryshme. Metodologji të ndryshme rezultojnë në vlerësime, të cilat shpesh janë kontradiktore. Vlerësimet e mbështetura në studimet mbi familjen pranohen si burimi më i besueshëm i vlerësimeve mbi vdekshmërinë foshnjore.

Studimi kombëtar demografik dhe shëndetësor (SKDSH) në vitin 2008-2009 nuk është pasuar në vitet e fundit me vlerësime të tjera për të shpalosur në mënyrë të

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998, Neni 55.

²⁸ <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2012/03/P%C3%ABr-sh%C3%ABndetin-riprodhues.pdf>

²⁹ <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2012/03/Ligji-i-shendetit-publik.pdf>

³⁰ <http://mobile.ikub.al/LIGJE/PeR-MIRATIMIN-E-PLANIT-Te-VEPRIMIT-PeR-FeMIJe-2012-2015-1205040136.aspx>

³¹ <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Dekada%20e%20Perfshirjes%20se%20Romeve%20-%20Plani%20Kombetar%20i%20Veprimit.pdf>


³² http://www.adrf.org.al/images/strat_komb_pak.pdf

vazhdueshme një panoramë të qartë mbi treguesit e ushqyerjes dhe shëndetit.

Sipas SKDSH 2009³³, vdekshmëria foshnjore dhe fëminore në vitin 2008, përkatësisht në vlerën 18 dhe 22 për 1,000 lindje, janë pak më të larta se sa të njëjtët tregues në vende të tjera të Evropës qendrore dhe lindore. Sidoqoftë deri në 2012, vdekshmëria foshnjore dhe fëminore (deri në 5 vjeç) janë reduktuar përkatësisht në 7.8 dhe 8.9 vdekje për 1.000 lindje. Vdekshmëria amtare ishte 5.7 për 100.000 lindje në të njëjtin vit nga 17/100.000 që ishte në 2008. SKDSH gjithashtu nënvizon edhe diferencat e theksuara për familje që i përkasin grupeve me të ardhura të ulta. Kështu, vdekshmëria foshnjore tek fëmijët e familjeve me të ardhura të ulta është rreth 40 përqind më e lartë se sa tek fëmijët e familjeve me të ardhura të larta. Vdekshmëria nën moshën 1 vjeç në vitin 2013 ishte në vlerën 7.9 për 100,000 lindje të gjalla dhe vdekshmëria nën moshën 5 vjeç ishte në vlerën 9.8³⁴ për 1,000 lindje të gjalla. Të dhënat për vitin 2014 dhe parashikimi për 2015 nuk janë të disponueshme nga institucionet përkatëse.

Megjithatë duhet nënvizuar se situata nuk paraqitet e njëjtë në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Në zonat rurale ky tregues është shumë më i lartë se sa në zonat urbane, ndërsa në zonat malore rurale është edhe më i lartë (shih figura 1).

Figura 1: Numri i vdekjeve, (0-1vjeç) në nivel rrethi (2010)³⁵



³³ INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik (2010) "Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-2009, Shqipëri

³⁴ Ministria e Shëndetësisë, Të dhëna administrative, 2014.

³⁵ Observatori për të drejtat e fëmijëve (2012) "Varfëria e Fëmijëve në Shqipëri" Karta Raportuese 1, UNICEF, Shqipëri

Për më tepër Tabela 1³⁶ jep një përmbledhje të treguesve të lidhur me fëmijët, duke bërë krahasimin ndërmjet shteteve të rajonit.

	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Maqedonia	Serbia
Vdekja foshnjore (vdekjet për 1,000 lindje të gjalla, 2010)	8.8	6	4	7	6
Vdekshmëria nën moshën 5 vjeç (vdekje për 1,000 lindje të gjalla, 2010)	17	7	5	7	7
Vonesa të lehta dhe të rënda zhvillimore (nën moshën 5 vjeç, 2006-2010)	19%	8.9%	Nuk ka të dhëna	4.9%	6.6%

Kështu, edhe pse shifrat e lidhura me vdekshmërinë foshnjore dhe amtare në vend janë në ulje ndër vitet e fundit, ato në vazhdimësi duhet të vlerësohen duke i krahasuar me vendet e tjera³⁷, me përfaqësimin e këtyre treguesve në zona të ndryshme të vendit³⁸, si edhe progresin për të përbushur indikatorët e përcaktuar sipas Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit 5 e 7.

Aksesi në shërbimet kryesore shëndetësore është i ndryshëm për gratë shtatzëna dhe për fëmijët e vegjël. Më shumë se 99 përqind e grave shtatzëna lindin në praninë e stafit të kualifikuar mjekësor dhe 97 përqind e tyre marrin të paktën një vizitë para lindjes. Gjithsesi, shumë më pak, mesatarisht 67 përqind e tyre, përfitojnë nga të paktën katër vizita përpara lindjes. Vetëm 54 përqind e fëmijëve me diarre marrin hidratim dhe ushqim të vazhdueshëm nga goja dhe pak më pak sesa 60 përqind marrin antibiotikë për dyshim për pneumoni. Nuk ka informacion për numrin e fëmijëve që marrin suplemente me vitaminën A³⁹.

Tabela 2 jep një krahasim rajonal të niveleve të aksesit në ndërhyrjet kryesore të shëndetit dhe të të ushqyerit për gratë shtatzëna në Shqipëri dhe në katër shtete të tjera evropiane.

Tabela 2: Krahasim rajonal i nivelit të aksesit në ndërhyrjet kryesore shëndetësore dhe të të ushqyerit për gratë shtatzëna⁴⁰

	Shqipëria	Bosnja	Kroacia	Maqedonia	Serbia
Mami me eksperiencë gjatë lindjes	99.3%	99.9%	100%	98%	99.8%
Gratë shtatzëna që marrin kujdes përpara lindjes (të paktën katër vizita)	66.8%	84.2%	Nuk ka të dhëna	93.9%	94.2%
Gratë shtatzëna që marrin kujdes përpara lindjes (të paktën një vizitë)	97.3%	87%	Nuk ka të dhëna	98.6%	99%
Prevalenca e anemisë tek gratë shtatzëna (2005)	31%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

Pabarazitë ndërmjet zonave urbane dhe rurale janë të dukshme në peshën e lindjes së sapolindurve, ku pesha e ulët në lindje haset në dyfishin e fëmijëve që vijnë nga familje të varfra sesa në fëmijët e tjerë. Tregues të tjerë shëndetësorë dhe të të ushqyerit sugjerojnë barazi në ofrimin e shërbimeve ndërmjet zonave

³⁶ Burimi: Statistikat e UNICEF-it (2012) sipas shteteve; UNESCO-ja, Instituti i Statistikave (2012); Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë (vdekja foshnjore dhe e fëmijëve).

³⁷ UNICEF, 2014, "Gjendja e Fëmijëve në Botë", New York, UNICEF


³⁸ INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik (2010) "Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-2009, Shqipëri

³⁹ ibid

⁴⁰ Burimi: Statistikat e UNICEF-it sipas shteteve, 2007- 2012; UNAID-iS, 2012; Baza e të dhënave e OBSH-së për Aneminë, 2006


urbane dhe rurale. Mund t'i referohemi figurës 2 për treguesit e higjienës dhe nënpeshës në zonat rurale dhe urbane në Shqipëri.

Figura 2: Tregues të përzgjedhur (në përqindje) të lidhur me higjienë dhe shëndet për zonat urbane dhe rurale në Shqipëri.



Ka barazi ndërmjet të pasurve dhe të varfërve lidhur me aksesin në disa shërbime kryesore të zhvillimit në fëmijërinë e hershme, por ekzistojnë pabarazi në peshën e të sapolindurve. Numri i fëmijëve të varfër të lindur me pesha të ulëta është më i madh se numri i fëmijëve të pasur me pesha të ulëta në lindje — duke sugjeruar se gratë e varfra shtatzëna nuk kanë akses të barabartë në shërbimet kryesore të shëndetit dhe të të ushqyerit. Figura 3 jep një përmbledhje të këtyre treguesve të përzgjedhur për më të pasurit dhe më të varfrit në Shqipëri.

Figura 3: Tregues të përzgjedhur (në përqindje) të lidhur me higjienë dhe shëndet për grupin e të pasurve dhe të varfërve në Shqipëri.



Treguesit e shëndetit mes popullatës Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri janë më të ulët se sa të pjesës tjetër të popullsisë. Shkaqet duhen kërkuar tek varfëria, kushtet e vështira të jetesës, mundësia e kufizuar për të përdorur shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, niveli i ulët arsimor e mungesa e infrastrukturës.

Një vlerësim i fundit me fokus fëmijët Romë 0-6 vjeç evidenton se largësia nga Qendrat Shëndetësore është një faktor që vështirëson aksesin. 14,4% e qendrave

shëndetësore janë mbi 2 km distancë nga vendbanimet Rome. 61.7% e fëmijëve kanë marrë vaksinat sipas kalendarit, për rreth 17% të fëmijëve stafi shëndetësor nuk ka informacion mbi statusin e vaksinimit të fëmijëve. Në rreth 68.8% të rasteve fëmijët gëzojnë shëndet të mirë, por kjo nuk qëndron për 5.4% të tyre⁴¹.

Studimi "Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë"⁴² thekson sërish se nënushqyerja e fëmijëve të familjeve të varfra dhe statusi i tyre shëndetësor, mbeten problematike. 56,7 përqind e familjeve në Ndihmë Ekonomike deklarojnë se nuk mbulojnë nevojat për ushqimin, dhe 88,9 përqind deklarojnë se nuk mbulojnë nevojat për shërbime shëndetësore të fëmijëve. Studimi tregon se 29 përqind e fëmijëve që vuajnë të paktën një sëmundje kronike dhe më shumë se gjysma e fëmijëve me sëmundje kronike, janë nga familje të nivelit më të ulët të shpenzimeve. Gjithashtu rezultoi se 50 përqind e fëmijëve që vuajnë nga sëmundje kronike dhe që nuk përfitojnë rregullisht konsultime mjekësore i përkasin familjeve të grupit më të ulët të shpenzimeve, të cilat shpenzojnë përkatësisht për kujdesin shëndetësor të fëmijëve sa 1/3 e shpenzimeve mesatare.

Çështjet që lidhen me ushqyerjen e shëndetshme për fëmijët, ndonëse kanë pak vite që trajtohen, janë shndërruar në prioritare, për shkak të ndikimit të thellë që kanë mbi shëndetin e fëmijës. Siç shihet nga tabela 3, grupi i sëmundjeve që janë rrjedhojë e kequshqyerjes, zë një peshë specifike relativisht të ulët për grup moshat deri në 5 vjeç dhe rritet ndjeshëm në moshat 5-14 vjeç.

Tabela 3: Sëmundshmëria sipas grup moshave.

Sëmundshmëria/grup moshat	0 – 1 vjeç	1 – 4 vjeç	5 – 14 vjeç
Sëmundje endokrine/të ushqyerit dhe metabolizmit	0,4 %	0,3 %	3 %

Burimi: Ministria e Shëndetësisë, të dhëna administrative, 2014

Përsa i përket ushqyerjes me gji të fëmijëve, vihet re se kjo formë e të ushqyerit ka peshë më të madhe se ajo me ushqim artificial (tabela 4).

Tabela 4: Ushqyerja me gji

	2010	2011	2012
Numri i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji	27,683	22,627	23,090
Numri i fëmijëve që ushqehen me ushqim artificial	6,317	5,042	4,016

Burimi, Ministria e Shëndetësisë, të dhëna administrative, 2014

Fëmijët që ushqehen në përputhje me praktikën e ushqyerjes për të porsalindurit dhe fëmijës⁴³ janë në nivel të ulët, vetëm 19 përqind e tyre ushqehen sipas këtyre praktikave, dhe vajzat kanë më pak gjasa se sa djemtë të ushqehen sipas tri praktikave të rekomanduara të ushqyerjes së të porsalindurve dhe fëmijëve. Po kështu fëmijët në zonat rurale kanë më pak gjasa se ato në zonat urbane që të

⁴¹ Hazizaj A., Elezi P., Ballo M., Vlerësim Kombëtar 2014: Aksesi i fëmijëve romë në Shërbimet e edukimit dhe shëndetësisë në Shqipëri, UNICEF / CRCA / YWCA / Observatori, Tirana 2014.

⁴² UNICEF, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Qendra Kombëtare të Studimeve Sociale dhe Instituti i Kërkimeve Urbane (2012) "Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë", Tiranë

⁴³ INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik (2010) "Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-2009, Shqipëri

ushqehen në përputhje me këto praktika. Përsa i përket indeksit të pasurisë së familjeve, edhe këtu kemi diferenca të theksuara, kështu në familjet që i përkasin indeksit të ulët të pasurisë 17 përqind e fëmijëve ushqehen sipas praktikave të rekomanduara krahasuar me 23,6 përqind të fëmijëve të familjeve në indeksin e lartë të pasurisë.

Rezultatet e SKDSH 2009 tregojnë se konsumi i disa mikroelementeve të rëndësishëm, përfshirë vitaminën A, hekurin dhe jodin mes fëmijëve 6-59 muajsh, varion sipas disa karakteristikave siç janë vendbanimi, rajoni dhe indeksi i pasurisë së familjes. Për efekt të këtij studimi, grupi i specialistëve iu referua matjes së bërë për "përqindjen e fëmijëve që kanë konsumuar ushqime të pasura me vitaminë A gjatë 24 orëve të fundit" sipas të cilit u konstatua se ekzistojnë diferenca ndërmjet zonës së vendbanimit (Tirana urbane 97,7 përqind dhe zonat malore 78,9 përqind); (zonat urbane 90,2 përqind dhe ato në zonat rurale 86,4 përqind) dhe indeksit të pasurisë së familjes (më i ulët 82,1 përqind dhe më i lartë 94,4 përqind).

Vlerësimi në 2013⁴⁴ rezultoi se, sipas vlerave kufi të OBSH-së, 21.6 % e fëmijëve 7-10 vjeç janë mbipeshë dhe 7.7% e tyre janë obezë. Sipas grup-moshave të marra në studim për fëmijët 7-8 vjeç rezultoi një prevalencë mbipeshë 21.4% dhe obeziteti 7.7%; te fëmijët 8-9 vjeç u gjenden 22.4 % mbipeshë dhe 7.9% obezë; ndërsa te fëmijët 9-10 vjeç u ndeshën sërish vlerat respektive më të ulëta mes tri grup-moshave, ku 18.8% e tyre ishin mbipeshë dhe 6.8% obezë. Prevalenca e mbipeshës është dukshëm më e lartë te fëmijët e moshës 8-9 vjeç, në zonat urbane në raport me zonat rurale, dhe tek meshkujt në raport me femrat, mes djemve në raport me vajzat. Vlerësimi⁴⁵ për grupmoshën e fëmijëve 11-13-15 vjeç raportoi se 3.2% e tyre klasifikohen si obezë.

Çështje të lidhura me parandalimin dhe trajtimin e HIV/AIDS janë pjesë e PVF 2012-2015, edhe pse Shqipëria është ende një vend i konsideruar me shkallë të ulët prevalence.

Rasti i parë i diagnostikimit të një fëmije me HIV/AIDS ishte në vitin 1997. Deri në dhjetor 2010, u raportuan 21 fëmijë të infektuar me HIV/AIDS, 15 nga të cilët janë infektuar nëpërmjet transmetimit vertikal nga nëna tek fëmija, ndërsa 6 fëmijë janë infektuar nëpërmjet transfuzionit të gjakut. Deri sot, 3 nga këta 21 fëmijë kanë vdekur nga AIDS. Fëmijët sot përbëjnë 5.3 përqind të të gjithë atyre që jetojnë me HIV dhe 4.9 përqind të personave të infektuar. Këto shifra relativisht të ulëta, në të vërtetë maskojnë rreziqet, sepse nuk ekzistojnë sisteme efektive monitorimi dhe kontrolli.

Vlerësimi mbi shërbimet për nënën dhe fëmijën deri në 3 vjeç në shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor evidenton si sfida për të ofruar shërbime cilësore: mungesën e pasqyrit në instrumente dhe praktikë të një kornize/perspektive holistike të zhvillimit të fëmijës, mungesës së programeve për prindërimin e mirë në komunitet, si edhe mangësitë në monitorimin dhe vlerësimin e duhur të shërbimit dhe treguesve të lidhur me këtë komponent të shërbimit⁴⁶.

⁴⁴ Jolanda Hyska J., Burazeri G., Mersini E. (2013) "Vlerësimi i obezitetit në moshën femërore", Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, United Nations, Tiranë.

⁴⁵ Qirjako G., Burazeri G., Mihali E., Bukli M., Agolli E. (2014) "Sjelljet e shëndetshme tek fëmijët e moshës shkollore 11, 13, 15 vjeç" UNFPA, UNICEF Shqipëri.

⁴⁶ Haxhiymeri, E., Hallkaj, E., Ndriç, M., Boci, A. "Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, cerdheve dhe institucioneve të kujdesit rezidencial për fëmijët 0-3 vjeç", UNICEF, Shqipëri.

Studimi mbi barrierat e aksesit të shërbimeve të shëndetit riprodhues në Shqipëri⁴⁷ paraqet vështirësitë e ofrimit dhe marrjes së shërbimeve në kuadër të infrastrukturës, organizimit të punës/shërbimeve, përqasjes jo të integruar të shërbimeve, kapaciteteve të stafit shëndetësor dhe kulturës/qëndrimeve të komunitetit lidhur me kujdesin shëndetësor. Ky vlerësim vendos theksin tek mungesa e shërbimeve miqësore për të rinjtë, dhe mundësi të kufizuara që të rinjtë kanë për të plotësuar nevojat e tyre për informacion e shërbime përmes sistemit shëndetësor.

Me gjithë rëndësinë dhe diskutimet e vazhdueshme mbi reformimin e sistemit të kujdesit shëndetësor, shpenzimet publike në këtë sektor gjatë periudhës 2011-2013 kanë patur një tendencë rënie nga 7.65% në 6.93% të PBB. Për 2014 plan, ky tregues është 6.64%, pra përsëri në rënie. Ndërsa për vitin 2015, programi buxhetor afatmesëm parashikon që këtij sektori t'i kushtojë një peshë prej 9.01% si vlerë të pritshme, ose 36% më lart se plani i vitit 2014. Tabela 5⁴⁸ jep një krahasim të shpenzimeve rajonale për kujdesin shëndetësor në Shqipëri dhe në katër shtete të tjera të Evropës Lindore.

	Shqipëria	Bosnja	Kroacia	Maqedonia	Serbia
Shpenzimet e dala nga xhepat e qytetarëve si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme për shëndetësinë	52%	28%	14%	36%	37%
Shpenzimet e përgjithshme për shëndetin/frymë me barazi të fuqisë blerëse (NCU/USÇ)	541	928	1,410	835	1,250
Shpenzimet private për shëndetin (PvtHE) si % e shpenzimeve të përgjithshme për shëndetin	52%	29%	18%	36%	39%
Shpenzimi i përgjithshëm për shëndetin si përqindje e PBB-së	6%	10%	7%	7%	10%
Përqindja e vaksinave rutinë EPI të financuara nga qeveria	100%	Nuk ka të dhëna	100%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna

Vetëm prania e ligjeve dhe e politikave jo gjithmonë garanton një lidhje me rezultatet e dëshirueshme të zhvillimit në fëmijërinë e hershme. Në shumë shtete politikat në letër dhe gjendja në realitet lidhur me aksesin dhe ofrimin e shërbimit nuk përkojnë me njëra-tjetrën. Për shembull, ligji shqiptar i inkurajon nënat e reja t'i ushqejnë me gji foshnjat e tyre gjatë gjashtë muajve të parë të jetës, por më pak se 40 përqind e grave i ushqejnë foshnjat vetëm me gji për 6 muaj. Po ashtu, Shqipëria ka politikën e ofrimit të kripës së jodizuar, por një e katërta e popullsisë nuk konsumon kripë të cilës nuk i është shtuar jodina. Tabela 6 i krahason politikat me rezultatet në fushën e ushqyerjes dhe shëndetit të fëmijëve në Shqipëri.

⁴⁷ Hallkaj, E. Pipa, T. (2013) "Barrierat e aksesit në shërbimet e shëndetit riprodhues në kujdesin shëndetësor parësor", ACA/UNFPA Shqipëri

⁴⁸ Baza globale e të dhënave për shpenzime shëndetësore, 2012; Statistikat e UNICEF-it sipas shteteve, 2010; Instituti i Shëndetit Publik (financimi i vaksinës EPI në Shqipëri)

Politikat e zhvillimit	Rezultatet
Ligji është në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Marketimit të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit	Niveli ekskluziv i ushqyerjes me gji (> 6 muaj): 38.6%
Shqipëria ka politika kombëtare për të inkurajuar jodizimin e kripës	Konsumi i kripës së jodizuar nga familjet 75.6%
Fëmijëve të vegjël u kërkohet të përfitojnë një kurs të plotë të imunizimeve në fëmijëri	Fëmijë me DPT (12-23 muaj): 99%

Burimi: UNICEF-i, statistikat sipas shteteve, Qeveria e Shqipërisë,

Ecuria

Reformimi i sistemit të kujdesit shëndetësor me qëllim sigurimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse, është një nga objektivat themelore të programit të ri të qeverisë. Në këtë program, i kushtohet vëmendje zvogëlimit të pabarazive si edhe rritjes së cilësisë të shërbimeve shëndetësore, duke përcaktuar edhe ndryshime thelbësore në mënyrën e financimit me qëllim mbulimin e plotë të kostos dhe zvogëlim të barrës financiare mbi kurrizin e qytetarëve, sidomos të atyre që vijnë nga grupe shoqërisht të përjashtuara. Mbrojtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shëndetit të nënës dhe fëmijës, ndonëse nuk trajtohet si komponent i veçantë i reformës shëndetësore të sapo ndërmarrë, konsiderohet prioritetet e politikës publike të kujdesit shëndetësor. Për vitin 2013, financimi i kujdesit shëndetësor parësor, krahasuar me një vit më parë, është rritur me 278.6 milionë lekë ose 4.4%⁴⁹.

Një nga arritjet më të rëndësishme të realizuara gjatë periudhës që mbulon ky raportim, është me siguri përmirësimi i kornizës rregullatore të shërbimit për nënën dhe fëmijën në kujdesin shëndetësor parësor. Miratimi⁵⁰ i udhëzuesve dhe protokolleve të kujdesit dhe ushqyerjes të nënës dhe fëmijës përcaktojnë standardet më të mira të kujdesit dhe praktikave. Megjithatë, ajo çfarë duhet t'i pasojë këto dokumente është po aq e rëndësishme për të përmirësuar treguesit shëndetësor. Shpërndarja e tyre në nivel qendrash shëndetësore, hartimi i manualeve të trajnimit, trajnimi, si edhe përditësimi i dokumenteve të tjerë orientues të shërbimit duhet të hartohen në vazhdimësi për të realizuar zbatimin në praktikë të këtyre dokumenteve.

Kujdesi paralindjes	Kujdesi pas lindjes	Ushqyerja	Monitorimi
Vizitat antenatale për gruan shtatzënë	Vizitat e kontrollit për kujdesin shëndetësor të nënës pas lindjes	Hapat për një ushqyerje të suksesshme me gji në komunitet	Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 0-6 muajsh
Shtimi në peshë gjatë shtatzënisë	Kujdesi paslindjes për foshnjën e porsalindur	Shtesat në mikronutiente tek fëmijët	Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 6-24 muajsh
Shtesat në vitamina dhe minerale për gruan shtatzënë	Menaxhimi i problemeve shëndetësore të nënës pas lindjes	Ushqyerja e fëmijës me formule foshnjore	Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 2-6 vjeç
Menaxhimi i shqetësimeve dhe problemeve që shfaqen gjatë shtatzënisë	Menaxhimi i problemeve shëndetësore tek i porsalinduri	Fillimi i ushqyerjes shtesë tek fëmijët	Monitorimi i zhvillimit të fëmijës 0-6 vjeç
Këshillimi për ushqyerjen me gji gjatë shtatzënisë	Menaxhimi i shqetësimeve të nënës pas lindjes	Ushqyerja me gji tek nënat me HIV/AIDS	Ndjekja e rritjes sipas kurbave të rritjes
	Shenjat kërcënuese të neonatit	Ushqyerja me gji në rast sëmundjeje të nënës dhe kur trajtohet me barna	Vlerësimi i dëgjimit tek fëmijët 0-6 vjeç Vlerësimi i shikimit tek fëmijët 0-6 vjeç

⁴⁹ ISDKSH (2014) Raporti Vjetor 2013

⁵⁰ Ministria e Shëndetësisë, Urdhër Nr.62/ 18.02.2014 dhe 157/ 26.04.2014

Mbështetur në kuadrin rregullator të miratuar, u hartuan module të akredituara të trajnimit për ofruesit e shërbimit për monitorimin e rritjes dhe ushqyerjes. Aktivitetet e trajnimit me përfitues 579 ofrues shërbimi (87 qendra shëndetësore) në Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Durrës pritet të shtrihen ndër ofrues në mbarë vendin në të ardhmen.

3 maternitete të tjera u certifikuan si 'Spitale miqësore të fëmijëve, duke e çuar në 9 totalin në vend. Tashmë, treguesit e ushqyerjes me gji janë pjesë e survejancës së ushqyerjes së fëmijëve, hartuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë në 2013.

Treguesit e ushqyerjes me gji janë pjesë e kornizës së survejancës së Institutit të Shëndetit Publik të miratuar në 2013.

Raporti i katërt i monitorimit të praktikave të tregtimit të formulave foshnjore dhe ushqimeve të industrializuara për foshnja dhe fëmijë të vegjël⁵¹ kishte si synim kryesor të shikonte përputhshmërinë e këtyre praktikave të tregtimit me Ligjin për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Gji. Gjatë këtij procesi monitorimi u vëzhguan dhe u analizuan praktikat e institucioneve që ofrojnë kujdes për nënat dhe foshnjat, si maternitete, pavione pediatrike, këshillimore të fëmijës. Janë evidentuar thyerjet e ligjit në promovimin e formulave, shqetësim i vërejtur edhe nga Komiteti i të drejtave të Fëmijëve në 2012, duke nxjerrë në pah nevojë për fuqizimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nga autoriteti përgjegjës - Inspektoriati i Shëndetësisë.

Nxënësit e klasave 1-9 të arsimit bazë janë prezantuar me kurikulat e edukimit mbi ushqyerjen, hartuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Ky edukim është pjesë e moduleve "kros-kurikulare". 20 shkolla kanë pilotuar modulet në Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Durrës. Rreth 300 sesione të hapura edukimi si edhe 10 evente me pjesëmarrjen e mësuesve, nxënësve dhe prindërve janë organizuar gjatë 2013-2014. Në vazhdimësi pritet aplikimi i moduleve në të gjithë shkollat e vendit.

Ministri të linjës⁵² janë angazhuar për zbatimin e "Planit të veprimit për ushqimin dhe ushqyerjen 2013-2020". Ky plan deklaron të jetë hartuar në përputhje me kapacitetet kombëtare dhe profilin epidemiologjik të vendit, dhe promovon mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit publik. Plani Kombëtar i Veprimit për Ushqimin dhe Ushqyerjen i ka kushtuar një fokus të veçantë kontrollit dhe reduktimit të mbipeshës dhe obezitetit të popullatës shqiptare në përgjithësi, dhe fëmijëve të vegjël në veçanti, duke planifikuar edhe një sërë aksionesh ndërhyrëse dhe të vazhdueshme në nivel kombëtar dhe vendor për përmbushjen e këtij objektiv, nën optikën e një përqsasjeje të integruar për reduktimin e faktorëve të riskut, të lidhur me sëmundjet kronike, ku bën pjesë edhe obeziteti.

Buxhetimi dhe monitorimi i progresit të tij në të ardhmen do të jetë subjekt i raportimeve të mëvonshme.

⁵¹ Qendra për Fëmijëri të Shëndetshme (2014) "Raporti i katërt i monitorimit të praktikave të tregtimit të formulave foshnjore dhe ushqimeve të industrializuara për foshnja dhe fëmijë të vegjël", Tiranë, Shqipëri

⁵² Memorandum mirëkuptimi mbi ushqimin dhe ushqyerjen, datë 18.06.2010 (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financës, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Në 2013-2014, në kuadër të përmirësimit të kujdesit perinatal në maternitetet rajonale, *vlerësimi i cilësisë ndaj kujdesit të nënës dhe fëmijës* u realizua në Kukës dhe Durrës. Vlerësimi u realizua përmes instrumentit të miratuar të Vlerësimit të Cilësisë, dhe u ndoq nga trajnimi i personelit shëndetësor dhe hartimi i planeve të ndërhyrjes në këto institucione. Si rezultat i procesit në Kukës u vu në jetë rooming-in (praktikë që nuk ekzistonte) - vënia e foshnjës në kontakt lëkurë me lëkurë menjëherë mbas lindjes, e krijimi i dhomave individuale të lindjes. U realizua përpilimi i një protokollit vendor për spitalin, si shembull se si mund të përshtaten protokollat kombëtare. Në Durrës, u përmirësua respektimi i të gjitha hapave për menaxhimin e të porsalindurit normal dhe plotësimi i rregullt i partogramës.

Në të ardhmen, buxheti i institucioneve (materniteteve) duhet jetë në përputhje me nevojat për të realizuar zbatimin e planeve të veprimit të hartuara. Gjithashtu, auditimi i vazhdueshëm i ecurisë së këtyre ndërhyrjeve është thelbësore për t'i institucionalizuar dhe integruar si pjesë përbërëse e sistemit të ofrimit të shërbimit.

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë vazhdon të jetë mbi 97%. Për të gjithë fëmijët e lindur që nga 1 mars 2014 dy dozat e para të vaksinës së poliomielitit bëhen me IPV. Kjo përbën një element të rëndësishëm në lidhje me përditësimin e kalendarit me vendet e BE dhe rritjen e sigurisë të vaksinave.

Parandalimi i transmetimit të HIV nga nëna tek fëmija është konsideruar si një nga komponentët kryesorë të Strategjisë Kombëtare të HIV/AIDS që po hartohen nga ekipi i punës. Përgatitja e protokollit kombëtar të PAINF dhe udhëzuesit të kujdesit shëndetësor parësor për këtë shërbim në qendrat e këshillimore të nënës dhe fëmijës synojnë të adresojnë nevojat e identifikuara për përmirësim e shërbimit, aksesin dhe uljen e rasteve të transmetimit.

Në 2013 e 2014, fushatat e 1 dhjetorit kanë vendosur theksin në parandalimin e transmetimit nga nëna tek fëmija, duke advokuar në Komisionin Parlamentar të Shëndetësisë.

Programi Kombëtar i HIV/AIDS në bashkëpunim me Organizatën e Personave që jetojnë me HIV/AIDS gjatë vitit 2014 kanë realizuar takime në Tiranë dhe Vlorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve HIV pozitiv. Në rastin e Vlorës, ky bashkëpunim është shtrirë edhe me Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Në punën për rishikimin e paketës bazë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor vëmendje i është kushtuar prezantimit të komponentit të shëndetit të adoleshentëve, për të theksuar rëndësinë dhe specifikat e shërbimit.



Çështje për adresim

Përmirësimi i politikave të kujdesit shëndetësor për fëmijët, e shprehur nëpërmjet shpërndarjes më të mirë e më efektive të burimeve financiare dhe njerëzore në sektorin e shëndetit me qëllim sigurimin e një aksesit të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët që jetojnë në zonat e largëta dhe fëmijët romë.

Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet shërbimeve të nënës me ato të fëmijëve, përfshirë edhe institucionet pediatrike, dhe bashkëpunimin e këtyre institucioneve me ato të fëmijërisë së hershme.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të fëmijës në tre nivelet e kujdesit, nëpërmjet unifikimit të udhëzuesve dhe protokolleve standard për ndjekjen e shëndetit të fëmijës

Rritja e njohurive dhe aftësive të personelit shëndetësor, nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të gjithë personelit shëndetësor që punon në këto shërbime

Edukimi, promovimi shëndetësor për komunitetin, familjen, sensibilizimin dhe mobilizimin e gjithë shoqërisë, mas medias, etj., me mesazhin se kujdesi për gruan, fëmijën, përbën prioritet dhe nuk është vetëm detyrë e shëndetësisë

Fuqizimi i shërbimeve për adoleshentët, përfshirë shërbimin shëndetësor në shkolla.

Adresimi i keq-ushqyerjes, duke u fokusuar mbi të gjitha tek kategoritë e fëmijëve të përjashtuar, kryesisht të atyre të familjeve të varfra, si edhe të grupimeve të tjera.

Përmirësimi i cilësisë së mbledhjes dhe përpunimit të informacionit dhe treguesve cilësor për shëndetin e fëmijës dhe adoleshentit.



IV. E DREJTA PËR ZHVILLIM DHE PËR EDUKIM

Situata

Fëmijëria e hershme

Evidencat ndërkombëtare mbështesin rëndësinë e ndërhyrjeve për kujdesin dhe edukimin për fëmijërinë e hershme (0-6 vjeç) me ndikim të konsiderueshëm në arritjet e mëtejshme pozitive tek fëmijët. Në Shqipëri mungon ende një mjedis i përshtatshëm veçanërisht për këtë grup moshë. Ka mekanizma të kufizuar për të harmonizuar politikëbërjen shumësektoriale për nxitjen e zhvillimit të fëmijëve më të vegjël se gjashtë vjeç⁵³. Plani i Veprimit për Fëmijët (2012-2015) mund të konsiderohet si një kornizë strategjike që identifikon nevoja dhe shërbime në këtë aspekt.

Në Shqipëri, shërbimet për zhvillim dhe edukim për fëmijërinë e hershme ndahen sipas grupmoshave 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç.

Shërbimet për **kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve 0-3 vjeç** janë organizuar përmes çerdheve (publike dhe private). Administrimi i çerdheve është një funksion i ushtruar plotësisht nga pushteti vendor⁵⁴. Çerdhet përcaktohen si institucione përgjegjëse për rritjen, edukimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve deri në 3 vjeç⁵⁵. Dokumenti mbi rregulloren higjieno-sanitare për çerdhet përcakton parametrat për siguri, infrastrukturë, higjienë dhe ushqyerje. Vitet e fundit, komponenti i ushqyerjes (menyja) është përditësuar dhe shpërndarë në të gjitha çerdhet⁵⁶. Tarifat e pagesave nga familja aplikohen vetëm për vaktet e ngrëna nga fëmijët. Ky shpenzim subvencionohet nga njësitë e pushtetit vendor. Funksionin e monitorimit të shërbimit të ofruar në çerdhe, pushteti vendor e ndan me Inspektoratin e Shëndetësisë dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Numri i çerdheve dhe fëmijëve që frekuentojnë këtë shërbim është i panjohur, edhe pse pushteti vendor duhet të raportojë tek ASHMDF të dhëna⁵⁷. Për herë të parë ofrohen të dhëna për 46 fëmijë Romë të regjistruar në 9 çerdhe në 2014⁵⁸.

Në përgjithësi, mungojnë vlerësimet mbi aspekte të ndryshme të shërbimit në çerdhe. Për të evidentuar situatën e shërbimit vijnë në ndihmë studime me fokuse të ndryshme të ndërmarra nga UNICEF:

⁵³ Banka Botërore (2014) "Raporti QSRMA – Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme", Tiranë, Shqipëri.

⁵⁴ Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor"

⁵⁵ Rregullorja higjieno-sanitare (26.10.1994) "Për ngritjen dhe funksionimin e çerdheve" Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit.

⁵⁶ <http://www.shendetesia.gov.al/al/publikime/shendeti-publik/dokumenta-mbi-shendetin-publik>

⁵⁷ VKM Nr. 267, datë 12.04.2012 "Llojet dhe mënyrën e shkëmbimit të informacionit e të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF-ja e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor"

⁵⁸ CRCA, YËCA, Observatory (2014), "Studimi kombëtar - Aksesi i fëmijëve Rom në arsim dhe shërbimet shëndetësore", UNICEF, Shqipëri

- Aksesit në çerdhe është i kufizuar në Shqipëri, veçanërisht në zonat rurale⁵⁹.
- Shërbimet janë përgjithësisht të lidhura me kujdesin e përditshëm, dhe asnjë praktikë pedagogjike nuk është e disponueshme. Ekziston një staf i kufizuar në nivel kompetencash dhe njohurish.
- Dokumentacioni që organizon dhe orienton funksionimin e këtij shërbimi është tepër i vjetruar⁶⁰. Për shkak të varësisë nga pushteti vendor, shërbimi funksionon i izoluar nga njëra njësi tek tjetra, me eksperiencave shumë të limituara të ndarjeve të eksperiencave pozitive.
- Shërbimi nuk i përgjigjet të drejtave dhe nevojave të fëmijëve duke mos respektuar standardet më të mira⁶¹.
- Çerdhet vlerësohen përtej një shërbimi të kujdesit të fëmijëve, si pika referimi komunitare për mirërritjen e brezave, por ato aktualisht nuk arrijnë të shërbejnë si pikë hyrjeje për shërbime të tjera të ofruara në komunitet për fëmijën dhe familjen

Arsimi parashkollor (publik dhe privat) është organizuar në kopshte dhe në klasa përgatitore ku edukohen fëmijët 3 deri 6 vjeç dhe nuk është i detyruar. Klasat përgatitore funksionojnë kryesisht në shkollat e arsimit bazë dhe frekuentohen nga fëmijë të moshës 5 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor.

Raportimi i regjistrimit neto varet nga burimi, nga 33% (LSMS 2012), në 76% (INSTAT, 2013). Sipas burimeve të LSMS (2012), arsyet kryesore që prindërit nuk i regjistrojnë fëmijët në kopsht vjen nga besimi se ata janë akoma të vegjël, dhe është më mirë për ta kujdesi në familje (25% e prindërve), veçanërisht kjo e shprehur tek prindërit me fëmijë 3-4 vjeç.

Bazuar në të njëjtën bazë të dhënash, përqindja e fëmijëve 3-5 jashtë sistemit parashkollor respektivisht 86.8%, 69.3% dhe 41.5%⁶².

Standardet e përmbajtjes, standardet e arritjes, si edhe programet për secilën grupmoshë janë dokumentet mbështetës dhe orientues për ofrimin e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve në kopshte. Ato nxisin zhvillimin e fëmijës në fushën e shëndetit fizik, qasjes ndaj të nxënës, zhvillimit social dhe emocional, zhvillimit kognitiv dhe gjuhësor dhe zhvillimit të aftësive motorike.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve aktualisht kufizohet nga mungesa e pajisjes së kopshteve me orëdit dhe mjete didaktike për të realizuar aktivitete të ndryshme, mungesa e mjediseve të përshtatshme të brendshme dhe të jashtme për aktivitete të ndryshme, fokusimi në 'shkrim e numra', programe të orientuara nga mësuesit dhe jo nga nevojat e fëmijëve, mungesa e një përjasjeje gjithëpërfshirëse/holistike institucionale ndaj nevojave të fëmijëve brenda dhe jashtë institucionit (me aktorë të tjerë, familjet e fëmijëve apo komunitetin e gjerë)⁶³.

Arsimi bazë fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Shtetasit, që mbushin moshën

⁵⁹ Rodríguez, A. M. (2013) "Impakti i shërbimeve të kujdesit dhe zhvillimit të fëmijërisë së hershme mbi fuqizimin e grave në Shqipëri", UNICEF Shqipëri.

⁶⁰ Haxhiymeri E., Ndrio M., Hallkaj E., Boci A., (2013) "Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, çerdheve dhe institucioneve të kujdesit rezidencial për fëmijët 0-3 vjeç", UNICEF, Shqipëri, Nëntor 2013.

⁶¹ Hallkaj, E., Binaj, I. (2011) "Kosto e shërbimit në çerdhet në Tiranë", UNICEF, 2012

⁶² Ravens, J.V. (2014), 'Parashkollor universal për 5 vjeçarët', UNICEF Shqipëri

⁶³ Qendra Burimore për Mirëqënien e Fëmijëve dhe Familjes (2014) "Praktikat e përfshirjes në sistemin parashkollor në Shqipëri", Save the Children, Shqipëri

16 vjeç, por që nuk arrijnë ta përfundojnë arsimin bazë, mund ta përfundojnë atë në shkollat me kohë të pjesshme.

Për vitin 2013-2014, numri i nxënësve që përfundojnë arsimin bazë dhe vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë ka arritur në 92%. Raporti mësues nxënës për arsimin bazë është përafërsisht 1:16. Numri i shkollave private të arsimit bazë përbën 8.5%. Numri i nxënësve që ndjekin arsimin privat përbën 7.2% të numrit të përgjithshëm të nxënësve.

Ndryshimet në hartën e përqendrimit të popullsisë kanë sjellë rritje të numrit të nxënësve (veçanërisht në arsimin bazë) në shkollat e qendrave të mëdha urbane dhe ulje të numrit të nxënësve në zonat rurale. Nga 1070 shkollat me klasa të bashkuara (ku numri i nxënësve është nën 40), mundësia për përqendrim pranë një shkolle tjetër 9 vjeçare zbatohet vetëm në 321 shkolla. Shpërqendrimi i institucioneve arsimore ka cenuar cilësinë e procesit mësimor-edukativ për 5243 nxënës⁶⁴.

Braktisja shkollore është dukuri e dukurive të dukura. Statistikat përgjithësisht pasqyrojnë vetëm kontingjentin e nxënësve që janë regjistruar dhe më pas kanë braktisur shkollën. Shqetësimi themelor mbeten fëmijët "e padukshëm", të cilët nuk e frekuentojnë shkollën dhe, për më tepër, nuk janë të identifikuar, pasi nuk shfaqen në asnjë regjistrë shtetëror. Përveç kësaj kategorie, janë edhe fëmijët "gjysmë të padukshëm" për sistemin si edhe "fëmijët në rrezik për ta braktisur shkollën" që përbëhen kryesisht nga fëmijë romë-egjiptianë dhe të tjerë nga familje në vështirësi ekonomike dhe sociale etj.

Infrastruktura (kushtet) fizike të shkollave mbeten problematike. Aktualisht janë evidentuar 58 objekte arsimore në rrezik shembje; 287 objekte arsimore që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për probleme serioze të strukturave ndërtimore; 1231 objekte që paraqesin shenja amortizimi, ndaj kërkohet ndërhyrje⁶⁵.

Përsa i përket *infrastrukturës së mësimdhënies*, shkollat publike disponojnë laboratorë demonstrues të lëndëve fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi, por në shumë raste ata nuk janë funksionalë. Mosfunksionimi i laboratorëve vjen si rezultat i sasisë së pamjaftueshme të mjeteve laboratorike dhe mjediseve të nevojshme për ngritjen e klasave laborator. Jo gjithmonë mjetet laboratorike që ofrohen nga DAR-et, përputhen me kërkesat e programeve për këto mjete, apo të nevojave që kanë realisht shkollat⁶⁶. Gjithashtu, koordinimi jo i mirë ndërmjet shkollave dhe DAR-ve, si dhe mungesa e fondeve ka bërë që bibliotekat të mos furnizohen me tituj të rinj librash që shërbejnë për nxitjen, motivimin dhe përqasjen e nxënësve ndaj librit.

Inspektimet e fundit të MAS evidentojnë 1184 mësues tepër në të gjithë Shqipërinë mbi nevojat, 2065 mësues jashtë profilit dhe 1984 mësues që janë pa arsimin përkatës⁶⁷. Edhe pse aktualisht modeli i *rregullimit të profesionit*

⁶⁴ Karameta, P. et al (2014) "Reforma e sistemit arsimor parauniversitar" – Raport Vlerësues paraprak, Grupi I punës për reformimin e arsimit parauniversitar, MAS

⁶⁵ ibid

⁶⁶ Gjedia, R., et al (2013) "Raport Vlerësimi i fushave 'Klima dhe Etika në Shkollë dhe 'Kujdesi ndaj Nxënësit'" IKAP

⁶⁷ <http://www.arsimi.gov.al/al/neesroom/lajme/msues-per-shqipërinë-kapitull-i-ri-per-reformën-në-arsim&page=1>

të mësuesisë është i krahasueshëm me përvojat e vendeve të tjera, ai po has vështirësi në testimet për licencë, pagesën e mësuesve praktikantë dhe mungesën e mentorëve profesionistë. Për më tepër trajnimi i punonjësve arsimorë është konceptuar nga individët dhe institucionet më shumë si element fakultativ. Planifikimi vjetor i trajnimeve nuk mbështetet në plane kombëtare dhe/ose vendore. Trajnimet nuk janë planifikuar sipas standardeve profesionale dhe përmbajtja e tyre nuk është hartuar për të përmirësuar kompetencat profesionale. Në seancat trajnuese, vendin e metodave ndërvepruese e kanë zënë përgjithësisht leksionet. Shërbimi trajnues është i kufizuar për nga larmia e agjencive ofruese, pasi në to nuk janë të përfshira sa e si duhet universitetet. Ky proces vuan nga përshtatshmëria tejet e ulët ndaj nevojave individuale dhe ekipeve të mësuesve, në veçanti, ndaj mësuesve të rinj. Kjo ka bërë që, në shkollat, procesi i të nxënies të rezultojë si përzjerje e praktikave të vjetruara me idetë e reja, por të paqarta ose të patretura mirë⁶⁸.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsim mbetet sfida. Megjithë përmirësimin e kuadrut ligjor ekzistojnë raste kur fëmijëve me aftësi të kufizuara iu refuzohet pranimi në shkollat e zakonshme. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar diskriminimin e fëmijës me aftësi të kufizuara për shkak të dështimit të strukturave përgjegjëse për të bërë vlerësimin individual të nevojave të nxëniesit nëpërmjet Komisioneve Multidisiplinare, në zbatim të parashikimeve ligjore që rregullojnë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.⁶⁹

Vëzhgimet dhe intervistat e kryera në një numër të madh kopshtesh dhe shkollash të zakonshme publike në vend si pjesë e një vlerësimi⁷⁰ të fokusuar në këtë tematikë tregojnë se aktualisht godinat nuk janë të përshtatura dhe mikpritëse për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në shkollat e vizituara, përveç rampave të vendosura në hyrje të shkollës, elementët e tjerë lehtësues mungojnë. Për këtë arsye, fëmijët me aftësi të kufizuara fizike vendosen në klasat e katit të parë të shkollës; katet e tjera nuk janë të aksesueshme. Pjesa më e madhe e drejtuesve të kopshteve dhe shkollave nuk arrijnë të identifikojnë çfarë është e nevojshme të përshtatet në godinë për të mundësuar përfshirjen e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Infrastruktura e godinave të kopshteve dhe shkollave është kompetencë e bashkive dhe komunave, të cilat shprehin si arsye kryesore për mungesën e përmirësimit të kushteve të infrastrukturës pamundësinë financiare.

Drejtuesit e DAR-eve pohojnë se, në mbi 60% të kopshteve dhe shkollave, mjetet mësimore nuk janë në përputhje me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe, në mbi 25% të rasteve, gjendja e mjeteve mësimore dhe pajisjeve është pjesërisht e përshtatshme.

Akomodime të tilla si instruksione në gjuhën e shenjave dhe instruksione dhe materiale mësimore në Braille për fëmijët me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe shikim nuk zbatohen.

Kurikula është shumë "e rënduar" për fëmijët e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale. Si në

⁶⁸ Karameta, P. et al (2014) "Reforma e sistemit arsimor parauniversitar" – Raport Vlerësues paraprak, Grupi i punës për reformimin e arsimit parauniversitar, MAS

⁶⁹ Vendimi Nr. 92 datë 25.10.2013 Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁷⁰ Save the Children Shqipëri (2013) Arsimi Gjithëpërfshirës në Shqipëri – Studim Analitik, Tiranë.

shkollat e zakonshme ashtu edhe në ato special mungojnë tekstet mësimore të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara. As mësuesit nuk kanë një udhëzues për përshtatjen e kurikulës për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Në zbatim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 69/2012, shkolla ofron *shërbim psikologjik*, dhe atë të mbështetjes nga punonjësi social. Urdhri Nr. 344 datë 19.08.2013⁷¹ Për ngritjen e njësisë së shërbimit Psiko-Social⁷² fuqizon dhe riorienton funksionin e këtij shërbimi. Aktualisht nuk është e qartë as shpërndarja apo shtrirja e shërbimit psiko-social. Kjo, për shkak se shërbimi ose nuk është ngritur, ose është ngritur në kundërshtim me specifikat e urdhrit. Nuk mbulohen me specialistë të gjitha institucionet arsimore, për shkak të vështirësive infrastrukturore apo të pozicionit gjeografik të shkollave. Gjithashtu, 25.1% e psikologëve shkollorë nuk janë punësuar duke respektuar kriterin e arsimit të duhur, sipas urdhrit të lartpërmendur.

Pothuajse në të gjitha shkollat e inspektuara nga IKAP në 2013⁷¹, janë ngritur organet kolegjiale si: Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Pedagogjik, Qeveria e Nxënësve dhe Këshilli i Disiplinës, por funksionimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë e vazhdueshme. Mungesa e një bashkëpunimi efikas me to reflekton një hallkë "të këputur" të funksionimit të mirë të institucioneve arsimore.

Aktualisht, **arsimi i mesëm** ofrohet si *arsim i mesëm i përgjithshëm* (gjimnaz), *arsim profesional* dhe *arsim i orientuar*. Gjimnazet përbëhen nga 3 vite shkollimi, ndërsa arsimimi në shkollat me kohë të pjesshme zgjat 4 vjet. Koha e arsimit të mesëm profesional është e organizuar në dy, tre dhe katër vjet. Arsimi i orientuar përfshin shkollat e gjuhëve të huaja dhe zgjat 3 vjet, ndërsa arsimi i mesëm për fushat e artit dhe sportit zgjat tre ose 4 vjet.

Arsimi i mesëm me kohë të plotë është i hapur për t'u frekuentuar nga të gjithë nxënësit që përfundojnë arsimin bazë, me moshë jo më të madhe se 18-vjeç. Forma alternative e arsimit (me kohë të pjesshme), për këtë nivel arsimor, është e hapur. Arsimi i mesëm ofrohet: a) me kohë të plotë; b) me kohë të pjesshme; c) në distancë. Forma e arsimit në distancë nuk ka gjetur zbatim. Frekuentimi i arsimit të mesëm të orientuar kufizohet nga kritere preference dhe kryesisht merite.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm ka njohur një rritje të konsiderueshme të aksesit gjatë viteve të fundit duke arritur në 70% nivelin neto të regjistrimit (INSTAT 2013). Pabarazitë në arsimin mesëm janë të ndjeshme, 87% të pasurve marrin pjesë kundrejt 56.5 të varfërve. Matura shtetërore ka sjellë përmirësime në zbatim pas një eksperience disavjeçare ndërkohë që kurikula e re e shkollës së mesme të përgjithshme, gjimnazit nuk është konceptuar ende në bazë të kompetencave.

Që nga viti 2009/10, sistemi i **Arsimit Fillestar Profesional** (AFP) është 2+1+1, në mënyrë që t'u ofrojë studentëve si arsimin e përgjithshëm, ashtu edhe atë profesional (teorik dhe praktik), duke i përgatitur për punë dhe arsimim të mëtejshëm. AFP përbëhet nga Shkollat e arsimit profesional dhe Qendrat e kualifikimit profesional. Arsimi dhe formimi teknik-profesional ofrohet në 53 shkolla (44 publike, duke përfshirë degët në shkollat e mesme të përgjithshme dhe 9 private), kryesisht të gjitha me vendndodhje në zonat urbane. Shumica e

⁷¹ Gjedia, R., et al (2013) "Raport Vlerësimi i fushave 'Klima dhe Etika në Shkollë dhe 'Kujdesi ndaj Nxënësit'" IKAP

shkollave ofrojnë dy deri në katër profile, ndër to vetëm një e katërta e të gjitha shkollave ofrojnë më shumë se tetë zgjedhje profesionale.

Përsa i përket infrastrukturës vihet re se mjediset e reparteve të punës në shkolla janë të vjetruara dhe në shumë raste mësimdhënia ofrohet në ndërtesa tërësisht të amortizuara.⁷²

Brendia e arsimit profesional ka kaluar nga prodhimi drejt profesioneve të shërbimit (ekonomi, menaxhim, hoteleri, turizëm, dhe TIK). Gjithsesi, përpunimi i standardeve dhe programeve profesionale, i orientuar drejt përfundimit të kompetencave dhe futja e praktikave në ndërmarrje kanë mbetur prapa. Ende ka pak programe ekzistuese pasdetyësore të arsimit dhe kualifikimit profesional për të diplomuarit nga shkollat e mesme, të cilat të jenë në gjendje t'i përgjigjen kërkesës në rritje të ndërmarrjeve dhe që u mundësojnë individëve të hyjnë dhe të dalin nga arsimit dhe kualifikimi në kohë të ndryshme të karrierës së tyre.

Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin profesional pësoi rënie gjatë periudhës 2006-2011 me rreth 38 për qind, për të rifituar ngritje në një farë mase gjatë vitit shkollor 2011 - 2012. Kjo ka qenë pjesërisht rrjedhojë e faktorëve demografikë (numri i nxënësve që ndjekin arsimin parësor dhe dytësor pati një rënie me afërsisht 10 për qind gjatë periudhës 2001-2010), por kryesisht pasojë e arritjeve të dobëta të sistemit të AFP. Aftësia tërheqëse e arsimit profesional është ende e dobët, pasi konceptohet si rruga e dytë më e mirë drejt arsimit tretësor, dhe jo si një rrugë për të hyrë në tregun e punës. Shumica e nxënësve të cilët regjistrohen në shkollat profesionale janë persona me rezultate shumë të ulëta shkollore. Shumë prej tyre mendojnë se është më e lehtë të kalosh klasën në shkollat e AFP. Drejtuesit e shkollave e pranojnë që më shumë se 50% e nxënësve të diplomuar në AFP-të paraqesin kërkesë për studime universitare dhe shumë nga ata regjistrohen në universitete private, edhe në profile që nuk kanë asgjë të përbashkët me profilet të cilat i ndoqën në shkollat profesionale.

Të diplomuarit nga shkollat profesionale janë kryesisht meshkuj, veçanërisht gjatë viteve të fundit, gjë e cila tregon se arsimit profesional ndiqet kryesisht prej tyre. Fenomeni gjinor, pra numri shumë i vogël i vajzave në krahasim me atë të djemve ndodh për shumë arsye. Faktorët që i shkurajojnë ato (dhe prindërit e tyre) për të mos zgjedhur arsimin profesional kanë të bëjnë me stereotipin thellësisht gjinor të profileve dhe kurseve, vendndodhjen e shkollave profesionale, mungesën e transportit, konviktet e pasigurta dhe klimën e përgjithshme sociale në shkollat e AFP-së. Megjithatë, edhe pse zhvendosja drejt profesioneve/profileve 'të reja' në sektorin e shërbimeve pritet të tërheqë si djem ashtu edhe vajza, dhe mundësisht të favorizojë përfshirjen e vajzave, numri i vajzave që ndjekin AFP ka pësuar rënie. Me qëllim arritjen e rezultateve pozitive në tregun e punës për femrat, është i nevojshëm trajtimi i arsyeve themelore të kësaj prirjeje, veçanërisht në sektorët që parashikohen si shtysë për ekonominë shqiptare dhe për rritje të mëtejshme në vitet e ardhshme.

Arsimimi për karrierën, si një mjet për të ndihmuar nxënësit dhe familjet e tyre për të marrë vendime është ende i pamjaftueshëm. Ende nuk ka një sistem gjurmimi për arsimin profesional, i cili do të ndihmonte për përcaktimin e rrugëve

⁷² MMSR "Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt", Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014-2020

të karrierës për të diplomuarit femra dhe meshkuj, duke përfshirë si punësimin e tyre, ashtu edhe/ose studimet pas-dytësore apo tretësore⁷³.

Ecuria

Mirërritja e fëmijëve në çerdhe

Situata aktuale dhe nevojat për ndryshim në kuadër të organizimit dhe ofrimit të shërbimit për fëmijët 0-3 vjeç është pasqyruar në një raport vlerësimi të mbështetur nga UNICEF⁷⁴. Realizuar në perspektivën e zbatimit të standardeve të zhvillimit të fëmijës, me fokus edukimin në të prezantohen rekomandime për të promovuar kujdesin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Njohja e nevojave dhe problematikave për shërbimet e fëmijëve në çerdhe vlerësohet si një hap pozitiv, marrë në konsideratë 'errësirën' e deritanishme për shërbimin e ofruar për këtë grupmoshë, si në kuadër të frekuentimit, dhe atë të cilësisë së shërbimeve të marra.

Në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbështetur nga UNICEF, janë hartuar standardet fizike të ndërtimit të çerdheve, që i përgjigjen nevojave zhvillimore të fëmijëve të vegjël sipas standardeve bashkëkohore⁷⁵, por ato janë të painteguara aktualisht në dokumentet rregullatorë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Standardet e kujdesit dhe zhvillimit për fëmijët 0-3 vjeç janë zhvilluar nga një grup profesionistësh të fushës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Arsimit mbështetur nga UNICEF, por ende të pamiratuara nga ndonjë Këshill Bashkiak në vend.

Arsimi parashkollor

81,448 fëmijë frekuentuan kopshtet (publike dhe private) në vitin shkollor 2013-2014. Nga 383 klasat përgatitore, përfituan 9100 fëmijë. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të përfshirë në sistemin publik parashkollor ishte 319. Numri i fëmijëve Romë regjistruar në kopshte është 630, 39.2% më shumë sesa në vitin 2011⁷⁶. Numri i mësueseve në kopshte është 4462, prej të cilave 71% janë me arsim të lartë. Raporti fëmijë/mësuese në kopshte është 18:1, ndërsa raporti fëmijë/grup në kopshtet është 22:1. Numri i institucioneve arsimore private përbën 8.4% të numrit të përgjithshëm. Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin privat parashkollor përbën 6% të numrit përgjithshëm. Shpenzimet për vitin e raportuar për kopshtet përfaqëson 7.2% të totalit të buxhetit për arsimin⁷⁷.

Edukimi parashkollor në Shqipëri po i nënshtrohet disa reformave të rëndësishme që kanë të bëjnë me aksesin dhe përmirësimin e cilësisë në parashkollor. Në këtë kuadër, MAS ka ndërmarrë një sërë masash, të cilat synojnë:

⁷³ MMSR "Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt", Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, 2014-2020

⁷⁴ Haxhiymeri E., Ndrio M., Hallkaj E., Boci A., (2013) "Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, çerdheve dhe institucioneve të kujdesit rezidencial për fëmijët 0-3 vjeç", UNICEF, Shqipëri, Nëntor 2013.

⁷⁵ <http://www.unicef.org/albania/Standartet-e-Cerdheve.pdf>

⁷⁶ CRCA, YÉCA, Observatory (2014), "Studimi kombëtar - Aksesin e fëmijëve Romë në arsim dhe shërbimet shëndetësore", UNICEF, Shqipëri

⁷⁷ Banka Botërore (2014) "Raporti QSRMA – Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme", Shqipëri.

- Universalizimin e vitit parashkollor (5-6 vjeç) në Shqipëri, si pjesë e paketës së rishikuar për krijimin e një seti standardesh të arsimit parashkollor sipas modeleve bashkëkohore; Kjo ndërmarrje, që pritet të përfundojë në 2015, do të realizohet nga grupe multidisiplinore specialistësh, mbështetur nga ekspertizë ndërkombëtare;
- Përgatitjen e kurikulës së parashkollorit;
- Hartimin e paketës trajnuese për mësuesit;
- Specifikimin e treguesve monitorues/vlerësues të cilësisë dhe rezultateve të të nxënit.

MAS, MMSR dhe UNICEF kanë bashkëpunuar në përmirësimin e përfshirjes së hershme të fëmijëve Romë të moshës parashkollore në Shqipëri nën ndërhyrjen “Çdo fëmijë Rom në kopsht”. Lehtësuar nga udhëzimi i MAS⁷⁸ për përfshirjen me përparësi të fëmijëve Romë në kopshte dhe monitorimin në vazhdim të situatës së frekuentimit, nga shtatori 2013-shtatori 2014 janë regjistruar mbi 300 fëmijë.

Arsimi bazë

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së të nxënit, si edhe për t’u përshtatur me prirjen e zhvillimit të shoqërisë tonë si një shoqëri e dijes e shekullit 21 dhe integrimin evropian, MAS nëpërmjet reformës të iniciuar në arsimin parauniversitar, ka shpalosur vizionin për ndryshimin e *kurikulës*, me fokus zhvillimin e kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës⁷⁹.

Sipas vizionit të ri, në qendër të arsimit janë nxënëset/nxënësit me nevojat dhe interesat e tyre, në ndryshim rrënjësisht nga sistemi tradicional që e detyron nxënësin t’i përshtatet atij mekanikisht.

Qëllimi i reformës është krijimi i kushteve më të mira të mundshme që nxënëset/nxënësit, pavarësisht mundësive dhe rrethanave vetjake, të përgatiten si qytetarë aktivë për të marrë pjesë në mënyrë krijuese dhe kritike në jetën ekonomike, shoqërore e kulturore të vendit dhe të aftësohen për t’u përshtatur ndryshimit të rrethanave në shoqërinë demokratike të dijes.

Kurikula e re do të ofrojë zgjidhje që mbajnë parasysh nevojat vetjake dhe stilet e të nxënit, si dhe përvojat mësimore paraprake të nxënësve, si kusht për përmirësimin e nivelit të arritjeve të tyre. Ajo do të hartohet dhe të zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grupmoshave dhe në varësi të mundësive dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë. Kurikula do t’i qartësojë nxënësit dhe prindërit për drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në shkallë dhe nivele të ndryshme arsimore, të cilat janë bazë për nivelet dhe shkallët pasardhëse. Nxënia sipas kurikulës së reformuar do të bëhet nëpërmjet situatave të lidhur me kontekstet e të nxënit, të cilat mbështetin dhe ndihmojnë zhvillimin e kompetencave⁸⁰.

Për të përmirësuar *kushtet/mjediset fizike* në shkolla, ndërtimin e shkollave të reja si edhe rehabilitimin e atyre ekzistuese, në 2013, janë ndërtuar ose rikonstruktuar

⁷⁸ Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Udhëzim 21, datë 08.08.2014 “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët Romë”

⁷⁹ MAS, Urdhri Nr. 323, datë 07.08.2014 “Për pilotimin e kurikules së re në institucionet arsimore të arsimit bazë në sistemin arsimor parauniversitar”

⁸⁰ Karameta, P. et al (2014) “Reforma e sistemit arsimor parauniversitar” – Raport Vlerësues paraprak, Grupi I punës për reformimin e arsimit parauniversitar, MAS

1336 objekte arsimore, nga të cilat 359 janë objekte të reja dhe 977 objekte të rikonstruara.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, mbështetja me udhëzimet mbështetëse për përmirësimin e standardeve të përgjithshme të mësuesve⁸¹ dhe kriteret e procedurat e kualifikimit për mësuesit⁸², ka vijuar me iniciativën më të re të MAS "Mësues për Shqipërinë". Kjo iniciativë synon të nxisë përthithjen e profesionistëve në sistem, por edhe menaxhimin e burimeve njerëzore në arsimin parauniversitar, përmes ngritjes së një portali online për punësim.

Në kuadër të gjithëpërfshirjes së fëmijëve, është bërë hartimi i udhëzimit që përcakton organizimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme⁸³. Ky udhëzim u vjen në ndihmë nxënësve që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë. Përforcohet në këtë kuadër edhe e drejta e ndjekjes së "shansit të dytë" për fëmijët deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç, për të gjithë ata që kanë braktisur shkollën, e ndërpresin ose nuk e kanë ndjekur dhe nuk kthehen në shkollën bazë me kohë të plotë dhe as nuk ndjekin shkollën bazë me kohë të pjesshme.

Për të adresuar braktisjen shkollore, marrëveshja⁸⁴ e nënshkruar nga MAS, Ministria e Punëve të Brendshme, MMSR dhe Ministria e Shëndetësisë, është pasuar nga udhëzime specifike për Ministrinë dhe draft udhëzimi i përbashkët është në pritje të miratimit.

Një tjetër udhëzim⁸⁵ synon të garantojë gëzimin e të drejtës për të ndjekur arsimin bazë me kohë të plotë, brenda moshës së arsimit të detyruar, fëmijëve që për arsye të ndryshme nuk janë regjistruar në kohë, kanë ndërprerë shkollimin për më tepër se dy vite.

Në dobi të rritjes së përfshirjes së **fëmijëve romë** në shkollat e arsimit parauniversitar është krijuar databaza e të dhënave për regjistrimin e fëmijëve romë, të moshës së detyrimit shkollore, në kopsht dhe shkollë, nga viti 2010 e në vijim. Fëmijët romë në arsimin e detyruar kanë vazhduar të përfitojnë tekstet shkollore falas në shkollën ku janë të regjistruar.

MAS mbështetur nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë e vendorë kanë realizuar iniciativa të ndryshme me fokus familjet dhe fëmijët romë, si kampe verore, ofrimi i ushqimit në shkollë, veprimtari kulturore, kualifikime specifike për mësues.

Në bordet e shkollave pranë komuniteteve Rome është inkurajuar përfshirja e prindërve në organet kolegjiale. 98 prindër Romë dhe Egjiptianë janë pjesë e bordeve të shkollave (nga rreth 63 shkolla ku rezulton prania e fëmijëve të komunitetit Rom).

⁸¹ MAS, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.02.2013 "Për standardet e përgjithshme të mësuesit"

⁸² MAS, Udhëzimi Nr. 2, datë 05.02.2014 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve"

⁸³ MAS, Udhëzimi Nr. 29, datë 02.08.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme."

⁸⁴ Marrëveshja e përbashkët (2013) "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë të moshës së detyrimit shkollore"

⁸⁵ MAS, Udhëzimi Nr. 31, datë 02.08.2013 "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasë të arsimit bazë."

Për të përmirësuar shërbimin psiko-social në kopshte dhe shkolla, si edhe për të siguruar një mjedis mbështetës, një grup pune multidisiplinar është krijuar nga MAS për hartimin e një udhëzimi të ri mbi këtë shërbim. Përmes tij, synohet të përmirësohet mbulimi me shërbim, dhe përforsimi i rolit të punonjësit social.

Arsimi Fillestar Profesional

Qeveria shqiptare ka shpallur në programin e qeverisë për periudhën 2013-2017 se do të zbatojë një model të ri, për rritjen e ekonomisë së vendit gjatë 15 deri 20 vitet e ardhshme, bazuar në politika të strukturuar dhe të përpunuara më mirë, me një gamë më gjithëpërfshirëse, për t'i dhënë një shtysë maksimale rritjes ekonomike, për të siguruar qëndrueshmëri të komponentëve të saj, për të rritur produktin e brendshëm dhe shkallën e eksporteve, si edhe për të krijuar kushtet për hapjen e një numri të madh vendesh pune në sektorët ekonomikë më strategjikë të vendit.

Në këtë kuadër është hartuar Strategjia për Punësim dhe Aftësim 2014 – 2020, e cila është konsultuar me grupet e interesit. Kjo strategji ka si qëllim të nxisë vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi për gjithë femrat dhe meshkujt shqiptarë gjatë gjithë ciklit të jetës dhe përbën një hap shumë të rëndësishëm për sistemin e AFP. Në kuadër të kësaj strategjie, janë hartuar politika që synojnë përmirësimin e perspektivave për punësim të cilat do të kenë një fushë më të madhe veprimi, ndërsa programet do të synojnë ata persona, të cilët janë në gjendje më të pafavorshme në tregun e punës, veçanërisht individët me nivel të ulët në arsim dhe kualifikim, si femrat, të rinjtë, grupet e tjera të cenueshme dhe ata persona, të cilët jetojnë në zonat rurale. Dizenjimi i një kuadri të ri për nxitjen e punësimit, do të sigurojë përdorimin e politikave më efikase dhe me më shumë burime për tregun e punës.

Objektivat dhe produktet e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi do të bëhen funksionale nëpërmjet Planit të Veprimit dhe dokumenteve të tjera të planifikimit tematik, të cilat janë hartuar tashmë dhe pritet të miratohen së bashku me strategjinë. Zbatimi i Planit të Veprimit do të mbikëqyret nëpërmjet treguesve të arritjeve, të cilët masin rezultatet e programeve aktive të tregut të punës, caktojnë përgjegjësitë për zbatim dhe përcaktojnë burimet financiare.

Për shumë vite, arsimi profesional ka patur mungesë të theksuar fondesh, megjithëse sasia e fondeve e caktuar në vitin 2012 pati një rritje prej më shumë se 28%. Më shumë se dy të tretat (77.8 për qind) e fondeve vjetore shkon për të mbuluar kostot për stafin, duke lënë burime të kufizuara për përmirësimin e pajisjeve, modernizimin e reparteve të punës dhe përgatitjen e kurikulave. Sipas Strategjisë për Punësim dhe Aftësim 2014 – 2020, buxheti i planifikuar nga MMSR për arsimin/kualifikimin profesional nga viti 2013 deri më 2020 do të rritet me 69.46%, duke pasur kështu një rritje mesatare për çdo vit prej 9.91%.



Çështje për adresim

Rritja e buxhetit për arsimin në të gjithë nivelet, bazuar në normat e vendeve të zhvilluara.

Rritja e aksesit të fëmijëve 0-3 vjeç në programe të kujdesit dhe zhvillimit, për të inkurajuar punësimin e prindërve, veçanërisht të nënave; rritja e aksesit gradual për të gjithë fëmijët 3-5 vjeçarë në kopshte duke përmirësuar efikasitetin e sistemit; përmirësimi i aksesit të arsimit profesional në zonat rurale, dhe nga vajzat; rritja e aksesit në arsimin bazë për fëmijët nga shtresat më vulnerabël si fëmijët në situatë rruge, fëmijët romë dhe egjiptiane, fëmijët me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta dhe fëmijët që jetojnë në zona të largëta dhe të izoluar.

Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve dhe shkollave sipas standardeve të ndërtimit, dhe sigurimi i bazës materiale për të përmirësuar mësimdhënien.

Përmirësimi i angazhimit të qeverisjes vendore për të ofruar shërbim cilësor të kujdesit dhe zhvillimit të fëmijëve në çerdhe dhe rritje të aksesit, përmes buxhetimit dhe aprovimit/zbatimit të standardeve të çerdheve. Miratimi i standardeve në nivel kombëtar për kujdesin dhe zhvillimin e fëmijëve 0-3 vjeç.

Shfrytëzimi i çerdheve dhe kopshteve si një hapësirë për të ndihmuar prindërit drejt modeleve të prindërimit pozitiv nëpërmjet trajnimeve, këshillimeve, etj.

Rritja e cilësisë së arsimit me bazë mësuesin duke investuar në kualifikim gjatë punës, motivimin e mësuesve dhe në vendosjen e kritereve të forta për cilësinë e mësimdhënies.

Përmirësimi i kurikulave për arsimin e mesëm dhe atë profesional me bazë kompetencash dhe për të lehtësuar praktikimin e aftësive të nxëna.

Përmirësimi i shërbimit psiko-social në shkolla, dhe ndërlidhjes së sistemit shkollor me sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Krijimi i lidhjeve me fakultetet që përgatisin mësues në mënyrë që praktikant, metodologjitë dhe kurikulat e reja të përfshihen edhe në lëndët e fakulteteve të mësuesisë.

Forcimi i ndëveprimit mes sistemit të arsimit e formimit profesional dhe industrisë dhe orientimi i arsimit profesional në një drejtim të kërkesave reale të tregut të punës.

Kontributi i Fëmijëve⁸⁶

Si është dhe dëshironi të jeta bota që ju rrethon?

Kemi paraqitur **familjen** me anë të një peme. Lulëzimi nuk është dhe aq i madh pasi nganjëherë familja nuk është aq e lumtur. Familja është shumë e rëndësishme dhe na përgatit për të ardhmen dhe duhet të jetë sa më e bashkuar.

Spitali është paraqitur me një monedhë lekësh pasi është shumë i korruptuar dhe pse duhet të jetë falas, por në të vërtetë duhet të paguash kur shkon dhe jo të gjithë njerëzit kanë të ardhura.

Një zemër për të paraqitur **dashurinë**. Është pikturuar në gjysmë, sepse jo të gjithë falin dashuri.

Libri tregon **arsimin**. Ka shumë fëmijë që nuk shkojnë për arsye të ndryshme dhe ne duam kjo të rregullohet, dhe kjo fytyra e mërziut të bëhet e qeshur.

Është paraqitur një shkop i cili simbolizon dhunën. **Dhuna** është e përhapur në shumë mënyra të ndryshme dhe kjo ndikon shumë keq në të ardhmen e fëmijëve.

Dy duart e kryqëzuara simbolizojnë **paqen** dhe ne duam që paqja të jetë kudo.


Në makinë është një fëmijë duke qarë. Në kohët e sotme ka fëmijë që **trafikohen** dhe dhunohen dhe kjo është një gjë shumë e keqe prandaj, këto prangat do të thonë që kush i bën këto gjëra duhet të dënohen sipas ligjit.

Kemi vizatuar **kishën** që mund të jetë dhe një xhami dhe ne nuk duam që kjo të ndryshojë pasi na ndihmon shumë dhe gjejmë mbështetje.

Alo 116 që është një linjë këshillimi shumë e mirë ku ne mund të drejtohem kur kemi nevojë.

Është vizatuar një laptop që tregon **internetin** që ne jemi shumë të lidhur por duam që të ndryshojë sepse aty jepen pamje që s'janë për ne. Dëshirojmë që të jetë më i sigurt.

⁸⁶ Grup diskutimi drejtuar nga ASHMDF me pjesëmarrjen e 20 të rinjve, në 12 nëntor 2014, në Shkodër, lehtësuar nga World Vision




V. E DREJTA PËR MBROJTJE LIGJORE

Situata

Të drejtat e fëmijëve kanë pësuar përmirësime të ndjeshme përmes iniciativave dhe reformave të gjithanshme ligjore dhe institucionale, duke i afruar ato me standardet Evropiane⁸⁷. Ministria e Drejtësisë, së fundmi, po harton Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur, e cila përbën një hap të rëndësishëm në lidhje me zgjidhjen e të gjitha çështjeve ligjore që lidhen me fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijëve nën 14 vjeç si dhe fëmijët viktime dhe dëshmitarë. Pavarësisht draftit të këtij dokumenti strategjik, sfida më e madhe në praktikë mbetet ngritja e një sistemi të drejtësisë miqësore⁸⁸, i cili merr parasysh si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës si dhe zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse me qëllim identifikimin e hershëm të fëmijëve me sjellje delinkuente dhe trajtimin e tyre jashtë sistemit të drejtësisë.

Fëmijët në konflikt me ligjin

Gjatë vitit 2013 numri i fëmijëve të denoncuar, bazuar në statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka qenë 1437 në shkallë vendi, nga të cilët, 485 prej tyre në Tiranë, 182 në Durrës, 118 në Elbasan, 145 në Fier etj. Numri i fëmijëve të dënuar në krahasim me totalin e denoncimeve është 624, nga të cilët 621 djem dhe 3 vajza. Statistikat tregojnë se 549 fëmijë janë dënuar për vepra penale dhe 75 prej tyre për kundravajtje penale. Pjesa më e madhe janë meshkuj, 546, dhe vetëm 3 femra. Rezulton gjithashtu, se vetëm 30 prej të dënuarve nuk kanë kryer arsim. Në vitin 2014, gjatë 6-mujorit të parë janë dënuar 386 të mitur, rreth 6.73% e totalit të të dënuarve në shkallë vendi. 382 prej tyre janë meshkuj dhe 4 janë femra. Në një vështrim krahasues mund të themi, se përfshirja në veprimtari kriminale gjatë vitit 2013 dhe 6-mujorit të parë të 2014 nuk ka një tendencë në rritje.



Fëmijët në konflikt me ligjin gëzojnë të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të

⁸⁷ Raport i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve.

⁸⁸ Në këtë kuadër, çështjet kryesore janë: i) mbajtja e fëmijëve në konflikt me ligjin jashtë sistemit të drejtësisë ii) ngritja e një sistemi të specializuar të drejtësisë për rinj si dhe; iii) ngritja dhe funksionimi i sistemi gjithëpërfshirës të drejtësisë për të rinj, i cili ka në qendër të tij drejtësinë restauruese.

respektimit të dinjitetit të tyre⁸⁹, të drejtën për ndihmë juridike dhe psikologjike që në kontaktin e tyre të parë me punonjësit e policisë⁹⁰. Megjithatë, jo rrallë procesi i drejtësisë për të miturit nuk është i përshtatshëm dhe miqësor për fëmijët. Marrja e tyre në pyetje bëhet në ambiente të papërshtatshme, nga punonjës policie që nuk kanë kualifikimin e duhur dhe në disa raste pa ndihmën e një avokati apo psikologu. Një hap pozitiv në këtë drejtim është miratimi i Urdhrit Nr. 300, datë 08.07.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Procedura Standarde Pune për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake”, me qëllim përcaktimin dhe qartësimin e procedurave që duhet të ndjekin dhe zbatojnë punonjësit e Policisë së Shtetit për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake⁹¹. Pavarësisht rregullit se të miturit duhet të mbahen të veçuar nga të rriturit, në komisaritet e policisë nuk ka dhoma të veçanta vetëm për të miturit dhe për këtë arsye ata vendosen në të njëjtën qeli me të rriturit. Me mbështetjen e organizatës Save the Children, Albania, gjatë vitit 2013 janë ngritur dhoma të intervistimit miqësor për fëmijët në 6 komisariate të policisë së Tiranës.

Në vitin 2007, me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë u ngritën “seksione të veçanta” për të mitur në gjashtë Gjykata të Rretheve Gjyqësore me numrin më të madh të çështjeve. Krijimi i këtyre seksioneve e ka përmirësuar dhënien e drejtësisë për të mitur në procesin gjyqësor.

Me qëllim garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi është e nevojshme ngritja seksioneve të veçanta në të gjitha Gjykatat e Shkallës së Parë në vend si dhe në Gjykatat e Apelit. Gjyqtarët kanë marrë trajnime mbi të drejtat e fëmijëve, megjithatë mbetet ende nevojë trajnime i tyre në fusha si teknikat e komunikimit dhe fazat zhvillimore të fëmijës. Trajnimi i avokatëve penalistë mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve, është gjithashtu një nevojë e paplotësuar.

Nga statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezulton se në 6-mujorin e parë të vitit 2014, numri mesatar i fëmijëve në paraburgim çdo muaj është rreth 98 dhe numri mesatar i fëmijëve që vuajnë dënimin me burgim çdo muaj rreth 16. Në 2013, numri mesatar i fëmijëve në paraburgim çdo muaj është rreth 84 fëmijë, ndërsa numri mesatar i fëmijëve që vuajnë dënimin me burgim është rreth 22. Mungon informacioni mbi kohëzgjatjen mesatare të të miturve në paraburgim apo burgim. Numri i të miturve në paraburgim mbetet shqetësues dhe fakti se shumica prej tyre ndodhet në paraburgim për vjedhje ose krime ndaj pronës private.

I mituri F, është fëmijë i një familje me pesë fëmijë. Ai ka kryer katër klasë shkollë dhe më pas e ka braktisur atë. Familja ndodhet në kushte të vështira ekonomike, pasi prindërit janë të papunë dhe ata mbijetojnë me të ardhura minimale që sigurohen nga puna e 2 motrave në rrobaqepësi.

I mituri akuzohet për veprën penale të “Vjedhje”, për të cilën Gjykata ka dhënë masën e arrestit në burg. Vjedhja e kryer nga i mituri përfshin vjedhjen e një

⁸⁹ Neni 28, Kushtetuta e R.Sh. Neni 40/1 KDF parashikon se “çdo fëmijë i dyshuar, i akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, ka të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon tek ai ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e tij si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj”.

⁹⁰ Neni 35, 48-49, Kodi i Procedures Penale.

⁹¹ Ky protokoll u përgatit nga Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe Terre des Hommes, me kontributin financiar të UNICEF, Bashkimit Europian dhe Save the Children Albania.

telefoni, një televizori, dhe një portofoli me shumën prej 5000 lekë. I mituri i ka shitur këto sende me çmime fare të ulta duke siguruar shpenzimet e tij të përditshme.

Për këto veprë, i mituri është arrestuar dhe ka qëndruar në paraburgim për rreth 7 muaj. Pas kësaj kohe, Gjykata e Shkallës së Parë ka marrë vendimin e dënimit me 1 vit e 4 muaj burg.

Trajtimi i të miturve në ambientet e paraburgimit/burgut duhet të bëhet në përshtatje me kapacitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë. Një vëmendje të veçantë merr ruajtja, përmirësimi ose rivendosja e lidhjeve të të miturve me familjen. Personeli mjekësor viziton çdo ditë të miturit dhe kontrollon periodikisht të gjithë të miturit, sipas një grafiku të hartuar nga drejtoria e institucionit. Elementë të rëndësishëm në edukimin dhe rehabilitimin e të miturve, është trajnimi profesional dhe pajisja me aftësi operacionale. Për këtë qëllim, organizohen kurse profesionale si zdrukthëtari, hidraulik, kompjuter, gjuhë e huaj, etj. Aktualisht, MMSR dhe MD kanë miratuar Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim përgatitjen për ri-integrim të personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim, nëpërmjet organizimit të formimit profesional në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), dhe krijimit të mundësive për ri-integrimin e tyre në shoqëri, pas lirit. Formimi profesional i personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim realizohet përmes kurseve të formimit profesional që zhvillohen në ambiente të veçanta të përshtatura për dhënie mësimi dhe praktikë profesionale pranë IEVP. Kurset e formimit profesional në IEVP do të zbatohen nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.

Në IEVP, zhvillohet procesi arsimor i detyrueshëm i ciklit 9 vjeçar për personat me liri të kufizuar. Procesi shkollor në IEVP, zhvillohet në bazë të marrëveshjes midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, mbi bashkëpunimin mbi procesin arsimor në IEVP. Kurikulat mësimore, planet, regjistri i shkollës dhe dokumentacionet e tjera, janë të njëtrajtshme me shkollat publike, duke qenë se shkollat në IEVP janë vartëse të tyre. Regjistrimi i nxënësve në shkolla kryhet mbi bazën e dokumentit të mbarimit të shkollës. Me përfundimin e shkollës, i mituri përfiton dëftesën nga shkolla përkatëse ku është regjistruar. Në total 45 të mitur kanë përfunduar ciklin mësimor 2013-2014. Të miturit, gjithashtu, janë të punësuar sipas mundësive që ofrojnë institucionet. Në total, 9 të mitur janë të aktivizuar në aktivitetet punësimi.

Pavarësisht progresit të arritur në trajtimin e të miturve në sistemin penitenciar, një nga çështjet më shqetësuese është zgjatja e hetimeve përtej afateve të parashikuara ligjore. Sipas legjislacioni penal, afatet procedurale janë të njëjta si për të rriturit edhe për të miturit, si në fazën e hetimit edhe në atë të gjyqimit⁹². Në caktimin e masës së sigurisë për të miturit, gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukuese⁹³ dhe masa e arrestit vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme⁹⁴. Nga analizimi i të dhënave rezulton se është e vështirë të llogaritet kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në paraburgim për një të mitur ndërkohë që mungojnë alternativat ndaj masës arrest me burg në rastet kur vepra penale e kryer është e një rrezikshmërie të vogël. Në këtë kuadër është e rëndësishme të


⁹² Neni 323, Kodi i Procedurës Penale.

⁹³ Neni 229/3, Kodi i Procedurës Penale.

⁹⁴ Neni 230/1, Kodi i Procedurës Penale.


përcaktohet qartë në legjislacionin penal cilat janë llojet e masave alternative të dhëna ndaj masës së sigurisë arrest në burg, roli dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi i provës si dhe një qasje e cila përfshin kontekstin familjar dhe komunitetin. Sipas Konventës së të Drejtëve të Fëmijëve, fëmijët duhet të kenë një legjislacion të posaçëm: kapituj të veçantë në Kodin Penal (KP) dhe Kodin e Procedurës Penale (K.Pr.P) ose një kod të mëvetshëm. Ministria e Drejtësisë (MD) ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e një kapitulli të veçantë për të miturit në K.P dhe K.Pr.P. Në këtë legjislacion duhet të gjejë rregullim edhe çështja e respektimit të afateve procedurale për të miturit.

Bazuar në të dhënat e studimit për sistemin penitenciar në Shqipëri, të realizuar nga Save the Children, Albania në bashkëpunim me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara dhe ARSIS, si dhe intervistimit të 25 fëmijëve në IEVP Kavajë, rezulton se perioda mesatare e paraburgimi është 0-6 muaj dhe vetëm për 2 % prej tyre është më shumë se 18 muaj kohë qëndrimi në institucion.



Gjithashtu, rezulton se 12 % e fëmijëve janë të moshës 15 vjeç, 4 % janë të moshës 18 vjeç, pjesa tjetër varion në kategorinë 15-18 vjeç.





Trajtimi i të miturit të dënuar në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) bazohet në Rregulloren e Posaçme të Institucionit. Në vitin 2009, në Kavajë është ngritur IEVP për të miturit e dënuar, i cili shërben edhe si institucion paraburgimi për të miturit nga rrethet: Elbasan, Durrës dhe Kavaje. Ky Institucion ofron programe rehabilituese edukimi, trajnimi profesional, aktivitete sportive dhe veprimtari zbatimëse, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ligji i ri për Trajtimin e të Dënuarve si dhe Draft Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, ende në fazë miratimi nga Ministria e Drejtësisë, rregullojnë trajtimin e të miturve në ambientet e paraburgimit.

Trajtimi i të dënuarve të mitur përfshin përgatitjen e tyre për riintegrim⁹⁵, qëllim ky që duhet të jetë në qendër të trajtimit të të miturit në sistemin e drejtësisë. Kjo realizohet nga stafet e edukimit në Institucion si dhe bashkëpunimi i tyre me qendrat e formimit profesional dhe OJF të ndryshme. Në varësi të moshës së të miturit të dënuar, sfidat për riintegrimin lidhen së pari, me riintegrimin e tij në shkollë dhe së dyti, me sigurimin e një rrjeti mbështetës dhe mbrojtës në komunitetin e fëmijës, hartimin e programeve në nivel të pushtetit vendor dhe punësimit. Në këto kushte: i) mbështetja e stafeve të IEVP-ve dhe/ose shërbimit të provës për të lehtësuar procesin e riintegrimin të të miturve dhe ii) ngritja e një sistemi të qartë referimi për aktorë të pushtetit vendor, hartimi i dokumenteve të përbashkëta për koordinimin e tyre, si dhe ngritja e shërbimeve mbështetëse me bazë komunitare, mbeten sfida për të ardhmen.

Prej vitit 2008, janë të zbatueshme dënimet alternative për të miturit⁹⁶, të cilat përfshijnë: gjysëm-lirinë, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë ose punë në interes publik dhe qëndrimi në shtëpi. Që prej fillimit të funksionimit të Shërbimit të Provës, numri total i personave të vendosur me

⁹⁵ Legjislatiioni penal parashikon ngritjen e programeve edukuese dhe shoqërore, të cilat synojnë përgatitjen për lirim të të miturit, veçanërisht gjatë 6 muajve të fundit të vuajtjes së dënimit

⁹⁶ Ligji Nr. 10024, Datë 27.11.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8331, Datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", VKM Nr. 302, Datë 25.3.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative".

vendim gjykatë në një rreth prej alternativave të dënimit me burgim është 9356, nga të cilët numri total i të miturve të është 1684. Siç mund të vihet re, ka një ndërgjegjësim për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim për të miturit, të cilët zënë rreth 18% të numrit total të tyre në shkallë vendi. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2014, numri i fëmijëve të dënuar me dënime alternative është 241, nga të cilët 7 femra dhe 234 djem. Ndërsa në vitin 2013, numri i fëmijëve të dënuar në total është 325, nga të cilët 3 femra dhe 323 djem. Nga një vështrim krahasues, në një mesatare të dy viteve 2013 dhe 2014, përgjatë një 6-mujori vihet re një tendencë në rritje e numrit të dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat për fëmijët në konflikt me ligjin. Llojet e dënimeve alternative të dhëna nga Gjykatat, gjatë vitit 2013-2014, për të miturit kanë qenë kryesisht punë në interes publik, kohë provë me detyrimin për të kryer një kurs profesional. Të miturve të dënuar me dënime alternative i garantohet e drejta e mbrojtjes dhe konfidencialiteti në dosjen personale. Zbatimi i dënimeve merr në konsideratë moshën, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale dhe ato shoqërore.

Shërbimi i Provës me mbështetjen e OSBE-se, ka hartuar "Sistemin e Vlerësimit për të Miturit dhe të Rinjtë në Moshë Madhore" me qëllim vlerësimin e rrezikshmërisë së të miturve dhe të rinjve në moshë madhore. Gjithashtu, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës është ngritur "Sektori i të Miturve, Shërbimeve Komunitare, Lirimit me Kusht dhe Statistikave", i cili inspekton punën e zyrave vendore me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të ofruar, rritjen e cilësisë së tyre si dhe zbatimin e kuadrit ligjor.⁹⁷

Me ngritjen e Shërbimit të Provës në vitin 2008, numri i zyrave rajonale të shërbimit të provës ka qenë 6 krahasuar me numrin 22 që janë aktualisht. Këto zyra ndeshen në Tiranë, Tropojë, Vlorë, Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnjë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë, Shkodër.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me mbështetjen e UNICEF, në tetor 2014, lançoi program "Google mapping", me të cilën bëhet i mundur identifikimi i zyrave vendore të shërbimit të provës si dhe i qendrave pritëse me të cilat mund të bashkëpunojnë për zbatimin e dënimit alternativ për të miturit. Ky program do të ndihmojë në menaxhimin më efektiv të të miturve në konflikt me ligjin, të cilët kanë marrë dënimin alternativ "punë në interes publik" si dhe do të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet gjykatave, njësive vendore dhe shërbimit të provës.

Me Urdhrin Nr. 100, datë 21.02.2014 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës", numri i stafit të shërbimit të provës është rritur nga 104 në 134 punonjës të arsimuar në fushën e drejtësisë, punës sociale dhe psikologjisë. Bazuar në këtë shifër, numri mesatar i punonjësve të shërbimit të provës në secilën zyrë vendore është 2-3 punonjës, me përjashtim të zyrës vendore Tirana, e cila për shkak të numrit më të madh të rasteve në ndjekje, ka mesatarisht 15-20 punonjës. Në çdo rast, stafet vendore nuk janë të mjaftueshme për ndjekjen e rasteve të fëmijëve të dënuar me dënime alternative dhe për ofrimin e shërbimeve cilësore, duke pasur parasysh ngarkesën e secilës zyrë si dhe mungesën e profilizimit të këtyre punonjësve në trajtimin e rasteve me të miturit.

⁹⁷ Urdhër Nr. 2, datë 11.01.2012 'Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Provës'.

Pavarësisht ecures së deritanishme të Shërbimit të Provës, mbetet ende sfidë mungesa e ambienteve të përshtatshme në funksion të ruajtjes së privatësisë së të miturit gjatë intervistimit të tij. Aktualisht, intervistimi i të miturve bëhet në ambiente të njëjta me të rriturit dhe në prani të personave të tjerë, të dënuar me dënime alternative apo staf i shërbimit të provës dhe nga punonjës të shërbimit të provës të cilët nuk kanë kualifikimin e nevojshëm për të trajtimin e këtyre rasteve. Largësia e vendbanimit nga zyrat e Shërbimit të Provës, bën që të miturit të kenë vështirësi për t'u paraqitur, pasi kjo sjell kosto shtesë për të dhe familjen e tij duke pasur parasysh faktin, se këta fëmijë vijnë nga familje me vështirësi ekonomike.

Dhënia e dënimeve alternative nga gjykata, veçanërisht për të miturit është e një rëndësie të veçantë. Ajo kërkon së pari një bashkëpunim efektiv të të gjithë aktorëve të përfshirë, shërbimit të provës, prokurorisë, gjykatës, organeve shtetërore qendrore dhe organeve të njëjste të qeverisjes vendore, OJF etj. Nevojitet gjithashtu më shumë sensibilizim për gjykatën në dhënien e dënimeve alternative si dhe hapje e zyrave vendore të shërbimit të provës në të gjithë vendit që t'i ofrojnë të miturve mbështetje gjatë gjithë kohës së kryerjes së dënimit. E një rëndësie të veçantë është ngritja e urave të bashkëpunimit ndërmjet shërbimit të provës dhe zyrave të punësimit me qëllim përfshirjen e kësaj kategorie automatikisht si punë-kërkues dhe qendrave të formimit profesional, të cilat të mundësojnë ofrimin e kurseve profesionale pa pagesë për këtë kategori. Mbështetje e vazhdueshme për shërbimin e provës është i nevojshëm, duke pasur parasysh ngarkesën e secilit specialist, pra numri i rasteve që ndjek një specialist i vetëm dhe nevojave specifike që paraqet ndjekja e rastit të një të mituri. Për lehtësimin e përmbushjes së detyrimit për t'u paraqitur pranë Shërbimit të Provës, është e nevojshme të zgjerohet numri i zyrave vendore duke e afruar më shumë këtë shërbim me të dënuarit. Së fundi, për të miturit të cilët kanë vështirësi në ndjekjen e programeve arsimore, duhet të vihet në zbatim praktika e lidhjes së Memorandumeve të Bashkëpunimit me Drejtoritë Arsimore Rajonale pranë Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës, me qëllim që të garantohen ngritja e programeve të veçanta për këtë kategori të miturish si dhe përfshirja e tyre në procesin e edukimit shkollor në rastet kur dënimi alternativ përfshinë detyrimin për ndjekjen e procesit arsimor.

Fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin

Sipas Kodit Penal (KP), të miturit nën moshën 14 vjeç përjashtohen nga ndjekja penale, por ata mund të jenë subjekt i masave edukuese apo rehabilituese. Sipas nenit 46 të KP, për fëmijë nën moshën e përgjegjësisë penale, Gjykata mund të marrë vendimin të dërgojë këta fëmijë në institucione edukimi. Këto masa nuk aplikohen në praktikë për shkak të mungesës së institucioneve të parashikuara në ligj.

Në vendimin gjyqësor për të miturin me iniciale G.F 13 vjeç, Gjykata e Rrethit vendosi dhënien e masës edukuese dhe dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.


Nga të dhënat e rastit rezulton se akuza e depozituar nga prokuroria ka qenë "Vjedhje e kryer më shumë se një herë", bazuar në nenin 134/2 të KP. Gjatë gjykimit ka qenë i pranishëm avokati i caktuar kryesisht, ndërkohë që as fëmija dhe as kujdestarët e tij ligjor nuk janë thirrur për t'u dëgjuar. Me Urdhër të Shërbimit Social Shtetëror fëmija gjendej në një institucion rezidencial. Gjykata nuk e ka marrë parasysh këtë fakt dhe në fund të gjykimit ka marrë vendim për vendosjen e fëmijës në "institucioni edukimi", duke lënë të pa përcaktuar

institucionin që ngarkohet me ekzekutimit dhe afatet për realizimin e tij.

Shënim: Aktualisht, fëmija nuk është vendosur në asnjë institucion dhe nga dita e shpalljes së vendimit rezulton të jetë raportuar disa herë në strukturat e policisë së shtetit për veprën penale të vjedhjes.

Fëmijët nën moshën 14 vjeç trajtohen nga sistemi i drejtësisë njësoj si fëmijët, të cilët kanë përgjegjësi penale dhe jo si kategori në nevojë për mbrojtje sociale. Atyre u garantohet e drejta për ndihmë ligjore dhe asistencë psikologjike që në momentin e parë të kontaktit me punonjës të policisë. Megjithatë burimet njerëzore të kufizuara dhe më konkretisht ekzistenca vetëm e një psikologu në organikën e Drejtorive Policore Rajonale, bën që në disa raste prania e psikologut të sigurohet në mënyrë alternative nga organizata jofitimprurëse. Statistikat e disponueshme në database të Policisë së Shtetit janë për të miturit në konflikt me ligjin në tërësi. Nuk ka statistika të diferencuara dhe mbi bazë gjinie për fëmijët nën moshën për përgjegjësi penale dhe as për përfshirjen e këtyre të fundit në vepra penale pas moshës 14 vjeç. Referimi nga punonjësi i policisë pranë Shërbimit Social Shtetëror apo në qendra të drejtuara nga organizata jo-fitimprurëse ndodh vetëm në rastet kur është nuk është i mundur kontaktimi i prindërve dhe kur i mituri vlerësohet të jetë në situatë rreth.

Nga të dhënat e marra nga intervistimi i 25 të miturve në IEVP Kavajë, përsa i përket përfshirjes së tyre në veprimtari kriminale nën moshën për përgjegjësi penale, ka rezultuar që 32 % e tyre kanë qenë në komisarjat për shkaqe të ndryshme përpara se të mbushnin moshën për përgjegjësi penale⁹⁸. Kjo tregon se ndërhyrja parandaluese me fëmijët nën moshën 14 vjeç që shfaqin sjellje kriminale, ka potencialin të ulë kriminalitetin tek të miturit mbi 14 vjeç.



Për sa më sipër, prioritet mbetet adresimi i kësaj çështje në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ngritja e shërbimeve mbështetëse dhe një sistemi identifikimi, referimi dhe trajtimi nga punonjësit e policisë tek punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve për ofrimin e mbrojtjes së nevojshme. Aktualisht me ndihmën e shoqërisë civile, Ministria e Drejtësisë, ASHMDF dhe MMSR po shqyrtojnë hartimin e një pakete ligjore që do të plotësojë këtë hendek. Ndryshimet e propozuara prekin Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

⁹⁸ Xhafellari, M., Gjoni, O., 2013 Femijet nen pergjegjesine ligjore. Tirana:ARSIS/CILSP/Save the Children.

etj si dhe hartimin e një Udhëzuesi të Përbashkët të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Brendshëm për menaxhimin e rasteve të fëmijëve nën moshën për përgjegjësi penale që kanë kryer vepra penale.

Viktimat/dëshmitarët e mitur

Mbrojtja e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë sanksionohet në mënyrë të përgjithshme, në kuadrin e së drejtës së fëmijëve për mbrojtje të veçantë⁹⁹. Mbrojtja e moralit dhe dinjitetit të fëmijës nga dëmtimi i kundërligjshëm nuk parashikohet në kontekstin e fëmijës si viktimë¹⁰⁰. Duke marrë parasysh faktin që fëmijët viktime/dëshmitarë janë të cenueshëm dhe kërkojnë mbrojtje të veçantë, të përshtatshme për moshën e tyre, nivelin e pjekurisë dhe nevojat e veçanta individuale, është e nevojshme të merren të gjitha masat për të parandaluar dhe për t'i mbrojtur ata nga dëmtimi, përfshirë kanosjen, hakmarrjen dhe ri-viktimizimin. Nevoja për të shmangur ri-viktimizimin është themelore në rastet kur fëmija është viktimë e abuzimeve të rënda siç janë ato seksuale, ku intervistimi i përsëritur i fëmijës nga autoritetet e ndryshme e detyron fëmijën të përjetojë sërish traumën e abuzimit.

Veç kësaj, duhet të garantohet mirë-funksionimi i organizmave shtetërore si dhe forcimi i bashkëpunimit ndër-sektorial ndërmjet gjykatave, policisë, prokurorisë, shërbimeve sociale dhe shëndetësore, mësuesve, organeve të qeverisjes vendore, strukturave për kujdesin shëndetësor dhe OJF-të. Gjithashtu, fëmijëve viktime/dëshmitarë dhe anëtarëve të familjeve të tyre t'u sigurohet aksesimi për ndihmë profesionale gjatë gjithë procesit gjyqësor si dhe referimi tek qendrat e kujdesit shëndetësor dhe programe të ndërhyrjes sociale.

Masat e diversionit

Masat e diversionit nuk janë të parashikuara në legjislacionin shqiptar. Megjithatë, prej vitit 2011 ka filluar zbatimi i ndërmjetësimit¹⁰¹, një praktikë, e cila synon drejtësinë restauruese. Në kushtet e një vakumi ligjor për vënien në zbatim të masave të diversionit çështje mbeten: adresimi i saj në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal, përcaktimi i masave të diversionit, roli dhe mandati i strukturave vendimmarrëse si dhe hartimi dhe zbatimi i programe trajnuese për profesionistët e përfshirë në këtë proces.

Ndihma juridike falas

Në vitin 2011 u miratua kuadri ligjor për ofrimin e ndihmë juridike falas¹⁰² dhe përcaktimin e përgjegjëseve konkrete të agjencive shtetërore dhe atyre publike në implementimin e standardeve të ndihmës juridike. U krijua Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike (KSHNJ), i cili më pas miratoi aktet nënligjore të domosdoshme për të bërë të mundur zbatimin e ndihmës juridike. Gjatë vitit 2011, KSHNJ ka refuzuar 27 kërkesa aplikuesish për ndihmë juridike (14 çështje penale dhe 13 çështje civile) për shkak të mangësive në dokumentacion të tyre. Në vitin 2012, KSHNJ ka miratuar dhënien e ndihmës juridike për 8 raste (5 raste penale dhe 3 civile). Duke konsideruar numrin e fëmijëve në konflikt me ligjin, dhe duke patur parasysh se shumë prej krimeve i kanë rrënjët në kushtet e varfërisë në të cilën ndodhet familja, numri i rasteve që kanë përfituar ndihmë ekonomike falas mbetet shumë i ulët në krahasim me nevojat.

⁹⁹ Neni 54, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

¹⁰⁰ Ligji "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

¹⁰¹ Ligjin Nr. 10385, datë 24.02.2011, "Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

¹⁰² Ligjin Nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për Ndihmën Juridike".

Pavarësisht përpjekjes për ngritjen e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike falas, konstatohet se mungon informacioni për ngritjen dhe funksionimin e KSHNJ, për përmbajtjen e ligjit dhe të akteve nënligjore, për kategoritë përfituese të ndihmës juridike, procedurën e aplikimit dhe të plotësimit të dokumentacionit. KSHNJ nuk ka hapur një faqe të veçantë në internet ku të publikojë informacione të domosdoshme për të interesuarit si dhe për vetë ofruesit e ndihmës juridike. Aksesit në ndihmën juridike falas kushtëzohet nga prezenca e KSHNJ në Tiranë. Kjo vështirëson ndjekjen e procedurave për ndihmë juridike falas për banuesit në zona gjeografike të largëta.



Çështje për adresim

Shumë nga rrethanat që çojnë fëmijët në konflikt me ligjin janë të një natyre sociale. Fëmijët që kryejnë vepra penale shpesh vijnë nga një kontekst familjar me probleme social-ekonomike si varfëria, ndarja apo dhuna në familje. Për të përmbushur qëllimin e ri-integrimit të fëmijës dhe në mënyrë që fëmija të luajë një rol konstruktiv në shoqëri (sipas nenit 40 të KDF), është e rëndësishme që të ketë një bashkëveprim dhe koordinim të mirë midis sistemit të drejtësisë dhe sistemit të mbrojtjes sociale. Sistemi i drejtësisë i vetëm nuk është i aftë të garantojë rehabilitimin e të miturve dhe ri-integrimin e tyre, dhe aq më pak parandalimin.

Paraburgimi i fëmijëve duhet përdorur si masë e jashtëzakonshme vetëm në kushte të një rrezikshmërie të lartë, dhe jo si praktikë e zakonshme. Gjithashtu, duhen promovuar alternativat ndaj burgimit dhe burgimi i fëmijëve duhet përdorur si alternativa e fundit.

Të gjithë fëmijët që vuajnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale IEVP, si edhe fëmijët pjesë e dënimeve alternative, si shërbimi i provës të kenë akses në një mekanizëm të ankesave, ku ata mund të paraqesin ankesa në lidhje me privimin e lirisë së tyre, kushtet e ndalimit/internimit dhe trajtimit.

Për fëmijët nën 14 vjeç është e rëndësishme të merren masa mbrojtëse “në interesin më të lartë të fëmijës”, mbi bazën e faktit që këto fëmijë duhet të konsiderohen fëmijë në rrezik për shkak të faktorëve që i kanë çuar në konflikt me ligjin. Kjo detyrë e vlerësimit të nevojave të fëmijës dhe planifikimi i ndërhyrjeve të nevojshme mbrojtëse dhe përkujdesi duhet të udhëhiqen nga punonjësi social/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, i cili bashkëpunon nëpërmjet një qasjeje ndër-sektoriale me aktorët e tjerë në nivel vendor. Këto procedura duhet të mbështeten në procedurat për mbrojtjen e fëmijës.

Të sigurohet e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar në çdo çështje gjyqësore, në një mënyrë të përshtatshme me moshën dhe miqësore për fëmijën, duke përfshirë çështjet civile dhe penale, si dhe në procedurat administrative që ndikojnë mbi fëmijët në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

Me qëllim promovimin e dhënies së dënimeve alternative për të miturit dhe riintegrimin e tyre në shoqëri, është e nevojshme të hartohen programe integrimi në komunitet, të forcohen më tej zyrat e shërbimit të provës përmes ngritjes/përmirësimit të kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës.

Realizimi i programeve integruese dhe ri-integruese të qëndrueshme më qëllim uljen e nivelit të recidivizmit për fëmijët e përfshirë në sistemin e paraburgimit.

Fëmijëve viklima dhe dëshmitarë duhet t'u sigurohet asistencë ligjore dhe ndihmë tjetër efektive dhe e përshtatshme që në fazat e para të procedimit dhe gjatë procesit gjyqësor në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Hartimi i programeve të trajtimit dhe rehabilitimit të fëmijëve viklima/dëshmitarë dhe ofrimi i shërbimeve mbështetëse.

Duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për vënien në zbatim të ligjit dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse që të garantohet e drejta për ndihmë juridike, si një e drejtë kushtetuese, veçanërisht për fëmijët, të cilët janë më të kufizuar në mundësinë për të përdorur në mënyrë proaktive instrumentet e mbrojtjes juridike.



Kontributi i Fëmijëve¹⁰³

Si është dhe dëshironi të jeta bota që ju rrethon?

Me anë të zemrës paraqesim **familjen**, dashurinë që marrim dhe japim aty. Por ka edhe familje ku për shkaqe të ndryshme, fëmijët nuk marrin dashurinë dhe ngrohtësinë e duhur.

Lulja e lulëzuar është përdorur si **simbol i miqësisë**, e cila është shumë e rëndësishme për ne.

Me anë të librit kemi simbolizuar **shkollën**, që është e rëndësishme meqë aty mësohet dhe bëhemi gati për jetë. Por dëshirojmë që shkollat dhe mësimdhënia të përmirësohet.

Kemi paraqitur nëpërmjet një peme **mjedisin/ambienti** që është i rëndësishëm, dhe duhet ruajtur e mbajtur pastër.

Fëmija me arkë në dorë tregon **shfrytëzimin e fëmijëve për punë**. Me anë të këtij zogu duam të themi se fëmija duhet të jetë i lirë dhe të mbrohet nga çdo lloj **abuzimi dhe dhune**.

Nëpërmjet vizatimit të një shisheje **alkooli dhe cigares**, duan të bëjmë apel që fëmijët të jenë sa më larg efekteve e pasojave të tyre.

Policia është që i mbron fëmijët dhe vendi ku ata mund të denoncojnë kur iu shkelen të drejtat.

Arma simbolizon **gjakmarrjen** që duhet të mos jetë më dhe duhet ndihma e institucioneve për ta zhdukur këtë fenomen.

Vizatimi i gojës dhe i veshit simbolizon **respektin** që duhet të kemi për njëri tjetrin, kur dikush flet të tjerët duhet ta dëgjojnë atë.

Fëmija që luan, tregon se **loja** është e rëndësishme për ne dhe është mirë që të na krijohen kushte për ta bërë këtë.

Stema e facebook-ut që paraqet se sa shumë kohë fëmijët kalojnë në rrjetet sociale. Duam që të vendoset një limit dhe kontroll për fëmijët, dhe të inkurajohen të shpenzojnë më tepër kohë me lojëra në natyrë.

Fytyra e mërzitur e këtij fëmije tregon emocionet e tij të shprehura me të qarë, pasi ai ka pësuar dhunë apo është mërzitur për arsye tjetër. Kjo është bota që na rrethon dhe do kishim dëshirë që të gjithë këto institucione që thamë të na ndihmojnë për ta bërë një vend sa më të mirë.

¹⁰³ Grup diskutimi drejtuar nga ASHMDF me pjesëmarrjen e 20 të rinjve, në 12 nëntor 2014, në Shkodër, lehtësuar nga World Vision.

Shtojca 1 Legjislacioni

LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Konventa e OKB "Për të Drejtat e Fëmijëve"

Konventa Nr. 138, 26 Qershor 1973, e ratifikuar me ligjin Nr. 8086, më 13.3.1996 "Në lidhje me moshën minimale për pranimin në punë e Organizatës Ndërkombëtare të Punës"

Konventa Nr. 182, e ratifikuar me ligjin 8774, më 23.4.2001 "Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999", e Organizatës Ndërkombëtare të Punës

Konventa e Hagës ratifikuar me ligjin Nr. 8624, datë 15.6.2000 "Mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit"

Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës ratifikuar me ligjin Nr. 9359, datë 24.03.2005 "Për Marrëdhëniet me Fëmijët"

Konventa e Hagës, ratifikuar me ligjin Nr. 9443, datë 16.11.2005 "Mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve"

Konventa e Hagës ratifikuar me Ligjin Nr. 9446, datë 24.11.2005 "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës"

Konventa e Këshillit të Evropës ratifikuar me ligjin Nr. 9642, datë 20.11.2006 "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"

Konventa e Këshillit të Evropës, Lanzarote 25.10.2007, ratifikuar me ligjin 10071, datë 9.2.2009 "Për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual"

Konventa e Këshillit të Evropës ratifikuar me ligjin Nr. 10 424, datë 2.6.2011 "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesë"

Konventa e Këshillit të Evropës 25.1.1996, e ratifikuar me ligjin Nr. 10 425, datë 2.6.2011 "Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"

Konventa e Këshillit të Evropës e ratifikuar me ligjin Nr. 10425, datë 02.06.2011 "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"

Konventa së Këshillit të Evropës e ratifikuar me ligjin Nr. 10424, datë 02.06.2011 "Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesë".

PROTOKOLLE

Protokolli shtesë i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve", **ratifikuar me ligjin Nr8920, datë 11.7.2002**

Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, **RSH ka aderuar në Konventë më 22.11.2007**

Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë, **ratifikuar më 02.11.2007**

Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijës "Për Procedurën e Komunikimit", **ratifikuar më 14.02.2013**

LEGJISLACIONI KOMBËTAR

- Ligji Nr. 7905, datë 21.3.1995** "Kodi i Procedurës Penale së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996** "Kodi i Procedurës Civile së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9062, datë 8.5.2003** "Kodi i Familjes"
- Kodi i Punës;** Ligji Nr. 7961 datë 12.07.1995, ndryshuar me Ligjin 8085 datë 13.3.1996, dhe Ligjin 9125 datë 29.7.2003
- Ligji Nr. 23/2012** "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 7952, datë 21.6.1995** "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar dhe Udhëzimi i Ministrit të Arsimit "Për Eliminimin e Dhunës në Shkollë"
- Ligji Nr. 7939, datë 25.5.1995** "Për migracionin", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8328, datë 16.4.1998** "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8331, datë 21.4.1998** "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8528, datë 23.9.1999** "Për nxitjen dhe mbrojtjen e ushqimit me gji"
- Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996** "Për statusin e jetimit"
- Ligji Nr. 8872, datë 29.3.2002** "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8876, datë 4.4.2002** "Për shëndetin riprodhues", i ndryshuar
- Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005** "Për Ndhimën dhe Shërbimet Sociale", i ndryshuar
- Ligj Nr. 9518, datë 18.4.2006** " Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit"
- Ligji Nr.9669, datë 18.12.2006** "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare "
- Ligji Nr. 9695, datë 19.3.2007** "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të birësimit
- Ligji Nr. 9952, datë 14.7.2008** "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it"
- Ligji Nr. 10039, datë 22.12.2008** "Për ndihmën juridike"
- Ligji Nr. 10173, datë 22.10.2009** "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë"
- Ligji Nr.10221 datë 4.2.2010** "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
- Ligji Nr.10237 datë 18.2.2010** "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar
- Ligji Nr.10347 datë 4.11.2010** "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve"
- Ligji Nr. 69/2012** "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"
- Udhëzimi Nr. 29, datë 02.08.2013, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohe të pjesshme.**
- Udhëzimi Nr. 31, datë 02.08.2013 "Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasë të arsimit bazë.**
- Urdhri Nr. 344, date 19. 08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social"**
- Ligji Nr. 10454 datë 21.7.2011** "Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në republikën e Shqipërisë"
- Ligji Nr. 44/2012** "Për shëndetin mendor"
- Ligji Nr. 93/2014** "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"

VKM Nr. 658 datë 17.10.2005 "Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore";

VKM Nr. 659 datë 17.10.2005 "Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për fëmijët në institucione rezidenciale"

VKM, Nr. 195, datë 11.04. 2007 "Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale"

Dekret Nr. 6218, datë 7.7.2009 "Për krijimin e seksioneve penale për gjykimin e të miturve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore"

VKM Nr. 142, datë 23.2.2011 "Për miratimin e "planit kombëtar të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore" dhe të dokumentit plotësues "plani i veprimit për luftën kundër trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, viktimave të trafikimit"

VKM Nr. 582, datë 27.7.2011 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit".

VKM Nr. 263, datë 12.04.2012 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve".

VKM Nr. 264, datë 12.04.2012 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"

VKM Nr. 265, datë 12.04.2012 "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij"

VKM Nr. 266, datë 12.04.2012 Për Bashkërendimin e mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e drejtave të fëmijëve"

VKM Nr. 267, datë 12.04.2012 "Për Llojet, Mënyrën e Shkëmbimit të Informacionit dhe të Dhënave Statistikore të Kërkuara nga Agjencia e nga Strukturat Shtetërore Përgjegjëse, në Nivel Qendror dhe Vendor"

VKM Nr. 89, datë 26.1.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë"

VKM Nr. 904, datë 12.12.2012 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot"

VKM Nr. 376, datë 11.6.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 787, datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", të ndryshuar



Shtojca 2 Lista e NJDF dhe NJMF

Lista e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve¹⁰⁴

Qarku Berat	Rrethi Berat	Bashkia Berat	Robert Nazari
		Bashkia Ura Vajgurore	Nerita Heqimi
		Komuna Cukalat	Fatbardh Shahini
		Komuna Otlak	Boriana Sofia
		Komuna Poshnje	Dallendyshe Lalo
		Komuna Roshnik	Haxhi Arberi/ Luto Mara
		Komuna Velabisht	Laureta Papa
		Komuna Vërtop	Liljana Hitollari/ Ali Salillari
	Rrethi Kuçovë	Bashkia Kuçovë	Majlinda Serjani
		Komuna Kozare	Marsela Sallo
		Komuna Perondi	Nertila Qorri
	Rrethi Skrapar	Bashkia Çorovodë	Ritvana Hysenbelliu
		Bashkia Poliçan	Valeriana Dyrmyshi/ Aurora Qama
		Komuna Leshnjë	Valbona Gropa
		Komuna Potom	Rajmonda Dusho
		Komuna Qendër	Xhuli Hysi
Qarku Dibër	Rrethi Dibër	Bashkia Peshkopi	Anjeza Vokaj
		Komuna Arras	Gezim Daci
		Komuna Luzni	Ali Damzi
		Komuna Maqellarë	Isuf Osmani
		Komuna Muhur	Astrit Veshi
		Komuna Tomin	Majlinda Deshati
		Komuna Zall-Dardhë	Avdi Lushi
	Rrethi Bulqizë	Bashkia Bulqizë	Flogerta Koci
		Komuna Zërqan	Vasfie Kurti
	Rrethi Mat	Bashkia Burrel	Edlira Drici/ Blerta Hysa
		Bashkia Klos	Mehmet Limani
		Komuna Baz	Dylbere Cakoni
		Komuna Komsî	Violeta Tusha
		Komuna Lis	Hismet Barhani
		Komuna Rukaj	Flora Neziri/Edison Troci
		Komuna Suç	Manushaqe Shkajoti
Qarku Durrës	Rrethi Durrës	Bashkia Durrës	Olta Bajraktari
		Bashkia Shijak	Daniela Deda

¹⁰⁴ Përditësimi i kësaj liste është bërë në datën 20.11.2014

		Bashkia Manzë	Mrika Hoxha/ Ingrid Gargaj/ Dylbere Shehi
		Bashkia Sukth	Viola Ibrahim
		Komuna Gjepalaj	Englantina Reka
		Komuna Ishëm	Rabije Qevani
		Komuna Katund i Ri	Hajrie Gashi
		Komuna Maminas	Lumturie Picari
		Komuna Rrashbull	Arta Vila/ Ismete Serjani/ Muharrem Kabashi
		Komuna Xhafzotaj	Merita Kodra/ Alma Berxulli
	Rrethi Krujë	Bashkia Fushë-Krujë	Albana Sefa
		Bashkia Krujë	Elmira Dallaku
		Komuna Bubq	Ramazan Kazim
		Komuna Çudhi	Saba Sejдини
		Komuna Thumanë	Merita Qira
		Komuna Nikël	Anisa Topalli
Qarku Elbasan	Rrethi Elbasan	Bashkia Belsh	Blerim Tafani
		Bashkia Cërrik	Ilma Ago
		Bashkia Elbasan	Nadire Kreka
		Komuna Bradashesh	Xhevair Ibrahim
		Komuna Fierzë	Haziz Mema
		Komuna Graçen	Petrit Balliu
		Komuna Grekan	Astrit Elezi
		Komuna Gjergjan	Blerta Kullaku
		Komuna Gjinar	Dashuri Myrta
		Komuna Klos	Faire Vishkulli
		Komuna Labinot-Mal	Rexhep Boci
		Komuna Mollas	Marsida Broshka
		Komuna Papër	Eglantina Doko
		Komuna Shirgjan	Drita Cerri
		Komuna Tregan	Manjola Tashi
	Rrethi Gramsh	Bashkia Gramsh	Arjona Bici
		Komuna Kodovjat	Kastriot Tafa
		Komuna Kukur	Kapedan Tarfo
		Komuna Kushovë	Fatime Daja
		Komuna Pishaj	Thellenxa Llalla
		Komuna Poroçan	Gani Peja
		Komuna Shenepremte (Lenie)	Rustem Bici
		Komuna Sult	Hamit Dermyshe
		Komuna Tunjë	Tefta Teto

	Rrethi Librazhd	Bashkia Librazhd	Rexhep Shaka
		Komuna Lunik	Sefedin Kodraliu
		Komuna Polis	Robert Gjeli
		Komuna Qendër (Librazhd)	Tefta Pepa
		Komuna Qukës	Ylli Kuka
		Komuna Rajcë	Zaide Çela
		Komuna Steblevë	Mirursh Toci
		Komuna Stravaj	Perparim Leka
	Rrethi Peqin	Bashkia Peqin	Erdi Kosta
		Komuna Gjocaj	Fadil Salliu
		Komuna Pajovë	Zenel Gordumi
		Komuna Shezë	Elida Tabaku
Qarku Fier	Rrethi Fier	Bashkia Fier	Alma Agalliu
		Bashkia Roskovec	Alda Gjata
		Komuna Levan	Xheksila Hamataj
		Komuna Qendër	Rrapi Vogli
		Komuna Ruzhdije	Amarildo Gllava
	Rrethi Lushnjë	Bashkia Lushnje	Valbona Myzeqari
		Komuna Allkaj	Pandeli Cauli
		Komuna Fier-Shegan	Evisona Pepa
	Rrethi Mallakastër	Bashkia Ballsh	Jonida Sulaj
		Komuna Fratar	Edison Zylalaj
		Komuna Hekal	Agron Hoxhaj
		Komuna Kutë	Shaban Sulaj
		Komuna Qendër/Mallakaster	Hajredin Serjanaj
Qarku Gjirokastrë	Rrethi Gjirokastrë	Bashkia Gjirokastrë	Marjanthi Bedjava
Qarku Korçë	Rrethi Korçë	Bashkia Korçë	Brikena Cuçllari/
		Bashkia Maliq	Jonila Lilollari
		Komuna Gore	Bedri Bashllari
		Komuna Liqenas	Kristina Sekulla
		Komuna Mollaj	Erjon Bacalli/ Demirali Latollari
		Komuna Qender, Bulgarec	Jeta Shehu/ Stela Koca
		Komuna Vithkuq	Dhimitraq Gjylapi
		Komuna Voskop	Ira Akrobati
		Komuna Vreshtas	Albert Zenelaku
	Rrethi Pogradec	Bashkia Pogradec	Besa Xhani
		Komuna Buçimas	Robert Çekiçi/ Ervisa baci

		Komuna Cerrave	Doriana Hoxha
		Komuna Udënisht	
		Komuna Proptisht	Besnik Xhyra, Shpetim Leka
		Komuna Trebinje	Neki Laraku
	Rrethi Kolonjë	Bashkia Leskovik	Leonora Kalavace
		Komuna Barmash	Qtesor Tafil
		Komuna Qender Erseke	Enton Cacani
		Komuna Qender Leskovik	Marjana Kravari
	Rrethi Devoll	Bashkia Bilisht	Diana Kapo
		Komuna Progër	Avni Dushi
Qarku Kukës	Rrethi Kukës	Bashkia Kukës	Morena Hoxha/ Lirie Bytyci
		Komuna Bicaj	Orjola Guri
		Komuna Shtiqën	Zeqir Halilaj
		Komuna Terthore	Ramadan Demaj
	Rrethi Tropojë	Bashkia Bajram Curri	Valentina Nezaj
		Komuna Margegaj	Drilon Toskaj
		Komuna Llugaj	Shkurta Gjoka
		Komuna Bujan	Bukurie Ahmetaj
		Komuna Fierzë (Tropojë)	Majlinda Ponari/ Izet Ponari
	Rrethi Has	Bashkia Krume	Shani Kastrati
		Komuna Gjinaj	Muharrem Thaci
		Komuna Golaj	Perparim Brati
Qarku Lezhë	Rrethi Lezhë	Bashkia Lezhë	Anita Jaku
		Komuna Balldre	Emanuela Mirukaj
		Komuna Zejmen	Violeta Paloka
	Rrethi Mirditë	Bashkia Rrëshen	Arselajda Pepkolaj
		Bashkia Rubik	Malvina Marku/ Gazmend Marku
		Komuna Fan	Zef Pjetri
		Komuna Kthellë	Odetta Ndrejaj
	Rrethi Kurbin	Bashkia Lac	Vilma Kola
		Bashkia Mamurras	Merita Krasniqi/ Deshira Kuqi
Qarku Shkodër	Rrethi Shkodër	Bashkia Shkoder	Rudina Kruja
		Komuna Ana-Malit	Xhemal Kopshti
		Komuna Postrribë	Dashmir Shabaj
		Komuna Qelez	Nikoll Kolaj
		Komuna Qafë-Mali	Etleva Elezi
Qarku Tiranë	Rrethi Tiranë	Njesia Bashkiake Nr 1	Joana Filo

		Njesia Bashkiake Nr 2	Adriatik Zaka
		Njesia Bashkiake Nr 3	Ada Isallari
		Njesia Bashkiake Nr 4	Emine Kica
		Njesia Bashkiake Nr 5	Adelina Shehu
		Njesia Bashkiake Nr 6	Stela Prendi
		Njesia Bashkiake Nr 7	Denisa Bakiasi
		Njesia Bashkiake Nr 8	Mirela Biba
		Njesia Bashkiake Nr 9	Lorena Cela/Naxhie Osmani
		Njesia Bashkiake Nr 10	Rudina Qendro
		Njesia Bashkiake Nr 11	Kozeta Makaj
		Bashkia Kamëz	Dhurata Cali
		Bashkia Vorë	Elida Karamuca
		Komuna Bërxullë	Dallendyshe Petku
		Komuna Bërzhitë	Elona Allmuca/ Luan Sallaku
		Komuna Dajç	Sami Kamberi
		Komuna Ndroç	Ivana Brahja
		Komuna Paskuqan	Hajri Lita
		Komuna Pezë	Hysni Isaku
		Komuna Vaqar	Mirela Xhabafti
		Komuna Zall-Herr	Ada Qarri
	Rrethi i Kavajës	Bashkia Kavajë	Marjusa Cara
		Bashkia Rrogozhinë	Ana Çeka
		Komuna Golem	Ilirjana Xhafa
		Komuna Kryevidh	Besnik Kaja
		Komuna Lekaj	Sabrie Gjini
		Komuna Luz i Vogël	Besjana Xeka
		Komuna Synej	Albana Salillari
Qarku Vlorë	Rrethi Vlorë	Bashkia Orikum	Klementina Curoj
		Bashkia Himare	Blerina Bala/ Antoneta Bollano
		Bashkia Selenicë	Orjeta Mishtaku
		Bashkia Vlorë	Jonida Dhroso
		Komuna Armen	Kastriot Haxhiraj
		Komuna Brataj	Cane Seferi
		Komuna Horë-Vranisht	Lefter Qejvanaj
		Komuna Kotë	Hava Rrapaj/ Jetnor Bejtaj
		Komuna Novoselë	Ediola Doko
		Komuna Qendër (Vlorë)	Zamir Qezari
		Komuna Sevaster	Inxhi Zykaj/Nero Gjonaj

		Komuna Shushicë	Ali Petani
		Komuna Vllahinë	Oljana Hoxhaj
	Rrethi Sarandë	Bashkia Konispol	Teuta Çokalli
		Bashkia Sarandë	Emanuela Cetri/ Anila Pikuli
		Komuna Aliko	Stavro Çavo
		Komuna Dhivër	Thodhori Papa
		Komuna Ksamil	Valbona Oruci/ Bashkim Shuka
		Komuna Livadhja	Stamato Naci
		Komuna Lukovë	Zamira Xhani/Nertila Hodaj/ Aleksandra Dhrami
		Komuna Markat	Vitori Muçaj
	Rrethi Delvinë	Bashkia Delvinë	Anila Janku/Lorena Dizdari
		Komuna Finiq	Fotini Spiro
		Komuna Mesopotam	Eleni Shqevi



Lista e Njësive për të Drejtat e Fëmijëve¹⁰⁵

Qarku	Emri Mbiemri
Fier	Shkelzen Bushi
Fier	Enerjeta Avrami
Berat	Redina Qafa
Berat	Vasilika Cela
Tiranë	Entela Lila
Tiranë	Lorena Totoni
Lezhë	Artan Palushi
Lezhë	Linda Maci
Dibër	Nevila Manga
Dibër	Zenulla Mehmeti
Durrës	Jonida Troplini
Durrës	Fatjona Muhametaj
Kukës	Elona Shaqiri
Elbasan	Najada Kokoneshi
Elbasan	Blendi Gremi
Gjirokastrë	Aurora Beci
Vlorë	Alma Myrtaj
Vlorë	Zhuljeta Kume
Shkodër	Jozef Serrmi
Korçë	Tatjana Gusho

¹⁰⁵ Përditësimi i kësaj liste është bërë në datën 20.11.2014





Agjencia Shtetërore
për **Mbrojtjen** e të
Drejtave të **Fëmijëve**

Raport kombëtar mbi situatën
e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri

2013-2014

